



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Cirkun Kombëtar

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE”
NË
CIRKU KOMBËTAR

Tiranë 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-4
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	4-5
II.	HYRJA	5
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	6
2.	Identifikimi i çështjes	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7
5.	Kriteret e vlerësimit	8
6.	Standardet e auditimit	8
7.	Metodat e auditimit	8
8.	Dokumentimi i auditimit	8-9
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:	9
2.1	Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.	9-22
2.2	Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.	22-30
2.3	Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare.	30-45
2.4	Prokurimet e fondeve publike	45
2.5	Veprimtaria e Cirkut Kombëtar	45-52
2.6	Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar	52-61
IV	REKOMANDIME	61-68
V	ANEKSE	68-69

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Cirku Kombëtar (*këtu e më poshtë CK*) është institucion publik me statusin e institucionit qendror në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën dhe funksion në mbështetje të Ligjit Nr. 10352, datë 18.11.2010 “*Për Artin dhe Kulturën*”, i ndryshuar, neni 5, germa “dh”, paragrafi 3, Statutit miratuar nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën dhe Rregullores së Brendshme. Objekti i veprimtarisë së CK është mbështetja në vlerat e kulturës dhe artit kombëtar.

Rëndësia e auditimit të tij.

Auditimi u krye nisur nga kërkesa nr.1324, datë 04.11.2024 e bërë nga Cirku Kombëtar drejtuar KLSH për kryerjen e një auditimi përputhshmërie.

Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi, synon në dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për vitin 2023 si dhe dhënien e opinionit mbi auditimin e përputhshmërisë për veprimtarinë e CK për periudhën 01.01.2022 deri me datë 31.12.2024.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim marrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushjen e qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
- Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare.
- Prokurimet e fondeve publike.
- Veprimtaria e Cirkut Kombëtar.
- Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodat për kryerjen e këtij e auditimi janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, CK, funksion në zbatim të Ligjit Nr.10352, datë 18.11.2010 “*Për Artin dhe Kulturën*” i ndryshuar.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;

c. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna. Në Projekt Raportin e auditimit janë trajtuar **16** gjetje dhe propozuar **21** rekomandime për masa organizative, **2** gjetje dhe **2** rekomandime për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet.

Paraqitja e gjetjeve kryesore. Grupi i auditimit ka propozuar **16** gjetje për masa organizative dhe **2** gjetje për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet, të cilat janë konstatuar në:

Drejtimi 1: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit janë konstatuar 3 gjetje për masat organizative dhe 2 gjetje për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet.

Drejtimi 2: Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave janë konstatuar 4 gjetje.

Drejtimi 3: Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare janë konstatuar 3 gjetje.

Drejtimi 4: Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik, nuk janë parashikuar dhe as realizuar procedura prokurimi për periudhën nën auditim, për rrjedhojë nuk ka asnjë rekomandim.

Drejtimi 5: Veprimtaria e Cirkut Kombëtar, janë konstatuar 4 gjetje për masat organizative.

Drejtimi 6: Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, janë konstatuar 2 gjetje për masat organizative.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Grupi auditimit ka propozuar **21** rekomandime për masa organizative, dhe **2** rekomandime për përdorim të fondeve publike pa efektivitet, konstatuar në:

Drejtimi 1: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, janë propozuar 4 rekomandime për masa organizative dhe 2 rekomandime për përdorim të fondeve publike pa efektivitet në vlerën totale **14,032,699** lekë, e cila përbëhet nga diferenca prej **796,699** lekë nga llogaritja e vlerës fillestare minimale të qirasë trajtuar përgjatë materialit dhe vlera **13,236,000** lekë që përfaqëson shpenzimet për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor.

Drejtimi 2: Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, janë propozuar 4 rekomandime për masa organizative.

Drejtimi 3: Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare, janë propozuar 3 rekomandime për masa organizative.

Drejtimi 4: Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik, nuk janë parashikuar dhe as realizuar procedura prokurimi për periudhën nën auditim, për rrjedhojë nuk ka asnjë rekomandim.

Drejtimi 5: Veprimtaria e Cirkut Kombëtar, janë propozuar 4 rekomandime për masat organizative.

Drejtimi 6: Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, janë propozuar 6 rekomandime.

1.3. Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi auditimin financiar i kualifikuar¹:

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të Cirkut Kombëtar për periudhën e mbyllur më 01.01.2022-31.12.2023, si dhe transaksione financiare të kryera gjatë vitit ushtrimor 2024.

Opinionin është dhënë mbi pasqyrat financiare të vitit 2023², të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e kualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha

¹ Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.54), Kapitulli VII pika 4.2. *Një opinion i modifikuar*, jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultetit financiar, ose kur nga auditimi nuk sigurohet evidencë e mjaftueshme dhe e duhur financiare për të mbështetur dhënie dhe opinionin, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të ketë gabime materiale të cilat sjellin ndryshim të rezultetit financiar.

² Gjatë fazës së auditimit në terren me afat përfundimtar 04.04.2025, nga ana e Cirkut nuk ishin përgatitur dhe miratuar në thesar deri në 31 Mars 2025 pasqyrat financiare të vitit 2024.

aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2023, referuar legjislacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi kryer auditimin financiar në mbështetje të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s) mbështetur në ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar”, ISSAI 2000 “Aplikimi i standardeve të auditimit financiar”, në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Cirkut. Për këto arsye kemi dhënë opinionin të kualifikuar.

Baza e opinionit të kualifikuar:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë se:

-Procesi i inventarizimit nuk rezulton të jetë kryer, si dhe nuk ka regjistër kontabël të aktiveve;
-Në pasqyrat financiare të vitit 2023 është reflektuar veprimi kontabël pakësim inventari. Ky veprim është bazuar në konkluzionet e grupit të inventarizimit të aktiveve të cilët kanë hartuar pasqyrën për nxjerrje jashtë përdorimit në tabelë exceli për 37 artikuj me emërtimin “Mungojnë me proces verbal” në vlerën 6,578 mijë lekë. Referuar këtyre evidencave, nuk dokumentohet të ketë miratim nga strukturat përgjegjëse lidhur me shkarkimin me procesverbal të vlerave të evidentuara si mungesë, të dhënat e kësaj table nuk janë konfirmuar nga grupi i inventarizimit, nuk është kryer një analizë e veprimeve kontabël të pakësuara. Në lidhje me procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë, rezultoi se nuk ka gjurmë të plotë të auditit përse i përket këtij procesi, nuk specifikohet mënyra e kryerjes së nxjerrjes jashtë përdorimit, mungojnë provat justifikuese. Veprimet e mësipërme rezultojnë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar.

-Për llogarinë ekonomike 218, sipas inventarit kontabël, ka disa aktive si pajisje elektronike, kondicionerë, kitarë, kamera digjitale etj që duhet të pasqyroheshin në llogarinë 214 “Pajisje, instalime teknike, makineri e pajisje elektronike” dhe jo në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, për pasojë Nënpunësi Zbatues nuk ka kryer klasifikimin e saktë të aktiveve ndër zëra. Për zërin 218 “Inventar ekonomik”, është përdoruar metoda e amortizimit mbi vlerën e mbetur. Kategorizimi i aktiveve nuk është i saktë, rrjedhimisht dhe amortizimi nuk është konform normave përkatëse për kategori të ndryshme aktivesh në kundërshtim me UMF Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitje, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

Opinion mbi përputhshmërinë e kualifikuar³

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Cirkut Kombëtar (këtu e më poshtë CK), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregulloret dhe rregullat që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, projektet artistike, veprimet me bankën, etj. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit/dokumentacionin e kërkuar dhe vënë në dispozicion, janë

³ Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 245, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.3 Një opinion ”i modifikuar”, jepet kur audituesi modifikon opinionin në rastet e: a. anomalive dhe mospërputhjeve materiale. Në varësi të shtrirjes së mospërputhjes, kjo mund rezultojë në: opinion të kualifikuar ose opinion të kundërt: a. raste të anomalive dhe mospërputhjeve materiale. Në varësi të shtrirjes së mospërputhjes, kjo mund rezultojë në: opinion të kualifikuar ose opinion të kundërt.

evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar/kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e përputhshmërisë

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në mbështetje me Ligjin Nr.154/2014, miratuar në datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 245, datë 29.12.2022. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P-10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr.56 , datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar, i cili rezulton në:

-mos realizimin e inventarizimit të aktiveve për vitet 2022-2023, në kundërshtim me nenin 74 të UMF nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar duke bërë të pamundur që zërat e aktiveve të pasqyruara në Bilancin e Pasqyrave Financiare për vitet 2022-2023, të paraqesin gjendjen reale të tyre në fund të vitit;

-struktura organike nuk është plotësuar për të gjithë pozicionet e parashikuara në Urdhrin e Kryeministrit Nr.134, datë 28.03.2014, si dhe mungesa në strukturë për pozicionin “jurist”, ka sjellë që ky pozicion aktualisht është mbuluar me kontraktim nga jashtë në mënyrë të vazhdueshme;

-kontratat individuale të punës lidhur me punonjësit e CK si dhe kontratat individuale për punonjësit e rekrutuar gjatë periudhës Janar 2022-Dhjetor 2024, të cilat janë pjesë e dosjeve të personelit, ishin me afat 1 ose 2 vjeçar, pa u justifikuar arsyet pse janë lidhur me këtë afat ose nuk janë rinovuar kontratat të cilëve ju kishte përfunduar afati; gjithashtu në dosjet e personelit mungojnë vlerësimet e performancës në punë, mbi verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave, si dhe i aftësive apo dobësive të punonjësve në kryerjen e detyrave.

-kontratat e shërbimit të lidhur me artistët për projektet artistike për periudhën 2023-2024, nuk parashikojnë penalitete për vonesa në realizimin e shërbimit, afatet, kalendarin e shfaqjeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve në mënyrë specifike, të drejtën e pronësisë për kostumet apo materialet skenike të prodhuara për projektin konkret, si dhe detyrimet mbi të drejtën e autorit, jo në përputhje me parimet e përgjithshme të Kodit Civil për kontratat e shërbimit;

-në zbatim të “gjurmës së auditimit të projekteve”, në disa raste mungon relacioni përmbledhës;

-publikimi i thirrjeve për aplikim projektesh artistike bëhet në rrjete sociale (instagram) në adresë të CK dhe jo në faqen zyrtare të tij dhe as në atë të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën (mungon faqe zyrtare).

- mos garantimin e mbikëqyrjes për periudhën 2022-2024, lidhur me zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, pasi nuk është hartuar deklarata dhe raporti i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm jo në përputhje me Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 i Ministrit të Financave “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike” dhe Udhëzimin nr. 02, datë 26.01.2024 i Ministrit të Financave “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”; nuk ka rregulla të brendshme që trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, nuk janë krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut pasi nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut/Plani i menaxhimit për trajtimin e risqeve, nuk është hartuar gjurma e auditimit për procese kryesore në kundërshtim me nenin nenin 16, pika 2 dhe 18 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit Nr.59/1, datë 21.01.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 22.01.2025 deri më datë 04.04.2025, në subjektin Cirkull Kombëtar (*këtu e më poshtë CK*) u krye auditimi financiar dhe përputhshmërie për periudhën nga 01.01.2022 deri në 31.12.2024 nga grupi i auditimit me përbërje:

1.M.H.,	përgjegjës grupi;
2.B.Z.,	auditues (i zëvendësuar)
3.B.B.,	auditues
4.L.L.,	auditues
5.M.V.,	auditues

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit në: Hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare, prokurimet e fondeve publike, veprimtarinë e Cirkullit Kombëtar dhe vlerësimin e funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur aktkonstatimet si dhe është organizuar takimi përmbyllës në terren me datë 04.04.2025 me Drejtorin e CK dhe stafin e tij si dhe grupin e auditimit. Takimi përmbyllës në terren është mbajtur sipas protokollit përkatës (Dokument i standard 2/2) parashikuar në “*Rregulloren e Procedurave të Auditimit*”, miratuar me Vendimin Nr.07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH e ndryshuar.

OBJEKTIVAT, FUSHË VEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1.Objekti dhe qëllimi i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e opinionit të auditimit mbi pasqyrat financiare si dhe opinionit të përputhshmërisë mbi një vlerësim objektiv, profesional dhe të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga CK të rregullave, ligjeve. Qëllimi i tij është përcaktimi i nivelit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e CK për periudhën në auditim. Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

- nëse janë kryer transaksionet financiare duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së CK-së.

2. Identifikimi i çështjes.

Projektraporti mbi auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së CK Tiranë, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2024, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me zbatimin e buxhetit të shtetit, marrëdhëniet e punës dhe pagave, prokurimet e fondeve publike, vlerësimin e funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.
- vlerësimin e parimeve kontabël të përdorur dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

3.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të CK, kanë për detyrë që të përgjigjen për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësi të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4.Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/CK dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për zbatimin e buxhetit të shtetit, marrëdhëniet e punës dhe pagave, prokurimet e fondeve publike, vlerësimin e funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

-vlerësimin e parimeve kontabël të përdorur dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

5.Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

-Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji Nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar;

-Statuti i Cirkut Kombëtar miratuar nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën protokolluar me shkresën Nr.843 prot., datë 05.02.2013;

-Rregullore e Brendshme miratuar nga drejtori i CK protokolluar me shkresën Nr.116 prot., datë 11.03.2013;

-Rregullore e Brendshme miratuar nga drejtori i CK protokolluar me shkresën Nr.71, datë 20.03.2024

-Rregullore për “Funksionimin e Bordit Artistik të Cirkut Kombëtar” protokolluar me shkresën nr.157, datë 12.07.2023.

-Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

6.Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi i auditimit gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

-ISSAI 200 (*Parime themelore të auditimit financiar*);

-ISSAI 100 (*Parime themelore të auditimit të sektorit publik*), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;

-Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.246, datë 29.12.2022;

-ISSAI 400 (*Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

-ISSAI 4000 "*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*";

-Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.;

-Praktikat më të mira të fushës.

7. Metodatat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, CK, funksion në zbatim të Ligjit Nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e CK, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në aktkonstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Cirku Kombëtar (CK) është institucion publik me statusin e institucionit qendror në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën dhe funksionon në mbështetje të Ligjit Nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, neni 5, germa “dh”, paragrafi 3, Statutit miratuar nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën dhe Rregullores së Brendshme. Objekti i veprimtarisë së CK është mbështetja në vlerat e kulturës dhe artit kombëtar. Detyrat dhe funksionet parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, Statutin dhe Rregulloren e Bordit Artistik.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit Nr. 59/1, datë 21.01.202 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Cirkun Kombëtar u ushtrua auditim financiar dhe përputhshmërie për periudhën 01.01.2022-31.12.2024, sipas këtyre drejtimeve:

- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
- Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare.
- Prokurimet e fondeve publike.

- Veprimtaria e Cirkut Kombëtar.
- Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

2.1 Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.

Hartimi i buxhetit është kryer mbështetur në Ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2024 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016 dhe Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, Udhëzimin nr. 1, datë 24.01.2024 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024”, etj.

- Me shkresën nr. 4838/6, datë 03.08.2021 Dega e Thesarit Tiranë ka njoftuar Cirkun Kombëtar për vendosjen e sekuestros conservative të tyre.

-Me Urdhrin nr. 61/3, datë 22.01.2025 Zyra Përmbarimore Private “K.B.S.” SHPK ka urdhëruar Degën e Thesarit Tiranë dhe për dijeni Cirkun Kombëtar mbi:

1. Heqjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e palës debitore Cirkul Kombëtar me NIPT L. dhe llogarinë e Ministrisë së Kulturës, pranë Degës së Thesarit Tiranë.

Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitet 2022-2024.

Institucioni ka përgatitur projektbuxhetin afatmesëm (PBA) sipas kërkesave buxhetore dhe pasqyrave standarde të përcaktuara në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave.

-Me shkresën nr. 205 prot., datë 16.08.2021 është dërguar në Ministrinë e Kulturës (MK) projektbuxheti afatmesëm (PBA 2022-2024) Faza II, në përgjigje të shkresës nr. 3896/2 prot., datë 30.07.2021 të MK, brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 26.02.2021”Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2022 sipas tabelave në vijim:

Tabela nr. 1. Të dhënat e PBA 2022-2024

në 000 lekë

Emërtimi		Buxheti Faktik 2021	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Faza e III PBA 2022
600	Paga	32,600	32,600	32,600	32,600
601	Sigurime Shoqërore	5,400	5,450	5,450	5,450
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,778	6,400	5,400	5,400
604	Transferta Korente të Brendshme	1,100	2,800	1,500	1,500
605	Transferta Korente të Huaja		-	-	-
606	Transferta për Buxhet Familjar & Individ	52			
I	Shpenzime Korrente	44,930	47,250	44,950	44,950
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-
	Shp. Kapitale me financim të brendshëm	-	-	-	-
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	-	-	-	-
II	Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti	-	-	-	-
I+II +III Totali i Shpenzimeve		44,930	47,250	44,950	44,950

Burimi: PBA 2022-2024, Ministria e Kulturës

Analizë e planifikimit dhe përdorimit të fondeve buxhetore për vitet 2022- 2024.

Me shkresën prot..., datë 31.01.2022 është dërguar detajimi i plan buxhetit për vitin 2022.Në total shpenzimet kanë vlerën 44,950 mijë lekë.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit 2022 janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ pakësime) si vijon:

Tabela nr. 2. Ndryshimet e buxhetit 2022

në 000 lekë

Shkresa nr. datë	Përshkrimi	Llog ekonomike	Vlerë
2175 datë 14.04.2022	Akti Normativ nr. 3 datë 12.03.2022	6000000	-1,000
2175 datë 14.04.2022	Akti Normativ nr. 3 datë 12.03.2023	6010000	-70
2175 datë 14.04.2022	Akti Normativ nr. 3 datë 12.03.2024	6020000	-500
5212/4 datë 07.11.2022	Dërgohet miratimi i rialokimit të fondeve buxhetore	6040000	-500
5212/4 datë 07.11.2022	Dërgohet miratimi i rialokimit të fondeve buxhetore	6000000	-500
5704/4 datë 16.11.2022	Dërgohet transferimi i fondeve për shpenzime kapitale	2310000	352
6236/4 datë 22.11.2022	Dërgohet transferimi i fondeve për shpenzime korrente	6000000	-500
6236/4 datë 22.11.2022	Dërgohet transferimi i fondeve për shpenzime korrente	6040000	-500
6236/4 datë 22.11.2022	Dërgohet transferimi i fondeve për shpenzime korrente	6020000	800
6692/1 datë 15.12.2022	Ndryshime	6060000	58

Burimi: Shkresat e Cirkut/Përpunuar nga grupi i auditimit

-Me shkresën nr. 1642 prot., datë 23.03.2022 MK ka kërkuar dërgimin e kërkesave buxhetore për PBA 2023-2025, faza strategjike. Me shkresën nr. 190 prot., datë 11.04.2022 është dërguar në MK projektbuxheti afatmesëm (PBA 2023-2025) brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin, nr. 9, datë 28.02.2022 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Me shkresën nr. 4177/2 prot., datë 12.08.2022 MK ka kërkuar dërgimin e kërkesave buxhetore për PBA 2023-2025, faza teknike dhe me shkresën nr. 299 prot., datë 18.08.2022, është dërguar në MK, PBA 2023-2025, faza teknike brenda afateve të përcaktuara.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2023 sipas tabelave në vijim:

Tabela nr. 3. Të dhënat e PBA 2023-2025

në 000 lekë

Emërtimi		Buxheti Faktik 2022	Faza e I PBA 2023	Faza e II PBA 2023	Faza e III PBA 2023
600	Paga	28,658	32,600	32,600	34,400
601	Sigurime Shoqërore	4,794	5,450	5,450	5,700
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6,918	5,376	5,400	5,812
604	Transferta Korente të Brendshme	-	1,500	1,500	1,500
605	Transferta Korente të Huaja	-	-	-	-
606	Transferta për Buxhet Familjar & Individ	474	24	24	24
I	Shpenzime Korrente	40,844	44,950	44,974	47,436
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-
	Shp. Kapitale me financim të brendshëm	-	-	-	-
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	-
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	-	-	-	-
II	Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti	-	-	-	-
	I+II +III Totali i Shpenzimeve	40,844	44,950	44,974	47,436

Burimi: PBA 2023-2025, Ministria e Kulturë

Me shkresën nr. 7213/3 prot., datë 13.02.2023 është dërguar detajimi i plan buxhetit për vitin 2023, mbështetur në shkresën nr. 23774/175 datë 20.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në total shpenzimet kanë vlerën 47,436 mijë lekë.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit 2023 ka pasur ndryshime në buxhet (shtesa/ pakësime) si vijon:

Tabela nr. 4. Ndryshimet e buxhetit 2023

në 000 lekë

Shkresa nr, datë	VKM nr, datë	Llog ekonomike	Vlerë
7296/2 datë 24.01.2023	898 datë 29.12.2022	6060000	360
3925/1 datë 01.08.2023	Dërgohet transferimi i fondeve shtesë	6000000	7,644
3925/1 datë 01.08.2023	Dërgohet transferimi i fondeve shtesë	6010000	1,528
3577/3 datë 10.08.2023	406 datë 04.07.2023	6040000	362
5816/3 datë 05.12.2023	Dërgohet transferimi i fondeve buxhetore	6020000	4,874
8/5 datë 08.01.2024	Mbi miratimin e detajimit të ndryshimeve të planit të buxhetit për vitin 2023	6000000	-250

Burimi: Shkresat e Cirkut/Përpunuar nga grupi i auditimit

Me shkresën nr. 1847 prot., datë 13.04.2023 MK ka kërkuar dërgimin e kërkesave buxhetore për përgatitjen e PBA 2024-2026, faza strategjike. Me shkresën nr. 77 prot., datë 27.04.2023 titullari i njësisë ka dërguar në MK projekt buxhetin afatmesëm (PBA 2024-2026) brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin, nr. 6, datë 28.02.2023 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

Me shkresën nr. 4043 prot datë 03.08.2023 MK ka kërkuar dërgimin e kërkesave buxhetore për përgatitjen e PBA 2024-2026, faza teknike e cila është dërguar me shkresën nr. 182 prot datë 16.08.2023.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2024 sipas tabelave në vijim.

Tabela nr. 5. Të dhënat e PBA 2024-2026

në 000 lekë

Llog	Emërtimi	Buxheti Faktik 2023	Faza e I PBA 2024	Faza e II PBA 2024	Faza e III PBA 2024
600	Paga	39,575	34,400	34,400	45,186
601	Sigurime Shoqërore	6,634	5,700	5,700	8,112
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	9,745	4,800	4,800	4,800
604	Transferta Korente të Brendshme	1,762	1,500	1,500	1,500
605	Transferta Korente të Huaja		-	-	
606	Transf. për Buxhet Familjar-Individ	253	24	24	24
I	Shpenzime Korrente	57,969	46,424	46,424	61,312
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	
231	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	
	Shp. Kapitale me financim të brendshëm	-	-	-	
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	-	
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	-	-	-	
II	Shpenzime Kapitale	-	-	-	
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti	-	-	-	
	I+II +III Totali i Shpenzimeve	57,969	46,424	46,424	61,312

Burimi: PBA 2024-2026, Ministria e Kulturës

Me shkresën nr. 907 prot., datë 12.02.2024 nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) është dërguar detajimi i planit të buxhetit për vitet 2024-2026. Konkretisht llog. 600 planifikuar në vlerën 53,299 mijë lekë dhe llog. 602 planifikuar në vlerën 6,024 mijë lekë.

Sa i takon detajimit të plan buxhetit për vitin 2024, në total shpenzimet kanë vlerën 59,723 mijë lekë. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit 2024 ka pasur ndryshime në buxhet (shtesa/ pakësime) si vijon:

Tabela nr. 6. Ndryshimet e buxhetit 2024

në 000 lekë

Shkresa nr, datë	Përshkrimi	Llog ekonomike	Vlerë
8911/1 datë 03.07.2024	Transferim fondi për vitin 2024, programi 08220, 08230	6000000	-2,000
8911/1 datë 03.07.2024	Transferim fondi për vitin 2024, programi 08220, 08230	6020000	2,000
14166 datë 08.11.2024	Miratim për transferim fondi në shpenzime korrente, program 08230	6000000	-2,000
17526/40 datë 26.12.2024	Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024 për shpenzimet korrente	6020000	44,329
17526/40 datë 26.12.2024	Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024 për shpenzimet korrente	6000000	-600
17526/40 datë 26.12.2024	Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 5, datë 19.12.2024 për shpenzimet korrente	6010000	-2,000
17605/50 datë 09.01.2025	Dërgohet akordim fond i veçantë për vitin 2024	6060000	60

Burimi: Shkresat e Cirkut/Përpunuar nga grupi i auditimit

Me shkresën nr. 176 prot., datë 11.06.2024, Cirku ka kërkuar transferim fondi nga llogaria 600 në 602 në vlerën 2,000 mijë lekë për pagesën e qirasë së ambienteve.

Me shkresën nr. 318 prot datë 01.10.2024, Cirku ka kërkuar çeljen e një fondi të veçantë prej 153 mijë lekë në masën e një page mujore për një punonjës, me rastin e daljes në pension.

Shpenzimet buxhetore plan dhe fakt sipas viteve dhe zërave të shpenzimeve
(Sipas situacionit të shpenzimeve, akt rakordimeve me thesarin)

Tabela nr. 7. Plani dhe fakti i shpenzimeve vitet 2022-2024

në 000 lekë

Art.	Emërtimi	2022				2023				2024			
		Plan fillest.	Plani përf.	Fakt	%	Plani fillest.	Plani përf.	Fakt	%	Plan fillest.	Plani përf.	Fakt	%
600	Shpenz. personeli	32,600	29,600	28,658	97	34,400	41,121	39,575	96	45,186	43,186	43,143	100
601	Kontrib. sig shoq. shëndet.	5,450	5,083	4,794	94	5,700	7,228	6,634	92	8,112	6,112	6,089	100
602	Shpenz. të tjera	5,000	7,000	6,917	99	5,412	10,886	9,745	90	4,500	52,829	50,798	96
604	Trans. të brendshme	1,500	500		0	1,500	1,862	1,763	95	1,500	1,500	1,299	87
606	Fondi i veçantë		494	474	96	24	288	253	88	24	237	213	90
602/5	Shpenz. të tjera	400	400		0	400				400	300		0
231	Investime		352										
	TOTALI	44,950	43,429	40,843	94	47,436	61,385	57,970	94	59,723	104,165	101,542	97

Burimi: Të dhënat e Cirkut/Përpunuar nga grupi i auditimit

Me shkresën nr. 5704/4 prot., datë 16.11.2022 institucionit i është transferuar fondi buxhetor për kryerjen e investimeve në shumën 352 mijë lekë për ndërtimin e tualeteve të Cirkut. Por ky fond nuk është përdorur dhe për gjithë periudhën e audituar nuk janë kryer shpenzime për investime. Shpenzimet buxhetore të planifikuara kanë ardhur në rritje çdo vit.

Planifikimi përfundimtar për vitin 2024 është rritur me 69.7% krahasuar me vitin 2023.

Për vitet 2022-2024 nga verifikimi i situacionit të shpenzimeve, ka realizim të lartë në llogaritë 600-601 dhe 602. Shpenzimet e personelit (llog 600) zënë % më të madhe të shpenzimeve të planifikuara për çdo vit. Respektivisht për vitin 2022 zënë 68%, për vitin 2023 zënë 66.9% dhe për vitin 2024 zënë 41.5%.

Shpenzimet e personelit gjithashtu zënë % më të madhe të shpenzimeve faktike për çdo vit respektivisht, për vitin 2022 zënë 70%, për vitin 2023 zënë 68.3% dhe për vitin 2024 zënë 42.5%.

-Llogaria 604 “Transferta të brendshme” për vitin 2022, edhe pse fondi i akorduar është 500 mijë lekë, realizimi paraqitet në vlerën 0 lekë. Pra evidentohet mosrealizim i këtij zëri. Për vitin 2023, kjo llogari është planifikuar në vlerën 1,862 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,763 mijë lekë. Gjithashtu për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 1,500 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,299 mijë lekë.

-Llogaria 606 “Fondi i veçantë” për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 494 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 474 mijë lekë. Për vitin 2023 ky zë është llogaritur në vlerën 253 mijë lekë, realizuar në vlerën 88 mijë lekë. Llogaria përfaqëson fondin e alokuar nga buxheti i shtetit për telefonin celular me vlerë 237 mijë lekë për 12- mujorin e vitit 2024 (*destinuar për shpenzimet telefonike celulare te drejtorit*) dhe fondet e pensionit janë realizuar në vlerën 213 mijë lekë.

Për vitin 2022, janë planifikuar shpenzime për investime (llog. 230, 231) në vlerën 352 mijë lekë kurse për vitet e tjera kjo vlerë është 0 lekë.

-Zëri 602 “Shpenzimet e tjera” zë një % të madhe në shpenzimet e planifikuara për çdo vit, respektivisht për vitin 2022 zë 16%, për vitin 2023 zë 17.7% dhe për vitin 2024 zë 50.7%. Për vitin 2024 evidentohet rritje e konsiderueshme në këtë llogari, si rezultat i çeljes së fondit për likuidimin e shpenzimeve përmbarimore me shoqërinë U. SHPK

Ky zë ka një % të madhe në shpenzimet faktike për çdo vit, respektivisht për vitin 2022 zë 16.9%, për vitin 2023 zë 16.8% dhe për vitin 2024 zë 50%.

Me zërin e shpenzimeve 602 për tre vitet janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve operative, ujë, drita, ku rreth 88% të këtyre shpenzimeve e zënë vetëm 3 zëra shpenzimesh (*Shërbimi i sigurisë dhe ruajtjes, Shpenzime ekzekutim vendimesh gjyqësore, Shërbimi qiramarrje ambientesh*). Në analizë ky zë shpenzimesh faktike është trajtuar më poshtë:

Shpenzimet faktike 602 “Shpenzime të tjera”:

Viti 2022

6022 -Shërbimi i sigurisë dhe ruajtjes 1,007 mijë lekë.

6027 -Shpenzime ekzekutim vendimesh gjyqësore 5,338 mijë lekë.

Të dy këto zëra shpenzimesh përbëjnë **92%** të artikullit 602 shpenzime të tjera.

Viti 2023

6026 -Shërbimi qiramarrje ambientesh 3,840 mijë lekë.

6027 -Shpenzime ekzekutim vendimesh gjyqësore 4,861 mijë lekë.

Të dy këto zëra shpenzimesh përbëjnë **89%** të artikullit 602 shpenzime të tjera.

Viti 2024

6026 -Shërbimi qiramarrje ambientesh 4,608 mijë lekë

6027 -Shpenzime ekzekutim vendimesh gjyqësore 2,000 mijë lekë, kurse 42,387 mijë lekë likuiduar në janar 2025.

Të dy këto zëra shpenzimesh përbëjnë **83%** të artikullit 602 shpenzime të tjera.

Vlerat e këtyre shërbimeve (për tre vitet) zënë mbi **88%** të llogarisë 602 shpenzime të tjera.

1.Viti 2022, shpenzimet për zërin “Shërbimi i sigurisë dhe ruajtjes” janë likuiduar në vlerën 1,007 mijë lekë.

Cirku Kombëtar ka lidhur kontratë shërbimi nr.72, datë 25.03.2021 me objekt “*Shërbimi privat i sigurisë fizike*” (Marrëveshje kuadër) me operatorin ekonomik SHPSF “D.S.” SHPK me vlerë 4,375 mijë lekë me TVSH, me afat nga data 26.03.2021 deri 25.03.2022. Vlera e kontratës në

shumën prej 3,368 mijë lekë me TVSH është financuar nga buxheti i vitit 2021 dhe vlera 1,007 mijë lekë me TVSH nga buxheti i vitit 2022.

Referuar kësaj kontrate janë kryer pagesat si vijon:

Tabela nr. 8. Urdhër-shpenzimet për kontratën e shërbimit të sigurisë dhe ruajtjes në 000 lekë

Urdhër- shpenzimi		Fatura nr, datë	Përshkrimi	Vlera
Nr.	Datë			
15	08.02.2022	6/2022, datë 29.01.2022	Shërbimi privat i sigurisë fizike	366
22	15.03.2022	13/2022, datë 28.02.2022	Shërbimi privat i sigurisë fizike	366
29	01.04.2022	15/2022, datë 28.03.2022	Shërbimi privat i sigurisë fizike	275
			Totali	1,007

Burimi: Të dhënat e Cirkut/Përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër rezulton se bashkëngjitur urdhërpagesave ndodhen dhe faturat përkatëse të lëshuara nga operatori ekonomik, konform kushteve të kontratës. Gjithashtu pagesat janë kryer brenda afatit të rënë dakord sipas nenit 7, ku Autoriteti Kontraktor merr përsipër të paguajë kontraktuesin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i faturës.

2. Shërbimi i qiramarrjes dhe shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për të tre vitet.

a. Auditimi i procedurës dhe pagesave të kryera për ekzekutimin e titullit ekzekutiv "Vendim nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë kreditore Shoqëria "U." SHPK dhe palë debitore Cirku Kombëtar.

Për auditimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u shqyrtuan pagesat e kryera për likuidimin e pjesës monetare, tarifave dhe shpenzimeve të kryera sipas zërave të paraqitur nga Zyra Përmbartimore "K.B.S." SHPK me shkresat nr.191/7-0025-21 "Kërkesë për informacion" datë 23.09.2022 dhe nr.191/8-0025-21 "Kërkesë për vëmendje" datë 13.10.2022 shoqëruar me situacionin e shpenzimeve në vlerën 54,586 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua:

-Me Vendimin nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur:

-Pranimi i kërkesë padisë dhe detyrimi i palës së paditur Cirku Kombëtar të ndërpresë posedimin e paligjshëm mbi truallin me sipërfaqe 1073 m². Nr. Pasurie 6/282 Zona Kadastrale 8350 në pronësi të paditësit, shoqëria "U." SH.P.K;

-Detyrimi i palës së paditur Cirku Kombëtar të lirojë dhe dorëzojë sendin, truall me sipërfaqe 1073 m², me Nr. Pasurie 6/282 Zona Kadastrale 8350, në pronësi të palës paditëse Shoqëria "U.", SHPK

-Detyrimi i palës së paditur Cirku Kombëtar të shpërblejë dëmin pasuror paditësit Shoqërisë "U.", SHPK, nga data 12.12.2011 deri në datën 27.05.2019 në vlerën **31,444 mijë lekë** si dhe vlerën mujore të përdorimit të truallit duke filluar nga data 28.05.2019 deri në datën e dorëzimit të tij sipas përlllogaritjes nga ana e shërbimit përmbartimor mbi bazën e vlerës së përdorimit në masën **329 mijë lekë** në muaj.

-Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur. Urdhërohet shërbimi përmbartimor për ekzekutimin e këtij vendimi pas marrjes formë të prerë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqësve.

CK është përfaqësuar në gjykim nga juristi z. D. Z. dhe znj. J. S. por nuk është dokumentuar nëse është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqësve sipas nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka marrë formë të prerë pasi nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve sipas detyrimeve të nenit 451, 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

Veprimet apo mosveprimet e mësipërme rezultojnë në kundërshtim me nenin 443 të Kodit të Procedurës Civile, për të cilën mbajnë përgjegjësi juristët z. D. Z. dhe znj. J. S., kjo edhe në referencë të njoftimit sipas shkresës së shoqërisë përmbarimore “K. B. S.” SHPK, me nr. 454/2, prot. datë 25.06.2020 “Lajmërim për ekzekutim vullnetar të detyrimit”.

Me shkresën nr. 454/6, datë 02.07.2021 shoqëria përmbarimore “K. B. S.” SHPK ka dërguar vendimin drejtuar Cirkut Kombëtar ku njofton “Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të Urdhrit të ekzekutimit vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” pasi është konstatuar se pala debitore nuk ka përbushur detyrimin sipas titullit ekzekutiv dhe urdhrit të ekzekutimit për likuidimin vullnetar të detyrimit brenda afatit 10 ditore nga marrja e njoftimit datë 29.06.2021.

Sa më lart, mosveprimi është në kundërshtim me UMF nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 4 ku “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë database për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumatat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatës. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varet” si dhe pika 9, ku “Në rastin kur njësi shpenzuese nuk ka ndjekur vullnetarisht asnjë nga procedurat e parashikuara në pikat 5 ose 6 të këtij Udhëzimi, atëherë përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit.....”.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 4838/1, datë 23.07.2021 ka vënë në dijeni CK për vënien të sekuestros Konservative në llogarinë e Cirkut Kombëtar për likuidimin në favor të palës kreditore shoqërisë “U.” SHPK.

Zyra përmbarimore “K.B.S.” SH.P.K me shkresat nr. 191/7-0025-21 “Kërkesë për informacion” datë 23.09.2022 ka kërkuar nga Cirkut Kombëtar ta bëjnë me dije për veprimet e ndërmarrja në funksion të shlyerjes së detyrimit kundrejt palës kreditore shoqërisë “U.” SHPK, tarifave dhe shpenzimeve përmbarimore në vlerën **54,538 mijë** lekë e pa specifikuar me zëra të veçantë se çfarë përfaqëson kjo vlerë.

Sipas Zyrës përmbarimore nuk është kthyer përgjigje nga Cirkut Kombëtar dhe për këtë ajo ka dërguar shkresën nr. 191/8-0025-21 datë 13.10.2022 “Kërkesë për vëmendje” shoqëruar me situacionin e shpenzimeve në vlerën **54,586 mijë** lekë me zërat si më poshtë:

Tabela nr. 9. Zërat e shpenzimeve nga zyra përmbarimore në 000 lekë

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Vlera
1	Shpërblimi i dëmit për periudhën 12.12.2011-27.05.2019	31,444
2	Vlera e përdorimit nga data 28.05.2019-28.05.2021, * 329 mijë lekë, vlera mujore e përdorimit. Gjithsej 24 muaj deri në datën 28.05.2021.	7,903
3	Vlera e përdorimit nga data 28.05.2021-20.10.2021	1,537
4	Tarifa përmbarimore respektive si rezultat i shtimit të detyrimit nga data 28.05.2021-20.10.2021	185
5	Shpenzimet gjyqësore	466
6	Tarifa përmbarimore për kryerje veprimi	8,629
7	Tarifa përmbarimore për ekzekutimin e shumës	1,911
8	Faturë për çmontimin e çadrës së Cirkut nga Shoqëria e Ndërtimit	2,000
9	Tarifë eksperti për Hartimin e Raportit të Vlerësimit për vënien në posedim të pasurisë së paluajtshme	180
10	Tarifë eksperti për demolimin e çadrës së cirkut	200
11	Tarifë për rojet e cirkut	84
12	Shpenzime përmbarimore sipas procesverbalit	48
	TOTALI	54,586

Burimi: Të dhënat e Cirkut/Përpunuar nga grupi i auditimit

Sikurse evidentohet, në tabelën e mësipërme janë situacionuar vlera prej **41,350 mijë** lekë si shpërblim dëmi pasuror për paditësin “U.” SHPK si dhe vlera e përdorimit të truallit, sipas

përllogaritjeve të shërbimit përmbarimor, shpenzimet gjyqësore sipas vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me paditës shoqëria “U.” SHPK, pala e paditur Cirkut Kombëtar,

Gjithashtu janë situacionuar vlera prej **13,236 mijë** lekë si tarifa dhe shpenzime përmbarimore për Zyrën përmbarimore “K.B.S.” SHPK, për procedurat e ekzekutimit të titullit ekzekutiv “Vendim nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të cilin nuk lëshohet urdhër ekzekutiv me palë kreditore “U.” SHPK dhe palë debitorë Cirkut Kombëtar.

Në situacion është parashikuar vlera e shpenzimit “*Tarifë eksperti për demolimin e çadrës së cirkut*” në shumën 200 mijë lekë. Pra shpenzimi bëhet për “*Demolim*” dhe jo për “*çmontim*” i cili ruan parametrat funksionalë të çadrës së cirkut.

Vendimi i zyrës përmbarimore nr. 454/31, datë 27.08.2021 për caktimin e ekspertit për çmontimin e Çadrës së Cirkut. Zyra përmbarimore “K.B.S.” SHPK, me shkresën 553/6, datë 23.09.2021 ka venë në dijeni Cirkun Kombëtar se “*Të na bëjë me dije nëse procesi i demolimit do të kryhet nga ana juaj.....*” dhe “*të na propozoni emrin e kompanisë në të kundërt do të caktohet nga ana jonë*”.

Nga MK ka dalë Urdhri nr. 66, datë 09.02.2022 “*Për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të sendeve të inventarizuara të çadrës së demoluar të Cirkut Kombëtar dhe zhvendosjen në ambientet e magazinës*”.

Me urdhrin nr. 267/1, datë 28.09.2022 Nëpunësi i Autorizuar i Përkohshëm i MK znj. Z. B. urdhëron sektorin e burimeve mbështetëse “*Të përdoren fondet e lira në dispozicion të Cirkut Kombëtar për të likuiduar në mënyrë të pjesshme detyrimet kundrejt vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndërmjet Cirkut Kombëtar dhe shoqërisë “U.” SHPK.*”

Tabela nr. 10. Pagesat e kryera për shlyerjen e detyrimeve e shërbimeve përmbarimore në 000 lekë

Urdhër Shpenzimi		Urdhëruesi	Përshkrimi	Lekë	Vendimi gjyqësor	Tarifa përmbar.	Fatura	
Nr.	datë						Nr.	Datë
69	28.09.2022	Z. B.	Shlyerje e pjesshme e vendimit gjyqësor	2,000	2,000	0		
75	24.10.2022	Z. B.	Shlyerje tarifë pjesore përmb.	638	0	638	323	30.9.22
92	07.12.2022	Z. B.	Shlyerje pjesore vendimi gjyqësor	2,700	2,700	0		
8	23.01.2023	Z. B.	Shlyerje tarifë pjesore përmbar.	861	0	861	6	10.01.23
41	12.05.2023	L. Y.	Shlyerje tarife pjesore përmbarimore	484	0	484	212	5.5.23
42	12.05.2023	L. Y.	Likuidim pjesor vendimi gjyqësor	1,516	1,516	0		
7	21.12.2023	L. Y.	Shlyerje tarifë pjesore përmbar.	484	0	484	829	18.12.23
8	21.12.2023	L. Y.	Likuidim pjesor vendimi gjyqësor	1,516	1,516	0		
116	07.11.2024	J. V.	Likuidim vendimi gjyqësor ndaj U.	2,000	2,000	0		
137	20.01.2025	J. V.	Likuid. pjesor vendimi gjyqësor dhe shpenzime përmbar.	42,387	31,617	10,770	Kont. Nr. 353	6.11.24
TOTALI				54,586	41,350	13,236		

Burimi: Të dhënat e Cirkut/Përpunuar nga grupi i auditimit

Me shkresën nr. 11 prot., datë 17.01.2025 ka dalë urdhri nr. 8 “Për shlyerjen totale të detyrimit ndaj shoqërisë ‘U.’ SHPK i titullarit të CK znj. J.V. për kryerjen e pagesës së plotë, të parashikuar në Akt-marrëveshjen nr. 353 prot., datë 05.06.2024 lidhur me shoqërinë “U.” SHPK.

Nga tabela e mësipërme rezulton të jetë likuiduar vlera totale **54,586 mijë** lekë e cila përbëhet: nga vlera **41,350 mijë** lekë për shpërblimin e dëmit pasuror ndaj paditësit “U.” SHPK, vlera e përdorimit të truallit sipas përllogaritjeve të shërbimit përmbarimor, si dhe shpenzimet gjyqësore sipas vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vlera prej **13,236 mijë** lekë, nga të cilat 10,773 mijë lekë përbëjnë tarifa dhe shpenzime përmbarimore dhe 2,463 mijë lekë shpenzime për hartim akt ekspertimi, çmontim çadre etj.

Ekzekutimi i Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është bërë në mënyrë vullnetare por në mënyrë të detyrueshme nga Zyra Përmbartimore “K.B.S.” SHPK, duke sjellë kosto shtesë për buxhetin në vlerën prej **13,236 mijë** lekë si shpenzim pa ekonomikitet.

Referuar urdhër shpenzimeve më sipër, nga Zyra Përmbartimore nuk janë vendosur në dispozicion të Cirkut në çdo rast, faturat për tarifat përmbartimore. Fatura nr. 40, është lëshuar në datën 03.02.2025 nga Zyra Përmbartimore ku përfshihen shpenzimet për zëra: tarifë pjesore përmbartimore, tarifë shpenzime përmbartimore, tarifë për çmontimin e çadresë së Cirkut, tarifa e ekspertit për demolim çadre, tarifë eksperti hartim akti dhe shërbim ruajtje dhe siguri fizike. Në momentin e kryerjes së likuidimit me Urdhër Shpenzimin nr. 137, datë 20.01.2025 sipas akt marrëveshjes nr. 353, datë 06.11.2024, Cirkut nuk ka pasur si dokument justifikues “faturë tatimore” në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar, paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë”, pika 61, ku citohet “*Pagesat ndërmjet njësisve publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet Sistemit të Thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pageses për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës.*”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z.L.Y., znj.J.V., znj.Z.B., znj.R.F. dhe znj.S.B., pasi kanë nënshkruar urdhër pagesat e kryera.

b. Për auditimin e procedurës dhe pagesave të kryera sipas kontratës së qirasë me nr. 45 prot., datë 20.02.2023 midis Cirkut Kombëtar dhe Shoqërisë “D.” SHPK

Midis Cirkut Kombëtar (Qiramarrësi) dhe Shoqërisë “D.” SHPK është lidhur kontrata e qirasë nr. 343, datë 20 shkurt 2023, me objekt dhënien me qira të ambientit me sipërfaqe totale 1084.57 m² të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8260, me adresë pasurie: Rruga “F.B.”, Tiranë, në katin përdhe të Qendrës Tregtare “K.C.”, me afat 1 (një) vit, i cili fillon në datën 01.03.2023 dhe përfundon në datën 28.02.2024.

Çmimi i qirasë për ambientin objekt të kësaj kontrate është 300 mijë lekë në muaj, pa përfshirë TVSH. Përveç qirasë mujore, qiramarrësi gjatë periudhës së qirasë, merr përsipër të paguajë shpenzimet e administrimit në shumën prej 70 mijë lekë/muaj ose në vlerën 84 mijë lekë me TVSH.

Me shkresën nr. 01, datë 05.01.2023 nga z. A.B., ish Drejtor i Cirkut Kombëtar është kërkuar ambient nga Ministria Kulturës ku ndër të tjera : “*të na krijoni kushtet për vazhdimësinë e aktivitetit artistik të cirkut dhe procesit normal të punës së akrobatëve dhe administratës, për gjetjen e një ambienti të përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit të institucionit gjatë vitit 2023*”.

Me shkresën nr. 24/1, datë 05.01.2023 znj. Z.B., Sekretar i Përgjithshëm i MK i ka kërkuar ambiente për institucionin e Cirkut Kombëtar Kryeministritë ku ndër të tjera kërkon: “.....*marrjen në konsideratë të mundësisë për sistemimin e institucionit të Cirkut Kombëtar, në një ambient të përshtatshëm, nga lista e godinave që disponon institucioni i Kryeministritë*”

Me shkresën nr. 24/3, datë 25.01.2023 Sekretar i Përgjithshëm i MK i ka kthyer përgjigje Cirkut Kombëtar ku ndër të tjera sugjeron: “.....*mundësinë e ndjekjes së praktikave të aplikuara nga institucionet e tjera, për procedurat e qiramarrjes së ambienteve nga persona fizikë e juridikë privatë nëse ju e gjykoni të nevojshme*”.

Bazuar në korrespondencat e mësipërme me shkresën nr. 11, datë 13.02.2023 Cirkut Kombëtar ka informuar MK ku ndër të tjera informon: “.....*se jemi në fazën e lidhjes së kësaj kontrate me Qendrën “K.C.”. Bashkëngjitur planimetria e hapësirës që do të merret me qira dhe detajet specifike për hapësirën e kërkuar me qira*”.

Pjesë e dokumentacionit është shkresa nr. 41 prot., datë 13.02.2023 ku drejtori z. A.B. i ka dërguar informacioni Ministrisë së Kulturës ku ndër të tjera citon: “.....i vetmi ambient që është disi më i përshtatshëm për fillimin e shfaqjeve tona dhe mund të konsiderohet i kryer, është salla e teatrit tek qendra “K.C.”. Është e vetmja sallë e lirë momentalisht. Kosto e qirasë së kësaj hapësire është 370,000 lekë në muaj pa TVSH, rreth 341 lekë për m², ku në atë zonë çmimi/m² varion nga 2,000 lekë deri në 3,000 lekë.”

Si rrjedhim në datën 20 shkurt 2023 është lidhur kontrata e qirasë.

Mbi procedurat e kryera për lidhjen e kontratës u konstatua se:

-Nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në VKM-të përkatëse për marrjen me qira të objekteve.

-Cirku Kombëtar nuk ka shpallur njoftimin për të interesuarit/konkurrentët për marrjen me qira të një godine/objekt ndërtimor për ushtrimin e veprimtarisë duke u bazuar në kriteret kualifikuese.

- Nuk është përcaktuar afati kohor për dorëzimin e ofertave konkurruese.

-Nuk është llogaritur sipërfaqja e nevojshme dhe vlera fillestare minimale për konkurrim sipas VKM-së nr. 469 datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore” referuar pasqyrave llogaritëse.

Referuar vlerës minimale bazuar në VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, pika 3, germa c) sipas të cilës “Për 1 m² sipërfaqe për zyrë dhe magazinë, vlera minimale e qirasë mujore është e barabartë me vlerën minimale të qirasë mujore për 1 m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit sipas zonave të Tiranës”, llogaritja rezulton si më poshtë:

Sipas pikës 2 të VKM-së së sipërcituar, vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtesë të dhënë me qira është e barabartë me 0.3% të çmimit të shitjes së saj, e përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Referuar Udhëzimit nr. 3 datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, tabelës nr. 3 ‘Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2016’ për zonën 5/4, ku bën pjesë dhe prona e marrë me qira, çmimi është 82,000 lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi. Llogaritja e vlerës minimale të qirasë mujore është:

-çmimi i shitjes/metër katror të ndërtesës është 82,000 lekë m² dhe sipërfaqja e ambientit të marrë me qira është 1084.57 m².

-vlera minimale e qirasë mujorë, për m² është:

$$82,000 \cdot 0.3\% = 246 \text{ lekë/m}^2$$

Vlera minimale e qirasë mujorë, për ambientin e marrë me qira duhet të ishte:

$$- 1084.57 \text{ m}^2 \cdot 246 \text{ lekë/m}^2 = 266,804.22 \text{ lekë}$$

$$- 266,804.22 \text{ lekë në muaj} \times 12 \text{ muaj} = 3,201,650.64 \text{ lekë/për 24 muaj} = 6,403,301 \text{ lekë.}$$

Sa llogaritur më lart, vlera minimale e qirasë mujore për ambientin objekt kontrate duhet të ishte 266,804.22 lekë në muaj dhe jo 300,000 lekë në muaj.

Diferenca prej 796,699 lekë/vit përbën shpenzime pa efektivitet dhe ekonomikitet, pasi nëse do të ishte shpallur procedura e njoftimit për marrje me qira ambienti dhe çmimi minimal, mund të kishte ofertues me këtë vlerë reference. Për veprimet apo mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. A.B.

Midis Cirkut Kombëtar dhe Shoqërisë “D.” SHPK, është **rinovuar** (sipas nenit 3) kontrata e qirasë duke u rilidhur me afati 1 (një) vit, i cili fillon në datën 01.03.2024 dhe përfundon në datën 28.02.2025.

Për periudhën 03.2023 – 03.2024 (12 mujore) janë likuiduar shumat si më poshtë:

Tabela nr. 11. Likuidimet për kontratën e qirasë

në 000 lekë

Urdhër Pagesat		Qira ambienti	Urdhër Pagesat		Administrimi (me TVSH)
Nr.	Datë		Nr.	Datë	
31	11.04.2023	300	32	11.04.2023	84
43	11.05.2023	300	44	12.05.2023	84
53	13.06.2023	300	54	13.06.2023	84
69	18.07.2023	300	70	18.07.2023	84
72	15.08.2023	300	71	15.08.2023	84
3	20.12.2023	1,500	4	20.02.2023	420
40	07.02.2024	300	41	07.02.2024	84
117	07.11.2024	300	118	07.11.2024	84
TOTALI		3,600			1,008

Burimi: Cirkul/Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga rakordimi me urdhër shpenzimet rezulton se për kontratën e qirasë nr. 45, datë 20.02.2023 i janë likuiduar subjektit "D." SHPK për një periudhë 12 mujore, vlera e qirasë prej 3,600 mijë lekë si dhe sipas nenit 4 të kontratës janë likuiduar shpenzimet e administrimit për një periudhë 12 mujore në vlerën 1,008 mijë lekë me TVSH. Çmimi i qirasë për ambientin objekt të kësaj kontrate është 300 mijë lekë në muaj. Në këtë çmim nuk përfshihet TVSH. Përveç qirasë mujore, qiramarrësi gjatë periudhës së qirasë, merr përsipër të paguajë shpenzimet e administrimit në shumën prej 70 mijë lekë në muaj së bashku me TVSH në vlerë totale 84 mijë lekë.

Për 2 kontrata e mësipërme janë kryer likuidimet me urdhër pagesat si vijon:

Tabela nr. 12. Likuidimi i faturave të qirasë me vonesë

në 000 lekë

Urdhër-shpenzimi		Fatura		Qira ambienti	Likuidimi
Nr	Datë	Nr	Datë		
31	11.04.2023	252/2023	09.03.2023	300	me vonesë
43	11.05.2023	334/2023	09.04.2023	300	me vonesë
54	13.06.2023	419/2023	04.05.2023	300	me vonesë
69	18.07.2023	504/2023	10.06.2023	300	me vonesë
72	15.08.2023	548/2023	10.07.2023	300	me vonesë
3	20.12.2023	641/2023; 731/2023; 819/2023; 908/2023; 1003/2023	03.08.2023 07.09.2023 03.10.2023 03.11.2023 07.12.2023	1,500	me vonesë
40	07.02.2024		Nov-24 11.01.2024	300	me vonesë
117	07.11.2024	102/2024; 217/2024; 300/2024; 402/2024; 492/2024; 584/2024; 672/2024; 758/2024; 14/2024; 96/2024;	05.02.2024 11.03.2024 03.04.2024 10.05.2024 06.06.2024 01.07.2024 01.08.2024 04.09.2024 07.10.2024 05.11.2024	3,000	me vonesë faturat shkurt- nëntor
132	27.12.2024	189/2024	02.12.2024	300	likuiduar në kohë
TOTALI				6,600	

Burimi: Shkresat e Cirkul/Përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela nr. 13. Likuidimi i shpenzimeve të administrimit

në 000 lekë

Urdhër-shpenzimi		Fatura		Pagesa Adminstrimi	Likuidimi
Nr	Datë	Nr	Datë		
32	11.01.2023	253/2023	09.03.2023	84	me vonesë
44	12.05.2023	335/2023	04.04.2023	84	me vonesë

53	13.06.2023	420/2023	04.05.2023	84	me vonesë
70	18.07.2023	505/2023	10.06.2023	84	me vonesë
71	15.08.2023	549/2023	10.07.2023	84	me vonesë
4	20.12.2023	642/2023; 732/2023; 820/2023; 909/2023; 1004/2023	03.08.2023; 07.09.2023; 03.10.2023; 03.11.2023; 07.12.2023	420	me vonesë
41	07.02.2024	Dec-24	11.01.2024	84	me vonesë
118	07.11.2024	103/2024; 218/2024; 301/2024; 403/2024; 493/2024; 585/2024; 673/2024; 759/2024; 15/2024; 97/2024	05.02.2024; 11.03.2024; 03.04.2024; 10.05.2024; 06.06.2024; 01.07.2024; 01.08.2024; 04.09.2024; 07.10.2024; 05.11.2024	840	me vonesë
131	27.12.2024	190/2024	02.12.2024	84	në kohë
TOTALI				1,848	

Burimi: Shkresat e Cirkut/Përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar sa më sipër, nga auditimi i faturave të likuiduara për qiranë, rezultojnë se likuidimi është kryer me vonesë në tejkalim të afateve të përcaktuara në kontratën e qirasë, neni 4, pika 1 ku citohet “*Qiramarrësi do t’i paguajë qiradhënësit qiranë mujore të përcaktuara brenda datës 5 të çdo muaji*” si dhe neni 4 pika 5 “*Në qoftë se qiraja dhe pagesa e administrimit nuk do të paguhen në afatin e përcaktuar në kontratë, Qiramarrësi detyrohet të paguajë një penalitet në masën 1% të qerasë mujore, i cili do të llogaritet për çdo ditë vonesë.*”

Gjithashtu nga krahasimi i datës së faturës tatimore dhe datës së likuidimit, rezultojnë se janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor, duke shkelur disiplinën ligjore.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 52 ku citohet...“*specifikohet se Nëpunësi zbatues i njëjtit shpenzues të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OEsë,* si dhe Ligjin nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” neni 7.

Nga dokumentacioni bashkëngjitur evidentohet se llogaritë e Cirkut Kombëtar kanë qenë të sekuestruara si rezultat i fillimit të procedurave për ekzekutimin e titullit ekzekutiv “Vendimi nr. 8473, datë 17.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” me palë kreditore “U.” SHPK Duke qenë se midis palës kreditore dhe Cirkut është lidhur një akt marrëveshje me këste për vlerën e mbetur të detyrimit, Zyra Përmbarimore me shkresën nr, 40/13 datë 06.11.2024 ka lejuar që pala debitorë nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë të kryejë pagesa në vlerën totale 4,700 mijë lekë (për qira të prapambetur, likuidim të faturave të energjisë elektrike, kancelari dhe paga punonjësish)

Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit

Në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendore”, përcaktohet:

“Pika 17. Nëpunësi autorizues, ka përgjegjësi të raportojë te Nëpunësi i Parë Autorizues në mënyrë periodike çdo katër muaj, por jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm, sipas formateve dhe standardeve të vendosura konform këtij udhëzimi.”

Gjithashtu dhe në Udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendore”, pika 18 parashikohet si më sipër.

Për vitet 2022-2023 nuk janë hartuar relacione mbi monitorimin e buxhetit, vetëm tabelat e ankeseve.

Për vitin 2022 janë hartuar anekset e monitorimit të buxhetit 4 mujore në datë 16.05.2022 dhe më pas është vijuar me anekset 12 mujore në datë 07.02.2023. Në këtë aneks nuk është paraqitur vlera në llogarinë 231, si rrjedhojë ka diferenca midis raportimit të anekseve të monitorimit dhe rakordimit të bërë me thesarin me shkresën nr. 17 prot., datë 23.01.2023.

Cirku Kombëtar ka hartuar 2 anekse monitorimi buxheti (katër mujor dhe 8 mujor) për zbatimin e buxhetit të vitit 2023. *Shkresat e dërgimit të raporteve të monitorimit ndër vite të sipërcituara nuk u vendosën në dispozicion të grupit të auditimit.*

Për vitin 2024 me shkresën nr. 315 prot datë 25.09.2024 është dërguar relacioni 8 mujor për monitorimin e zbatimit të buxhetit. Si dhe është dërguar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit relacioni për monitorimin e zbatimit të buxhetit 12 mujor. Buxheti total i planifikuar dhe i realizuar për vitin 2024, shprehur në këtë relacion ka diferenca me buxhetin e planifikuar dhe realizuar sipas rakordimeve me thesarin. Përkatësisht planifikimi në vlerën 100,030 lekë dhe fakti në vlerën 100,000 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 dhe Udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendore” dhe është përgjegjësi e znj.S.B., znj. R.F., z. A.B., z. L.Y., znj J.V.për periudhat respektive.


Gjithashtu në bazë të statutit të Cirkut neni 3, pika 2 “*Kompetencat e Cirkut*” përcaktohet se Cirku ka kompetencë të shpallë publikisht në fillim të çdo viti fondin publik të institucionit, jo më vonë se 1 (një) muaj pas përcaktimit me hollësi të buxhetit të shtetit”, e cila është kompetencë dhe përgjegjësi e titullarit të institucionit që nuk është përmbushur për vitet objekt auditimi 2022-2024.

2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Respektimi i strukturës organike dhe krahasimi me faktin.

Struktura organike e CK për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 deri me datë 31.12.2024) ka funksionuar në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.134, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Cirkut Kombëtar”, me një numër total punonjësish 38 veta.

Struktura e CK është e organizuar sipas skemës:



Burimi: CK/përpunuar të dhënat nga KLSH

Nga auditimi:

Për vitin 2022, numri total i punonjësve në strukturë sipas Urdhrit Nr. 134, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Cirkut Kombëtar”, ishte **38** (plani), ndërsa numri faktik i punonjësve rezultoi **37** (fakti) në Janar 2022 dhe **32** (fakti) në Dhjetor 2022.

Gjatë vitit 2022, ka patur 1 punësim dhe 6 largime nga puna.

Për vitin 2023, numri total i punonjësve në strukturë ishte **38** (plani), ndërsa numri faktik i punonjësve rezultoi **32** (fakti) në Janar 2023 dhe **30** (fakti) në Dhjetor 2023.

Gjatë vitit 2023, ka patur 5 punësime dhe 7 largime nga puna.

Për vitin 2024, numri total i punonjësve në strukturë ishte **38** (plani), ndërsa numri faktik i punonjësve rezultoi **30** (fakti) në fillim Janar 2024 dhe **33** (fakti) në Dhjetor 2024.

Gjatë vitit 2024, ka patur 6 punësime dhe 3 largime nga puna.

Referuar të dhënave të marra nga CK (Sektori i Shërbimeve Mbështetëse) për vitin 2022 numri i vendeve të lira/vakante në Janar 2022 rezultoi **1** (pozicioni i Drejtorit të Cirkut) dhe në Dhjetor 2022 rezultoi **6** vende vakante.

Vendi i Drejtorit gjatë vitit 2022 ka qenë vakant dhe është plotësuar me delegim, respektivisht për periudhën Janar 2022 deri Gusht 2022 i është deleguar z.A. H., sipas Urdhrit të Ministrit të Kulturës (MK) Nr.845, datë 29.12.2021. Për periudhën Shtator 2022 deri Dhjetor 2022 i është ngarkuar përkohësisht detyra e Drejtorit të Cirkut Kombëtar z.A. B., sipas Urdhrit të MK Nr.579, datë 31.08.2022.

Numri i vende të lira/vakante sipas strukturës organike në total në dhjetor 2022 të ndarë sipas sektorëve në strukturë paraqiten:

Drejtor:	1
Mjeshtër cirku:	1
Akrobat i parë:	2
Orkestrant i parë:	1
Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme (mekanik):	1
Totali	6

Për vitin 2023 numri i vendeve të lira/vakante në Janar 2023 rezultoi **6** dhe në Dhjetor 2023 rezultoi **8**.

Drejtori i Cirkut Kombëtar është emëruar me VKM Nr.229 datë 13.04.2023, Z. L.Y., në përputhje me VKM Nr.173, datë 07.03.2003 “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”.

Numri i vende të lira/vakante sipas strukturës organike në total në dhjetor 2023 të ndarë sipas sektorëve në strukturë paraqiten:

Drejtues artistik:	1
Mjeshtër cirku:	2
Akrobat i dytë:	3
Përgjegjës sektori Teknik:	1
Elektracist/ndriçimi/fonist:	1
Totali	8

Për vitin 2024 numri i vendeve të lira/vakante në fillim Janar 2024 rezultoi **8** dhe në Dhjetor 2024 rezultoi **5**.

Sipas VKM Nr.584 datë 25.09.2024 z. L.Y. është liruar nga detyra si Drejtor i Cirkut Kombëtar. Për periudhën 18.9.2024-16.10.2024 me Urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Nr.707, datë 18.9.2024, “Për ngarkimin e përkohshëm me detyrën e drejtorit të Cirkut”, është emëruar z.M.Q. MEKI me datë 18.09.2024 ka shpallur konkurrimin për vend vakant Drejtor i Cirkut Kombëtar. Me VKM Nr.652 datë 16.10.2024 znj.J.V. është

emëruar Drejtore e Cirkut Kombëtar. Procedurat e ndjekura për ndryshimin e Drejtorit të Cirkut Kombëtar janë në përputhje me VKM Nr.173, datë 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”.

Numri i vende të lira/vakante sipas strukturës organike në total në dhjetor 2024 të ndarë sipas sektorëve në strukturë paraqiten:

Drejtues artistik:	1
Mjeshtër cirku:	1
Akrobat i dytë:	3
Totali	5

Planifikimi rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve.

Lidhur me procedurat e rekrutimit të punonjësve, në Rregulloren e brendshme Nr.116 prot, datë 11.3.2013 përcaktohet se punonjësit e CK punësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me konkurs dhe pas kalimit të periudhës së provës. Rregullorja e protokolluar me shkresën Nr.116 prot, datë 20.03.2024, përcakton se njoftimet për pozicionet e lira të punës publikohen në faqen zyrtare të Cirkut Kombëtar/Buletiniv e Njoftimeve Publike si dhe i komunikohen Ministrisë përgjegjëse. Verifikimi i plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit kryhet sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme.

Për vitin 2022, ka patur vetëm 1 rekrutim sipas tabelës Nr.1 në aneks, deri në dhjetor 2022 rezulton se struktura nuk ka qenë e plotësuar sipas strukturës së miratuar, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk administrohet asnjë procedurë rekrutimi e ndjekur për këtë rekrutim.

Për vitin 2023, ka patur 4 rekrutime të reja sipas tabelës Nr.2 në aneks, gjithashtu dhe për këtë periudhë nuk ka qenë e plotësuar sipas strukturës së miratuar.

Për 4 vende vakante në gusht 2023, CK i ka dërguar MK shkresën Nr.181 prot., datë 16.08.2023, me anë të së cilës i kërkon një përfaqësues si anëtar komisioni. Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit ka njoftuar (vënë në dijeni) MK me shkresën Nr.181/3 prot., datë 22.09.2023, ku i ka bashkëlidhur dhe procesverbalin e komisionit të vlerësimit vetëm për sektorin artistik.

CK i ka dërguar me shkresën Nr.184 prot., datë 05.09.2023, Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), kërkesë për shpallje të vendeve vakante, por pa vendosur kriteret për rekrutim. APP me shkresën Nr.6448/1 prot., datë 22.08.2023 i ka kërkuar CK të dërgojë në formë të shkruar dhe elektronike shkresën së bashku me kriteret. Nga CK rezulton që nuk ka një shkresë zyrtare dërguar APP-së, dhe nuk administrohet dokumentacioni i publikimit të njoftimit.

Për 1 vend vakant (mekanik) në tetor-nëntor 2023 i ka dërguar APP-së shkresën Nr.326 prot., datë 15.11.2023, kërkesë për shpallje të vendeve vakante. APP me shkresën Nr.8705/1 prot., datë 20.11.2023 i ka kërkuar CK të dërgojë në formë të shkruar dhe elektronike shkresën së bashku me kriteret. Nga CK rezulton që nuk ka një shkresë zyrtare dërguar APP-së, dhe nuk administrohet dokumentacioni i publikimit të njoftimit.

Konstatim: CK nuk ka njoftuar Ministrinë përgjegjëse mbi publikimin e njoftimit për vendet vakante të Institucionit, gjithashtu në një rast u evidentua se dokumentacioni i vënë në dispozicion ka parregullsi në lidhje me rendin kronologjik të numrave të protokollit.

Për vitin 2024, ka patur 2 rekrutime të reja sipas tabelës Nr.3 në aneks, gjithashtu dhe për këtë periudhë nuk ka qenë e plotësuar sipas strukturës së miratuar.

Në periudhën nëntor-dhjetor 2024 ka filluar publikimin e vendeve vakante në faqen e MEKI, por nuk i përkasin rekrutimeve të vitit 2024.

Konstatim:

CK nuk ka plotësuar strukturën e miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr.134, datë 28.03.2014. Vendet vakante për periudhën 2022-2024, nuk janë shpallur në faqen zyrtare të

Ministrisë përgjegjëse, pasi vetë institucioni nuk disponon një faqe zyrtare në ueb, ose në Buletin njoftime publike për vende vakante.⁴

Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me:

-nenin 9, shkronjën a, pika 5, të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë,” ku cilësohet: “...Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë...”;

-nenin 12, shkronjën a dhe b, pika 1, të Ligjit Nr.10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (i ndryshuar), ku cilësohet: “...Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve...”;

-nenin 5, të Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku cilësohet: “...Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të..”.

-nenin 9, shkronjën dh, pika 4, të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku cilësohet: “...Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: ...dh) mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin...”;

-nenin 4 të rregullores së brendshme, protokolluar me shkresën Nr.116 prot., datë 11.03.2013, ku cilësohet: “Punonjësit e Cirkut Kombëtar, punësohen në mënyrë të drejtpërdrejt, me konkurs.”

-nenin 4 të rregullores së brendshme, protokolluar me shkresën Nr.71 prot., datë 20.03.2024, ku cilësohet: “Punësimi mund të kryhet nëpërmjet përzgjedhjes sipas procedurës së konkurrimit publik: a) Procedurat e konkurrimit zhvillohen me nismën e institucionit kur konstatohen pozicione të lira pune në strukturë.”

Sa sipër ngarkohen me përgjegjësi, titullarët e Institucionit sipas periudhave respektive.

Për periudhën objekt auditimi, disa pozicione në CK nuk janë mbuluar nga struktura e miratuar, për të cilat janë paraqitur në kërkesat buxhetore sipas PBA 2023-2025, përcjellë Drejtorisë së Buxhetit, Investimeve dhe Financës në MK me shkresën Nr.299 prot., datë 18.08.2022, dhe në PBA 2024-2025 me shkresën Nr.77 prot., datë 27.04.2023. Pozicionet që nuk janë të përfshirë në strukturë, për të cilat janë kërkuar në PBA respektive, janë sanitar, marangoz dhe jurist. Në kërkesat buxhetore të dorëzuara nuk është specifikuar numri i punonjësve të sipërcituar për vitin korrent, por vetëm në dy vite pasardhëse.

Për periudhën 2022-2024, sipas VKM Nr. 35, datë 19.1.2022, VKM Nr. 56, datë 01.02.2023 dhe VKM Nr.39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, në njësitë e qeverisjes qendrore”, është miratuar vetëm një punonjës sanitar për periudhën Janar–Tetor 2022-2024. Periudhën e mbetur është mbuluar duke lidhur kontrata shërbimi me punonjës sanitar, me afat 3 muajor.

Për vitin 2024, Drejtori i Cirkut Kombëtar i ka dërguar MEKI-it shkresën Nr. 334 prot., datë 28.10.2024, duke njoftuar nisur nga nevoja urgjente që ka CK për lidhjen e tre kontratave shërbimi për një punonjës pastrimi, një jurist dhe një arkivist. MEKI me shkresën Nr.13705/1 prot., datë 18.11.2024 i ka kthyer përgjigje CK, duke u shprehur që këto punonjës sezonal të

⁴ Mos publikimi i vendeve vakante është konstatuar dhe në raportin përfundimtar të Auditit të brendshëm të kryer nga MK me nr.4414/7 prot., datë 26.12.2023.

përfshihen në planifikimin e punonjësve sezonal për vitin 2025. Kontratat e lidhura për punonjësit me kontratë të përkohshme është kryer para përgjigjes nga MEKI, dhe pa miratim e Ministrisë së Financave.

Për pozicionin e juristit, CK ka lidhur kontrata shërbimi me afat 3 mujor, si më poshtë:

- 1- Kontrata Nr.295 prot., datë 20.10.2023;
- 2- Kontrata Nr.39 prot., datë 07.02.2024;
- 3- Kontrata Nr.150 prot., datë 21.05.2024;
- 4- Kontrata Nr.338 prot., datë 29.10.2024.

Gjithashtu në vitin 2024 është lidhur kontrata e angazhimit për një arkiviste me Nr. 348 prot., datë 05.11.2024, me afat 3 muaj.

Konstatim:

☛ Pozicioni i juristit i cili nuk është i përfshirë në strukturë, është kryer duke lidhur kontratat e shërbimit të cituar sa më sipër. Për përzgjedhjen e personave në këtë pozicion nuk ka kriteret vlerësimi dhe nuk ka publikime në faqen zyrtare të Ministrisë përgjegjëse, pasi vetë institucioni nuk disponon një faqe zyrtare në ëeb ose në Buletin njoftime publike. Çmimi i shërbimit për juristin nuk ka një referencë ligjore.

Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me:

-pikën 5,6,7 të VKM Nr.109 datë 6.3.2019, ku cilësohet: *“...5.Kërkesa për punonjës me kontratë të përkohshme bëhet vetëm kur institucioni disponon fondet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të këtyre punonjësve dhe, si rregull, kjo kërkesë paraqitet pas miratimit të ligjit të buxhetit të vitit pasardhës kalendarik. kërkesa paraqitet pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e argumentuar dhe e shoqëruar me informacion të detajuar mbi numrin e punonjësve, pozicionin e punës dhe afatin kohor të kontraktimit. Pas shqyrtimit të kërkesave të paraqitura, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i dërgon për miratim në Këshillin e Ministrave. 6. Punonjësi me kontratë të përkohshme merren në punë në përputhje me kriteret e parashikuara për atë vend pune 7. Paga e punonjësit me kontratë të përkohshme përcaktohet në referencë të vendimit përkatës Këshillit të Ministrave, për pozicionin për të cilin ai kontraktohet. Për pozicionin “specialist”, paga e punonjësit me kontratë të përkohshme përcaktohet referuar kategorisë më të ulët të pagës së këtij pozicioni, në institucionin në të cilin ai kontraktohet...”*

-nenin 5, të ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku cilësohet: *“...Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të..”*

Sa sipër ngarkohen me përgjegjësi, titullarët e Institucionit sipas periudhave respektive.

Largimet nga puna.

Për vitin 2022, numri i punonjësve të larguar nga puna në total është **6** punonjës, respektivisht numri i punonjësve që kanë mbushur moshën për pension në këtë vit është **2**, numri i punonjësve të larguar nga puna me zgjidhje kontrate është **1**, për të cilin nuk administrohet dokumentacion nga CK. Punonjës të larguar si pasojë e përfundimit të kontratës janë **1**, me kërkesë për dorëheqje **2**.

Për vitin 2023, numri i punonjësve të larguar nga puna në total është **7** punonjës, respektivisht numri i punonjësve që kanë mbushur moshën për pension në këtë vit është **2**. Punonjës të larguar si pasojë e përfundimit të kontratës janë **1**, me kërkesë për dorëheqje **1** dhe **3** punonjës larguar nga puna me masë disiplinore për të cilën ka ankimim në gjykatë në proces.

Për vitin 2024, numri i punonjësve të larguar nga puna në total është **3** punonjës, respektivisht numri i punonjësve që kanë mbushur moshën për pension në këtë vit është **1**. Punonjës të larguar me VKM (drejtori) **1**, dhe me kërkesë për dorëheqje **1**.

Konstatim:

Lidhur me procedurat e largimeve nga puna, për periudhën 2022-2024 nuk është realizuar

dorëzimi me procesverbal i aktiveve dhe i dokumentacionit zyrtar në ngarkim të personelit të larguar nga puna. Veprime jo në përputhje me nenin 11, pika 4, të ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar), ku cilësohet: “...Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për: 4. Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar...”.

si dhe veprime jo në përputhje me pikën 13, të udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku cilësohet: “...Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i Njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkaqe objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga Nëpunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit...”

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullarët e Institucionit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Specialisti i Protokoll/Arkivit sipas periudhave respektive.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Për auditimin mbi procedurat e administrimit të dokumentacionit në dosjet e personelit, u përzgjedhën 9 dosje personeli. Dokumentacioni që administrohen në dosje, në përgjithësi janë në përputhje me VKM Nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

CK ka lidhur kontratën kolektive e punës me sindikatën e pavarur të artistëve dhe punonjësve, protokolluar me Nr.261 prot., datë 01.06.2013.

Konstatim:

☛ Kontratat e lidhura janë me afat të përcaktuar ose nuk janë rinovuar⁵, sipas tabelës 4 në aneks veprime jo në përputhje me nenin 147, pika 2, e Ligjit Nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku cilësohet: “Kontrata e punës lidhet për një periudhë të pacaktuar. Lidhja e kontratës së punës për një periudhë të caktuar duhet të justifikohet me arsye objektive, që lidhen me natyrën e përkohshme të detyrës në të cilën punëmarrësi do të punësohet”.

☛ Në kontratat individuale të punës të përzgjedhura të punonjësve të CK dhe kontratat për rekrutimet e reja, u konstatua se kontratat nuk përmbanin të gjithë elementët e kërkuar sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Përkatësisht mungonin, identiteti i palëve duke mos specifikuar gjeneralitet e palës, veprime këto jo në përputhje me nenin 21, pika 3, e Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku cilësohet: “...Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos: a) identitetin e palëve; ...”.

☛ Në dosjet e personelit mungojnë vlerësimet e performancës në punë, në kundërshtim me nenin 15 të kontratave individuale Vlerësimi i performancës në punë, ku cilësohet: “...Punëmarrësi i nënshtrohet vlerësimit të performancës së punës së tij çdo gjashtë muaj...”, dhe në kundërshtim me nenin 4.4 të rregullores së brendshme Nr.71 prot., datë 20.03.2024 “Vlerësimi i performancës në punë”, ku cilësohet: “...1. Vlerësimi i performancës është procesi vjetor i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave, realizimi i punës me cilësi dhe në kohë, marrëdhëniet kolegjiale, si dhe i aftësive apo dobësive të punonjësve në kryerjen e detyrave;2.Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që përsëritet një herë në vit, në periudhën midis datës 31 Tetor-15 Nëntor..”.

⁵ Kontratat me afat të përcaktuar është konstatuar dhe në raportin përfundimtar të Auditit të brendshëm të kryer nga MK me nr.4414/7 prot., datë 26.12.2023.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullarët e Institucionit dhe përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse sipas periudhave respektive.

Auditimi mbi përputhshmërinë ligjore të pagave.

Për periudhën objekt auditimi janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e pagave. U audituan me përzgjedhje listëpagesat e muajve Shtator-Tetor 2023, si dhe Shtator-Tetor 2024. Nga auditimi i listëpagesave u konstatua se përlllogaritjet e pagave janë kryer sipas bazës ligjore në fuqi, dhe në listpagesën e dorëzuar kollona “Detyra, Funkcioni, Profesionit apo Puna që ka kryer punonjësi” përputhen kodet sipas VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”.

Në sektorin e financës, lidhur me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të mbledhura nga punëmarrësi e punëdhënësi dhe tatimit mbi të ardhurat, është zbatuar ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Konstatim:

☛ Nga auditimi me përzgjedhje i listë pagesave rezultoi se për vitin 2023 listë pagesat nuk janë shoqëruar me listëprezencat në punë, ndërsa për vitin 2024 rezulton se listë prezencat janë të përgatitura nga dirigjenti / drejtuesi artistik dhe janë nënshkruar nga Drejtori i CK, por kanë mospërputhje ndërmjet numrit të punonjësve në listë prezencë dhe numrit punonjësve në listë pagese, veprime këto jo në përputhje me pika 1 dhe 5, e Udhëzimit Nr.1, datë 21.05.2021, “Për formën, elementët dhe plotësimin e listë pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ku cilësohet: “...1. Forma e listë pagesës mujore të pagave për të punësuarit e njëjsteve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të punësuarit me kontratë të përkohëshme pune të kontraktuar mbi numrin organik të njëjsteve të qeverisjes së përgjithshme, si dhe për studentët dhe specializantët e sistemeve që kanë të tillë, përcaktohet në lidhjen Nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij...”

5. Shpjegimi për rrugën dhe hapat që duhen ndjekur për përgatitjen e listëpagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit të pagave, përcaktohen në lidhjen Nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.”

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues sipas periudhave respektive.

Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre.

Nga auditimi:

Për vitin 2022 deri në 2024, ka patur 4 largime nga puna me masë disiplinore, nga të cilat:

- 1 (një) larguar për mosparaqitje në punë.

- 3 (tre) largime me Urdhër respektive, Urdhër Nr. 60, datë 03.11.2023, “Për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës për shkaqe të justifikuara për mjeshtrin e profilit znj A.H.”, Urdhër Nr. 61, datë 03.11.2023, “Për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës për shkaqe të justifikuara për mjeshtrin e profilit z. U.Xh” dhe Urdhër Nr. 62, datë 03.11.2023, “Për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës për shkaqe të justifikuara për mjeshtrin e profilit z. Xh.K.”.

Për 3 largimet e mësipërme me masë disiplinore, është ankimuar në Gjykatë me kërkesë padinë me Nr. regjistrimi 14866, datë 20.06.2024, me objekt zbatimin e urdhërave të MK me Nr. 836, 841, 842 dhe dëmshpërblim për pagat e munguara nga data 3.11.2023. Ankimimi është akoma në proces gjyqësor.

Në lidhje me largimet e sipërcituara MK me Urdhër Nr.756 prot., datë 22.11.2023 ka urdhëruar ngritjen e komisionit për kryerjen e hetimit administrativ me komision me përbërje znj. F.Gj., znj. M. T. dhe znj. I. M.

MK i ka dërguar CK me shkresën Nr.6019/6 prot., datë 29.12.2023 raportin e grupit të punës mbi përfundimin e hetimit administrativ në CK dhe Urdhrin Nr.836 datë 19.12.2023 për shfuqizimin e Urdhrit Nr.62 datë 03.11.2023, Urdhrin Nr.841 datë 19.12.2023 për shfuqizimin e Urdhrit Nr.61 datë 03.11.2023 dhe Urdhrin Nr.842 datë 19.12.2023 për shfuqizimin e Urdhrit Nr.60.

CK ka kundërshtuar urdhrat e MK me shkresën Nr. 07 Prot., datë 11.01.2024.

CK me shkresën Nr.47/2 prot, datë 14.11.2024, dërguar MEKI-t ka njoftuar se ka rikthyer në punë tre punonjësit sipas Urdhrave të mëposhtëm:

Urdhri Nr.80 datë 07.11.2024 në zbatim të urdhrit Nr.841, Urdhri Nr.81 datë 07.11.2024 në zbatim të urdhrit Nr.836 dhe Urdhri Nr.82 datë 07.11.2024 në zbatim të urdhrit Nr.842 dhe janë lidhur kontratat individuale respektive.

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 deri në 31.12.2024 struktura organike rezulton të jetë e paplotësuar:

☛ CK nuk ka plotësuar vendet vakante sipas strukturës së miratuar, dhe nuk ka publikimin e vendeve vakante;

☛ Për përzgjedhjen e personave në pozicionin e juristit nuk ka kritere vlerësimi dhe nuk ka publikime dhe çmimi i shërbimit nuk ka një referencë ligjore.

☛ Disa nga kontratat e lidhura të administruara në dosje janë me afat të përcaktuar ose nuk janë rinovuar, kontratat nuk përmbanin të gjithë elementët e kërkuar sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe mungojnë vlerësimet e performancës në punë të punonjësve.

☛ Mungojnë dorëzimet me procesverbal i aktiveve dhe i dokumentacionit zyrtar në ngarkim të personelit të larguar nga puna.

☛ Në vitin 2023 listepagesat e përzgjedhura nuk janë shoqëruar me listëprezencat në punë, dhe për vitin 2024 listepagesat me listeprezencat respektive të përzgjedhura kanë mospërputhje të numrit të punonjësve.

2.3.Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare.

Në zbatim të programit të auditimit, pika nr. 3 “Auditimi i llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare” u shqyrtuan nënpikat:

- Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- Administrimi, inventarizimi dhe dokumentimi i vlerave materiale dhe monetare;
- Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur më 31.12.2023.

Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Për vitet 2022-2023 Cirku Kombëtar këtu e në vijim (Cirku) për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare (PF) u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Auditimi u shtri në dy drejtimet e mëposhtme:

-mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit,

-kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm, konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kërkesave të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Konstatohet se veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht dhe përgjithësisht janë kontabilizuar në ditaret në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Cirku, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar PF vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor të cilat janë raportuar si vijon:

- Për vitin 2022, PF janë dorëzuar PF pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 60 Prot., datë 20.03.2023, protokolluar me nr. 2226 datë 08.05.2023 pranë Ministrisë së Kulturës.

- Për vitin 2023, PF janë dorëzuar PF pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 88 Prot., datë 29.03.2024.

PF janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë brenda afatit të përcaktuar, në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin.

Emri i Njesisë ekonomike raportuese, Cirku Kombëtar me NIPT L.;

Për vitet 2022-2023, nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit, mbi bazë ekstrate banke (*dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj*) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca.

Në bashkëlidhje të PF viti 2022, dokumentohet evidenca për rakordimin e planeve buxhetore dhe të shpenzimeve të thesarit/veprimet me bankën të miratuara nga NZ znj. S.B., znj. F.G. përfaqësuese e Degës së Thesarit Tiranë dhe znj. Z.B., Sekretare e përgjithshme e MK.

Në bashkëlidhje të PF viti 2023, dokumentohet evidenca për rakordimin e planeve buxhetore dhe të shpenzimeve të thesarit/veprimet me bankën të miratuara nga NZ znj. R.F., znj. K.T. përfaqësuese e Degës së Thesarit Tiranë dhe NA z. L.Y.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Në lidhje me auditimin mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022, konstatohet se:

Pasqyra e pozicionit financiar, Formati nr.1, është depozituar në Degën e Thesarit sipas formatit elektronik në datën 20.03.2023.

Për vitet 2022-2023, është plotësuar Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyrat anekse të tyre, e konkretisht:

- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5 - Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Formati 6 - Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;

-Formati 7 - Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; (formati 7/a, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), formati 7/b, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).

-Formati 8 - Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike bëhet në mënyrë manuale me programin Excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe që printohen në çdo kohë. Mënyra manuale përbën një risk për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit dhe në përpunimin e të dhënave kontabël si edhe në besueshmërinë e veprimeve kontabël, pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë. Si rrjedhojë, kjo mënyrë mund të sjellë mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Paraqitja dhe raportimi i aktiv/pasivit është kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”, i ndryshuar.

Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se:

PF viti 2024, gjatë fazës së auditimit në terren (afatati përfundimtar 04.04.2025) nuk ishin mbyllur, pasi afati përfundimtar i tyre është deri në 31 Mars të vitit pasardhës.

Në analizë janë marrë pasqyrat financiare të viteve 2022 dhe 2023.

Aktiviteti ekonomik-financiar i Cirkut, për vitin 2022 është zhvilluar nën përgjegjësinë e Përgjegjësit të sektorit znj. S.B. dhe në drejtimin e z. A.B., si ish drejtor i komanduar me urdhrin nr. 579 datë 31.08.2022 të Ministrisë së Kulturës. PF viti 2022, janë nënshkruar nga znj. R.F., Përgjegjës i sektorit të shërbimeve mbështetëse.

Për vitin 2023 ky aktivitet është zhvilluar nën përgjegjësinë e znj. R.F. si Nëpunës Zbatues (NZ) dhe z. L.Y. si ish Nëpunës Autorizues (NA).

PF të viteve 2022 dhe 2023 janë mbyllur pa u realizuar procesi përkatës i inventarizimit, si rrjedhojë vlerat e raportuara nuk japin pamjen e vërtetë dhe nuk sigurojnë besueshmërinë e arsyeshme mbi vërtetësinë e posteve të këtyre pasqyrave.

Pasqyra e Pozicionit Financiar (F1) vitet 2022 dhe 2023.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si më poshtë:

	2023	2022
Të drejtat (Aktivet)	70,276 mijë lekë	73,822 mijë lekë
Detyrimet (Pasivet)	48,590 mijë lekë	51,859 mijë lekë
Fondet Neto (Aktivet neto)	21,686 mijë lekë	21,963 mijë lekë

Aktiviteti neto plotësojnë rregullin Aktive - Pasive = Aktiviteti Neto (21,686 mijë lekë për vitin 2023 dhe 21,963 mijë lekë për vitin 2022).

1.1. Të Drejtat (Aktivet)

Aktiviteti më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën 70,276 mijë lekë dhe në datë 31.12.2022 në vlerën 73,822 mijë lekë. Përbëhen nga:

Tabela nr. 1. Aktiviteti total për vitet 2022-2023

në 000 lekë

Emërtimi	Viti 2023	Viti 2022	Pesha % për 2023	Pesha % për 2022	Ndryshimi 2023-2022
I.Aktiviteti Afatshkurtra	54,473	57,187	77.50%	77.50%	-2,714

II. Aktivet Afatgjata	15,803	16,635	22.50%	22.50%	-832
III. Aktivet afatgjata financiare	-	-	0%	0%	-
IV. Investime	-	-	0%	0%	-
Totali	70,276	73,822	100%	100%	-3,546

Burimi: CIRKU/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi u konstatua se për vitet 2022-2023 Aktivet afatshkurtra kanë zënë rreth 77.5% të totalit të të Drejtave, ndërsa Aktivet afatgjata kanë zënë 22.5% të këtij totali.

Gjatë vitit 2023 vihet re një rënie e vlerës totale të aktiveve me 3,546 mijë lekë krahasuar me një vit më parë.

Në lidhje me verifikimin mbi saktësinë dhe besueshmërinë e vlerave të pasqyruara në Formatin nr. 1 “Pozicioni financiar” për vitet ushtrimore 2022-2023, u audituan referencat e llogarive të aktivitetit dhe të pasivitetit si në vijim:

I. I. I. Aktivet afatshkurtra (qarkulluese)

Tabela nr. 2. Aktivet afatshkurtra për vitet 2022-2023 në 000 lekë

Aktivitet Afatshkurtra	Ref. e llog	Viti 2023	Viti 2022	Ndryshimi 2023-2022
I. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	5	49.9	20.2	29.7
II. Gjendje inventari qarkullues	3	5,884	5,329	555
III. Llogari të arkëtueshme	4	4,152	2,590	1,562
IV. Të tjera aktive afatshkurtra	4	44,387	49,248	(4,861)
Totali		54,473	57,187	(2,714)

Burimi: CIRKU/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga disa zëra, por në rastin e Cirkut sipas pasqyrës së pozicionit financiar F1, me vlerë është vetëm zëri 532:

Tabela nr. 3. Gjendja e llogarisë 532 në 000 lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
532	Vlera të tjera	49.9	20.2	29.7

Burimi: CIRKU/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Vlerat e llogarisë 532 “Vlera të tjera” për vitet 2022-2023 në vlerat respektive, sipas aktrakordimeve me Degën e Thesarit, përbëhen nga gjendja e llogarisë 475 “Të ardhura për t’u regjistruar në vitet pasardhëse”, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr. 3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”.

Evidentohet se vlera e llogarisë 532 ka ardhur në rritje nga viti në vit, ku për vitin 2023 rritja ka qenë në vlerën 29.7 mijë lekë krahasuar me vitin 2022. Në këtë vlerë përfshihen mjete që ruhen në arkë në formën e biletave apo vlera të tjera.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Tabela nr. 4. Gjendja e klasës 3 në 000 lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	494	169	325
32	Inventar i imët	3,459	3,459	-
33	Prodhime në proces	-	-	-
34	Produkte	1,931	1,701	230
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshë në rritje e majmëri	-	-	-

37	Gjendje te pambritura ose pranë të tretëve	-	-	-
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provizjone për zhvlerësim te inventarit (-)	-	-	-
Totali		5,884	5,329	555

Burimi: CIRKU/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Lëvizjet e klasës 3 për vitin 2023 rezultojnë me tepriçë debitore në vlerën 555 mijë lekë, që tregon rritje të gjendjes së mallrave inventariale në magazinë në krahasim me vitin paraardhës. Ndryshimi në rritje i gjendjes së klasës 3 në vlerën 555 mijë lekë paraqitet në postin e llogarisë 63 si dhe në efektin e llogarisë 85 pasqyruar në formatin nr. 4.

Vlerat e këtyre llogarive rakordojnë me akt rakordimet me Degën e Thesarit.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Tabela nr. 5. Gjendja e klasës 4

në 000 lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Diferenca 2023-2022
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	4,152	2,590	1,562

Burimi: CIRKU/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaria analitike 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”:

Tabela nr. 6. Gjendja e llogarisë 4342

në 000 lekë

Nr. rreshti	Referenca llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Diferenca 2023-2022
68	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	58	-	58
69	42	Detyrime ndaj personelit	2,737	1,801	935
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	395	168	227
75	435	Sigurime Shoqërore	845	545	300
76	436	Sigurime Shëndetësore	117	76	41
77	437,438	Organizma të tjerë shtetërore	-	-	-
Totali			4,152	2,590	1,562

Burimi: Pasqyra Financiare Cirku/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në aktiv të bilancit llog. 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” paraqitet në vlerën 4,152 mijë lekë për vitin 2023 dhe përfaqëson detyrime të shtetit debitor ku përfshihen detyrimet e paraqitura në kredi të llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” me vlerën 2,737 mijë lekë, llog. 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa” me vlerën 395 mijë lekë, llog. 435 “Sigurimet shoqërore” me vlerën 846 mijë lekë, llog. 436 “Sigurimet shëndetësore” me vlerën 117 mijë lekë (shpenzime të kryera në muajin dhjetor 2023 por që do paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm), si dhe llog 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”. E njëjta analogji dhe për vitin 2022 ku kjo llogari paraqitet në vlerën 2,590 mijë lekë. Vihet re se llog. 4342 është rritur në vitin 2023 me 1,562 mijë lekë më tepër se viti paraardhës, ku peshën më të lartë në këtë rritje e zë llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” me afërsisht 52%, si rezultat i rritjes së pagave të punonjësve.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet në vlerën 0 lekë edhe pse pretendohet se rezultojnë nëpunës debitorë për asetet e Cirkut. Nëse pretendimet qëndrojnë edhe sipas analizave të Cirkut, atëherë ekziston risku që ky pasqyrim nuk paraqet vlerën reale të llogarisë 468.

Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”

Tabela nr. 7. Gjendja e llogarisë 486

në 000 lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Diferenca 2023-2022
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	44,387	49,248	-4,861

Burimi: CIRKU/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për vitin 2023 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” rezulton në vlerën 44,387 mijë lekë e cila rakordon me vlerën e llogarisë 467 “Kreditor të ndryshëm”, në përputhje me UMF nr. 5, datë 21.02.2022, pika 15. Evidentohet se ky zë ka pësuar rënie në vlerën 4,861 mijë lekë krahasuar me një vit më parë.

I.I.II. Aktivet Afatgjata (AAGJ)

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” të pasqyruara në aktiv të bilancit për vitet 2023 dhe 2022 përbëhen vetëm nga zëri 218 “Inventar ekonomik” dhe paraqiten në vlerat respektive 15,803 mijë lekë dhe 16,635 mijë lekë. Krahasuar me vitin paardhës ky zë rezulton me rënie në vlerën 832 mijë lekë.

AAGJ përfaqësohen nga aktivet afatgjata jomateriale dhe aktivet afatgjata materiale. Në rastin e Cirkut zëri “Aktivet afatgjata jo materiale” rezulton 0 lekë.

Tabela nr. 8. Përbërja e Aktivet afatgjata materiale

në 000 lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Diferenca 2023-2022
	II.Aktive Afatgjata	15,803	16,635	(832)
20	Aktive Afatgjata jo materiale	-	-	-
218	Inventar ekonomik	15,803	16,635	(832)
230	Investime për AAGJIM	-	-	-
231	Investime për AAGJM	-	-	-

Burimi: CIRKU/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Për periudhën e audituar u konstatua se nuk ka regjistër për aktivet afatgjata dhe afatshkurtëra, veprime në kundërshtim me UMFnr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 26 ku citohet “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim..” si dhe pika 30 ku citohet “Formati i rregjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”

Nga CK nuk janë plotësuar dhe kontabilizuar lëvizjet ditore të materialeve sipas hyrje-daljeve në librin e financës dhe rakordimin me librin e magazinës për çdo muaj, nuk dokumentohet

mbartja e llogarive nga një vit në tjetrin, për të dhënë informacion të besueshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore.

Për veprimet ose mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi znj. S.B. me detyrë ish Përgjegjëse e shërbimeve mbështetëse, znj. R.F., me detyrë Përgjegjëse e shërbimeve mbështetëse dhe znj. M. D., Specialiste e shërbimeve mbështetëse.

Nga auditimi i llogarive të aktiveve afatgjata materiale evidentohet se për vitet 2022 dhe 2023 ato pasqyrohen vetëm në zërin 218 “Inventar ekonomik”.

Gjendja në fillim të vitit 2022 e llog. 218 e paraqitur në vlerën 24,309 mijë lekë, evidentohet se është e mbartur në pasqyrat financiare po në këtë vlerë nga vitet 2020-2021. Nuk dokumentohet të jetë kryer inventarizimi i plotë i aktiveve dhe kuadrimet me llogaritë përkatëse me vlerat e paraqitura në bilanc.

Referuar Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i Aktiveve Afatgjata (vlera neto)”, paraqitet të jetë llogaritur vlera prej 1,096 mijë lekë ‘Amortizim për asetet e nxjerra jashtë përdorimit’ në vlerën 6,578 mijë lekë. Për pakësimin prej 6,578 mijë lekë dokumentohet një tabelë exceli për 37 artikuj me emërtimin “Mungojnë me proces verbal”. Nuk dokumentohet të ketë miratim nga strukturat përgjegjëse lidhur me shkarkimin me procesverbal të vlerave të evidentuara si mungesë, veprim i cili nuk është në përputhje të kërkesave të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011. Të dhënat e kësaj table nuk janë konfirmuar nga grupi i inventarizimit. Veprimet e mësipërme rezultojnë në mos zbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” të ndryshuar pikave 34, 35, 36, 37 dhe 38.

Gjithashtu në lidhje me procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë, konstatohet se nuk ka gjurmë të plotë të auditit përsa i përket këtij procesi. Nuk specifikohet mënyra e kryerjes së nxjerrjes jashtë përdorimit, mungojnë provat justifikuese sikundër e kërkon pika 122 e Udhëzimit 30 datë 27.12.2011. *(lidhur me këtë problematikë është shprehur dhe Inspektimi Financiar Publik dhe çështja është në proces në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë).*

Përsa më sipër mban përgjegjësi sipas periudhave respektive në cilësinë e P/Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse znj. S. B. dhe znj. R. F..

Për llog. 218, sipas inventarit kontabël, ka disa aktive si pajisje elektronike, kondicionerë, kitarë, kamera digjitale etj që duhet të pasqyroheshin në llogarinë 214 “Pajisje, instalime teknike, makineri e pajisje elektronike” dhe jo në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”. Pra evidentohet se nuk është bërë klasifikimi i saktë i aktiveve ndër zëra.

Për këtë zë, në përlllogaritjen e amortizimit janë zbatuar normat e amortizimit të caktuara në Udhëzimit nr. 8, date 09.03.2018 Ministrisë të Financave “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. Gjithashtu në përlllogaritjen e amortizimit është përdoruar metoda e amortizimit mbi vlerën e mbetur. Referuar sa më sipër, kategorizimi i aktiveve nuk është i saktë, rrjedhimisht dhe amortizimi nuk është konform normave përkatëse për kategori të ndryshme aktivesh.

Veprimet e mësipërme rezultojnë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011 i ndryshuar.

Vlera e amortizimit vjetor është e pasqyruar në llogarinë 1013, në vlerën 832 mijë lekë si pakësim i fondeve baze, në formatin nr. 7/b. Janë pasqyruar shtesat dhe pakësimet e llogarive inventariale të klasës 2, gjatë vitit 2023 dhe gjendja e tyre në fund të vitit 2023.

Përsa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Zbatues znj. R. F.

Mungesa e inventarizimit dhe e regjistrimit të aktiveve, sjell mungesën e të dhënave të plota kontabël dhe si rrjedhojë, nuk pasqyron gjendjen reale dhe të besueshme të zërave në pasqyrat financiare.

Llogaritë 230 dhe 231 “Investime” paraqiten me tepricë kreditore në vlerën 0 lekë për vitet objekt auditimi.

1.2. Detyrimet (Pasivet)

Detyrimet në datën 31.12.2023 janë pasqyruar në vlerën 48,590 mijë lekë dhe në datën 31.12.2022 në vlerën 51,859 mijë lekë, me një rënie prej 3,269 mijë lekë.

1.2.a- Detyrimet afatshkurtra në datën e mbylljes së pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 9. Parqitja e detyrimeve afatshkurtra në vitet 2022-2023 në 000 lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Diferenca 2023-2022
	I. Detyrimet Afatshkurtra	48,590	51,859	(3,269)
	1. Llogari të Pagueshme	48,590	51,859	(3,269)
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	58	-	58
42	Detyrime ndaj personelit	2,737	1801	935
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	395	168	227
435	Sigurime Shoqërore	846	545	301
436	Sigurime Shëndetësore	117	76	41
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-	-	-
467	Kreditorë të ndryshëm	44,387	49,248	(4,861)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	-	-	-

Burimi: Pasqyra Financiare Cirkul/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaritë e klasës 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pageshme. Ato paraqesin detyrimet e Cirkut përkatësisht në 31.12.2023 dhe 31.12.2022 kundrejt furnitorëve, punonjësve për pagat e muajit dhjetor 2023/2022, tatimeve për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023/2022, kreditorëve të ndryshëm etj, të analizuar si më poshtë:

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” e paraqitur në pasiv të bilancit përbëhet vetëm nga teprica kreditore e llog. 404 “Furnitorë për investime” në vlerën 58 mijë lekë si detyrim për furnitorët.

-Në llog. 42 “Detyrime ndaj personelit” janë paraqitur detyrimet për pagat e muajit dhjetor 2023 në vlerën 2,737 mijë lekë që vjen nga detyrimi i pagesës së pagës së dhjetorit në janar të vitit pasardhës, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesës së muajit Dhjetor 2023.

-Në llog. 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa” janë paraqitur detyrimet për pagesën e TAP për pagat e muajit dhjetor 2023 në vlerën 395 mijë lekë, e cila përfaqëson vlerën e mbajtur punonjësve për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për pagat e muajit dhjetor 2023. Kjo vlerë paguhet në janar të vitit pasardhës.

-Për sa i përket posteve të llogarive 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 846 mijë lekë dhe llogarive 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 117 mijë lekë janë pasqyruar detyrimet për tatime, detyrime për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për sa paguar punonjësit për muajin dhjetor 2023. Këto teprica rakordojnë me listëpagesën e deklaruar në muajin dhjetor 2023.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet përkatësisht në vlerat 44,387 mijë lekë dhe 49,248 mijë lekë për vitet respektive 2023/2022. Evidentohet rënie në vlerën 4,861 mijë lekë në vitin 2023 krahasuar me një vit më parë. Në këtë llogari janë kontabilizuar veprimet që

institucioni kishte me shoqërinë “U. SHPK” dhe Përmbarrimin në bazë të vendimit gjyqësor. Në vitin 2021, gjendja ka qenë 50,354 mijë lekë, shtuar pagesa me 4,233 mijë lekë nga gjyqi duke u bërë në vlerën 54,586 mijë lekë. Në vitin 2022, është paguar vlera prej 5,338 mijë lekë dhe gjendja rezulton 49,248 mijë lekë.

Fondet Neto

Tabela nr. 10. Pasqyra e aktiveve neto/fondeve neto

në 000 lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2023	Ushtrimi i mbyllur 2022	Diferenca 2023-2022
C	AKTIVET NETO/ FONDET NETO (A-B)	21,686	21,963	(277)
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	21,686	21,963	(277)
12	Rezultatet e mbartura	-	-	
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	-	-	
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	-	-	
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	-	-	

Burimi: Pasqyra Financiare Cirkul/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi konstatohet se Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto (21,686 dhe 21,963 mijë lekë).

Llogaria 101 paraqitet në vlerën 21,686 mijë lekë, e cila tregon vlerën e fondeve të veta për financimin e blerjeve të aseteve të Institucionit, korrigjues kjo me amortizimin e aseteve. Kjo llogari paraqet vlerën neto të të gjitha aseteve të marra nga Institucioni, Totali i Fondeve sipas pasqyrës F1 është i barabartë me Totalin e Fondeve në Pasqyrën F4. Në krahasim me vitin ushtrimor paraardhës kjo llogari paraqitet e zvogëluar në vlerën 277 mijë lekë. Ky pakësim vjen nga rritja e amortizimit në krahasim me vlerën e aseteve të blera në këtë vit ushtrimor.

Për vitet 2023/2022 llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në Formatin F1 paraqitet në shumën 0 lekë, vlerë që përfaqëson rezultatit të vitit ushtrimor përkatës.

Në formatin F4, Llogaria 85 “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore” në vlerën 555 mijë lekë nuk është e barabartë me llogarinë 85 në formatin F1 i cili është 0 lekë. Rezultati nuk ka dalë si diferencë e të ardhurave në vlerën 61,509 mijë lekë dhe shpenzimeve në vlerën 61,509 mijë lekë.

Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, përfaqëson si tepricë kreditore, rezultatit financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Si tepricë debitore kjo llogari, përfaqëson rezultatit negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

Tabela nr. 11. Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto

në 000 lekë

Ref.	EMËRTIMI	Fonde bazë dhe Grante Kapitale	Rezultatet e Ushtrimit Tepricë/Deficit	Gjithsej Aktive/neto Fonde/Neto
b	c	1	5	6
101	I. Aktivet Neto/Fondet Neto	21,963		21,963
	II. Ndryshimet Në Aktivet/ Fondet Neto(1+2)		-277	-277
	1. Nga burime të brendshme		-277	-277
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)			
1016,	Nga Transfertat e brendshme të AAGJ, Dhurata në natyrë, (+,-)			
1059				
1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)			
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)			
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)		555	555
111	Nga Rezervat (+,-)			

115	Nga Fondet e veta të investimeve (+)			
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)			
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)		-833	-833
1015	Nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe dëmtimet(-)			
107	Vlera të AAGJ, të caktuara në përdorim(+,-)			
109	Diferenca nga Rivlerësimi i AAGJ(+,-)			
	2.Nga Burime të Jashtme			
106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)			
1016,	Nga Transfertat e brendshme të AAGJ, Dhurata në			
1069	natyrë, (+,-)			
	TOTALI I FONDEVE TË VETA(I+II)	21,963	-277	21,686

Burimi: Pasqyra Financiare Cirkul/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaria 1013, “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ-së” ka marrë në debi amortizimin vjetor të aktiveve afatgjata me kundër parti kreditin e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 832 mijë lekë (Diferenca 16,635 mijë – 15,803 mijë lekë = - 832 mijë lekë).

Në formatin nr.7/a dhe 7/b janë pasqyruar shtesat, paksimet e llogarive të klasës 2, amortizimi vjetor për vitin 2023 dhe amortizimi i akumuluar. Në përlllogaritjen e amortizimit janë zbatuar normat e amortizimit të caktuara në Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 Ministrit të Financave “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. Gjithashtu në përlllogaritjen e amortizimit është përdoruar metoda e amortizimit mbi vlerën e mbetur. Vlera e amortizimit vjetor është e pasqyruar në llogarinë 1013, në vlerën 832 mijë lekë si pakësim i fondeve baze, në formatin nr. 7/b. Janë pasqyruar shtesat dhe pakësimet e llogarive inventariale të klasës 2, gjatë vitit 2023 dhe gjendja e tyre në fund të vitit 2023.

Pasqyra e Performancës F2

Nga auditimi i gjendjes së llogarive në pasqyrën e performancës rezultoi se konstatimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.

Totali i të “Ardhurave” në Pasqyrën e Performancës F2 është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit.

Për vitet 2023/2022 pasqyrat paraqiten si mëposhtë:

në 000 lekë

	<u>2023</u>	<u>2022</u>
Të ardhurat (grupi A)	61,509 mijë lekë	43,858 mijë lekë
Shpenzimet (grupi B)	61,509 mijë lekë	43,858 mijë lekë
Rezultati i ushtrimit (llog.85)	0 lekë	0 lekë

Llogaria 85 “Teprica ose deficiti i periudhës“ në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Në formatin 2 janë pasqyruar të gjitha të gjitha të ardhurat në vlerën 61,509 mijë lekë të klasifikuara si të ardhura nga grantet korente dhe shpenzimet e konstatuara në vlerën 61,509 mijë lekë për periudhën janar – dhjetor 2023 të rakorduara me Degën e Thesarit, Tiranë.

2.1. Të ardhurat

Tabela nr. 12. Të ardhurat për vitet 2022-2023

në 000 lekë

Vitet	2023	2022	Diferenca 2023-2022
A TË ARDHURAT	61,509	43,858	17,651
71 III. Të Ardhura Jotatimore	-	-	-
72 V. Grante Korrente	62,064	43,433	18,631
73 VII. Ndryshimi i gjendjes së inventarit të Produkteve	(555)	425	(980)

Burimi: Pasqyra Financiare Cirku/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Llogaria 720, “Grante korrente të brendshme” në vlerën 62,064 mijë lekë përfaqëson të gjitha transferimet dhe grantet korrente të përgjithshme për mbështetjen e veprimtarisë së funksionimit të institucioneve përfituese kryesisht nga buxheti i shtetit, por dhe nga donatorë të tjerë të brendshëm që financojnë për qëllime të caktuara.

-Në llogarinë 7200 “Grante nga Buxheti për NJQP (Qendrore)” përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit, ku për vitin 2023 paraqitet në vlerën 56,140 mijë lekë dhe për vitin 2022 në vlerën 40,843 mijë lekë.

-Llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti” për vitin 2023 në vlerën 4,095 mijë lekë përfaqëson shumën që institucioni u detyrohet punonjësve për pagat e muajit dhjetor, detyrimet ndaj shtetit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin e mbajtur për tatimin mbi pagat, shpenzime të cilat do të kryhen në Janar 2024.

Rakordimi me thesarin është bërë në përputhje me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”i ndryshuar, pika 37 ku “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë Cash, me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët”.

2.2 Shpenzimet

Tabela nr. 13. Shpenzimet për vitet 2022-2023

në 000 lekë

74 B	SHPENZIMET	2023	2022	Diferenca 2023-2022
75 600	I. PAGAT DHE PËRFITIMET E PUNONJËSVE	43,026	30,876	12,150
76 6001	Paga, personel i përhershëm	43,026	30,635	12,391
77 6002	Paga personel i përkohshëm	-	241	-241
80 601	II. KONTRIBUTE TË SIGURIMEVE	7,210	5,166	2,044
81 6010	Kontributi i sigurimeve shoqërore	6,475	4,348	2,127
82 6011	Kontributi i sigurimeve shëndetësore	735	818	-83
83 602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	9,745	6,917	2,828
85 6020	Materiale zyre e të përgjithshme			
86 6021	Materiale dhe shërbime speciale			
87 6022	Shërbime nga të tretë	1,027	1,564	-537
88 6023	Shpenzime transporti			
89 6024	Shpenzime udhëtimi			
90 6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme			
91 6026	Shpenzime për qiramarrje	3,840		3,840
92 6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	4,861	5,338	-477
94 6029	Shpenzime të tjera operative	17	15	2

101		V. TRANSFERIME KORRENTE	2,083	474	1,609
103	6040	Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë	1,830	-	1,830
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	223	134	89
114	6061	Transferta të paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	30	340	-310
130	63	VIII. NDRYSHIMI I GJENDJES SË INVENTARIT	-555	425	980
TOTALI			61,509	43,858	19,611

Burimi: Pasqyra Financiare Cirku/Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në shumën prej 43,026 mijë lekë për vitin 2023 dhe 30,876 mijë lekë për vitin 2022, përfaqëson pagat e personelit të përhershëm dhe të përkohshëm sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts. Vihet re rritje e këtij zëri me 12,391 mijë lekë në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

-Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve” në shumën prej 7,210 mijë lekë për vitin 2023 dhe 5,166 mijë lekë për vitin 2022, përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e kontributeve e paguar nga punëdhënësi sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin e Tatimeve C@ts.

-Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në shumën prej 9,745 mijë lekë për vitin 2023 dhe 6,917 mijë lekë për vitin 2022, përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve e cila përbëhet nga:

Llogaria 6022 “Shërbime nga të tretë” për 1,027 mijë lekë për vitin 2023 dhe 1,564 mijë lekë për vitin 2022 që përfshin shpenzimet për shërbime utilitare si energji elektrike, ujë, shërbim telefoni/internet, shërbim ruajtje objekti, shërbime pastrimi. Janë kontabilizuar dhe gjopa për deklarim të vonuar në vlerën 5 mijë në muajin dhjetor 2022 dhe derdhje tatim në burim muaji janar.

Llogaria 6026 “Shpenzime për qiramarrje” në shumën 3,840 mijë lekë përfaqëson shpenzimet për qiramarrje ambientesh në bazë të kontratës së lidhur me shoqërinë “D.” sh.p.k.

Llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në shumën 4,861 mijë lekë për vitin 2023 dhe 5,338 mijë lekë për vitin 2022, përfaqësojnë “shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore”. Nga kontabilizimi evidentohet se për vitin 2022 kjo vlerë përbëhet nga shpenzime gjyqi përmbartimore në shtator në vlerën 2,000 mijë lekë, shp përmbartimore K. B. në tetor në vlerën 638 mijë lekë dhe vlera 2,700 mijë lekë në muajin dhjetor.

Gjithashtu për vitin 2023 kjo vlerë përbëhet nga shpenzime përmbartimore për për zyrën përmbartimore K. B.

Llogaria 6029 “Shpenzime të tjera operative” në shumën 17 mijë lekë për vitin 2023 dhe 15 mijë lekë për vitin 2022.

-Llogaria 6040 “Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë” në shumën prej 1,830 mijë lekë përfaqëson pagesa për pjesëmarrjen në projekte, ekspozita, veprimtari të ndryshme.

-Llogaria 6060 “Transferta të paguara nga ISSH dhe ISKSH” në shumën prej 223 mijë lekë dhe 134 mijë lekë përfaqëson shpenzime shpërbllim dalje në pension dhe leje e pakryer.

-Llogaria 6061 “Transferta të paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor” në shumën 30 mijë lekë dhe 340 mijë lekë përfaqëson shpenzime për ndihmë ekonomike dhe ndihmë me rast vdekje.

-Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruara drejt në shumën prej 555 mijë lekë për vitin 2023.

F4 “Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto”

Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” konstatohet se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë me të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar F1 në rubrikën C. Aktivet neto rakordojnë me fondet neto.

F6 “Për investimet dhe burimet e financimit”

Në Formatin nr. 6 “Për investimet dhe burimet e financimit” shtesat dhe pakësimet e llogarive të fondeve të përdorura për shtesat e aseteve inventariale të klasës 2, gjatë vitit 2023 dhe gjendja e tyre në fund të vitit 2023 janë pasqyruar në vlerat 0.

F7 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”

Në Formatin nr. 7 a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është pasqyruar vlera 6,578 mijë lekë si nxjerrje jashtë përdorimit për llogarinë 218 “Inventar ekonomik”. Llogaria 218 “Inventar Ekonomik” vlera gjendje në fillim të vitit 24,309 mijë lekë, nxjerrje jashtë përdorimit vlera 6,578 mijë lekë dhe gjendja në mbyllje të vitit 2022 rezulton në vlerën 17,730 mijë lekë.

Nuk dokumentohet një analizë për artikujt e nxjerrë jashtë përdorimit që përbëjnë vlerën e mësipërme dhe veprimin kontabël. Ky veprim rezulton në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, Kreu “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, pikat 34, 35, 36, 37 dhe 38 dhe mungesa e dokumentacionit për regjistrimet në librat kontabël.

Shënim: Kjo problematikë është trajtuar dhe nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në raportin “Për inspektimin financiar publik të kryer në ish Ministrinë e Kulturës/strukturat përgjegjëse, sot MEKI dhe Cirku Kombëtar/Strukturat përgjegjëse.” Nga kjo drejtori është dhënë rekomandim masë rregullative për Ministrin e MEKI-t, në cilësinë e autoritetit ligjor për të kryer një analizë shteruese lidhur me tjetërsimin e vlerës historike të aktiveve. Gjithashtu është propozuar kallëzim penal për strukturat përgjegjësi të ngarkuara me përgjegjësi në raport, ku ndër të tjera objekt i kallëzimit ka qenë *“Pakësimi i vlerës prej 6,578,456 lekë të aktiveve afatgjata, vlerësuar veprim fiktiv dhe dëm pasuror/pasuri e munguar për njësinë publike.”*

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas UMF nr. 30 të MF, datë 27.12.2011 i ndryshuar. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon: Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2022-2023.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të paragrafit 74, i UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar që sanksionin se *“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”*.

Inventarizimi i vitit 2022:

Me shkresën nr. 231 prot., datë 13.05.2022, z. J. K. anëtar i komisionit të inventarizimit, i ka dërguar z. A. H. dijeni mbi konstatimet paraprake të mungesës së një pjese të materialeve të inventarit të cirkut.

Në vijim të korrespondencave shkresore, dokumentohet Urdhri i brendshëm nr. 360 prot., datë 06.12.2022 “Mbi ngritjen e komisionit” lidhur me verifikimin e inventarit të materialeve të CK,

të zhvendosura nga ambientet e CK dhe të magazinuara tek ambientet e Bunk Art 1. Pjesë e komisionit të inventarizimit janë: znj. M. D., z. J. K., z. G. Sh. dhe znj. Y. S.

Me shkresën nr. 360/1 prot., datë 07.12.2022 nga grupi i mësipërm është hartuar procesverbali mbi konstatim inventari, ku shprehen se dera e hyrjes së ambientit të magazinimit ishte e mbyllur por pa vulën e sigurisë dhe se materialet e Cirkut janë të dëmtuara në pjesën më të madhe të tyre. U mendua se duhet caktuar një datë tjetër për të sistemuar materialet me ndihmën e një grupi punonjësish të Cirkut.

Me shkresën nr. 360/3 prot., datë 15.12.2022 është hartuar procesverbali mbi verifikimin e inventarit të materialeve të Cirkut të zhvendosura nga ambientet e Cirkut me urdhrin e Ministrit me shkresën nr. 66 prot datë 09.02.2022, të magazinuara në ambientet e Bunk-Art 1, ku u konstatuan inventarë të dëmtuar dhe të humbur.

Me shkresën nr, 360/4 prot., datë 27.12.2022 është hartuar procesverbali, ku grupi i inventarizimit ka konstatuar asete të munguara/të humbura në vlerën 9,173 mijë lekë (kosto historike) si vijon: Inventar ekonomik vlera 9,110 mijë lekë; materiale konsumi vlera 63 mijë lekë;

Me shkresën nr. 360/8 prot datë 30.12.2022 grupi i inventarizimit ka hartuar procesverbalin lidhur me materialet e Cirkut të cilat janë në inventarin ekonomik, por nuk dihet vendndodhja e tyre në vlerën 185 mijë lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të inventarizimit të periudhës 2022/2023, krahas urdhrin nr. 360, datë 06.12.2022 për verifikimin e materialeve të CK është vijuar me ngritjen e komisionit për inventarizimin vjetor 2022 në referencë të Urdhrit nr. 19 prot datë 23.01.2023 “Mbi inventarizimin vjetor/2022”, me Komision: znj. M. D., z. F. Sh. dhe z. G. Sh.

Referuar kërkesave të Urdhrit nr.19 datë 23.01.2023, komisioni nuk ka vijuar me inventarizimin e aseteve “Të trashëguara”, por ka marrë të mirëqenë fletët e inventarizuara nga një komision i mëparshëm.

Ky proces inventarizimi nuk ka ndjekur rregullat e përcaktuara në UMF nr. 30 datë 27.12.2011 konkretisht:

-nuk është mbajtur një procesverbal për të fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletë daljes nga magazina;

-nuk dokumentohet të jetë kryer inventarizimi në vend i aktiveve të Cirkut.

-përgjegjësit e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse sipas periudhave respektive nuk kanë zbatuar urdhrin e sipërcituar, nuk kanë nxjerrë rezultatin përfundimtar të inventarizimit si dhe nuk është dokumentuar ndonjë relacion zyrtar përmbledhës për rezultat e inventarizimit në mënyrë që t'i drejtohej titullarit të institucionit.

Sa më sipër, në moszbatim të kërkesave të parashikuara në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar lidhur me përgjegjësitë e Titullarit të njësisë publik/Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësi zbatues; UMF nr. 30 datë 27.12.2011 i ndryshuar; Urdhrin nr. 19 datë 23.01.2023 2023 “Mbi inventarizimin vjetor/2022”, ngarkohen me përgjegjësi:Znj. M.D. z. G.Sh.- anëtarë, znj. Y. S. me detyrë magaziniere, znj. S. B. në cilësinë e ish NZ, znj. R. F. në cilësinë e NZ për periudhën përkatëse dhe z. A.B. në cilësinë e NA për periudhën respektive.

Inventarizimi i vitit 2023

Me shkresën nr, 12 prot datë 15.01.2024 ka dalë Urdhri nr. 5 për “Inventarizimin vjetor të pasurisë së Cirkut Kombëtar” me përbërje të komisionit znj. M. D., z. M. E. dhe z. G. Sh. Referuar urdhrin është hartuar procesverbali nr. 116/1 prot., datë 27.04.2024, pas diskutimit të problematikave të hasura (mungesa e kartelave të inventarit, mungesa e kapaciteteve të duhura dhe ekspertizës për të bërë vlerësimet e sakta të gjendjes së materialeve). Anëtarët e komisionit bien dakord për të kryer vetëm verifikimin në natyrë të vlerave materiale.

Me shkresën nr. prot datë 16.05.2024 znj. R. F. ka dërguar memo ish titullarit z. L.Y. lidhur me mbledhjen e zhvilluar me komisionin e inventarizimit dhe problematikat që dolën në pah

ku shprehet se financa nuk disponon një procedurë të saktë të inventarizimit dhe asnjë inventar përfundimtar të institucionit. Bilanci i vitit 2023 është mbyllur me shënimet përkatëse se inventarët janë në proces inventarizimi dhe do të pasqyrohen në bilancin e vitit të ardhshëm. Me shkresën nr.160 prot., datë 23.05.2024 është mbajtur procesverbal ku referuar problematikave të trajtuara, drejtori shprehet për pezullimin e procesit të inventarizimit, për shkak të mos rakordimit të kartelave të inventarëve, mungesës së kartelave, pasi znj. F. nuk ka kartela të trashëguara me marrjen e detyrës. Përsa më sipër edhe për vitin 2023, nuk është realizuar procesi i inventarizimit konform rregullave dhe procedura ve të përcaktuara në UMFnr. 30 datë 27.12.2011.

2.4.Prokurimet e fondeve publike.

Për periudhën objekt auditimi institucioni i Cirkut Kombëtar nuk ka realizuar procedura prokurimi dhe për pasojë nuk ka hartuar regjistër parashikimi dhe realizimi vjetor të prokurimeve publike për arsye të mungesës së fondeve, pasi Dega e Thesarit me shkresën nr.4838/6 prot datë 03.8.2021 ka vendosur masën e sekuestros në shpenzimet operative (artikulli buxhetor 602), për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në favor të palës U. SHPK.

2.5 Veprimtaria e Cirkut Kombëtar

Cirku Kombëtar (*këtu e më poshtë CK*) është institucion publik me statusin e institucionit qëndror në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën i cili funksion në mbështetje të Ligjit Nr. 10352, datë 18.11.2010 “*Për Artin dhe Kulturën*”, i ndryshuar, neni 5, germa “dh”, paragrafi 3, Statutit miratuar nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën dërguar me shkresën Nr.843 prot., datë 05.02.2013, Rregullores së Brendshme protokolluar me shkresën Nr.116 prot., datë 11.03.2013 dhe shkresën Nr.71, datë 20.03.2024.Objekti i veprimtarisë së CK është mbështetja në vlerat e kulturës dhe artit kombëtar.

Struktura e CK miratuar nga Kryeministri me Urdhërin Nr.134, datë 28.03.2014 përbëhet nga 38 punonjës, si dhe funksion me 3 sektorë në varësi të Drejtorit të Cirkut.

Në zbatim dhe në përputhje me Ligjin Nr. 10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar në lidhje me organizimin e veprimtarisë administrative të institucionit rezulton se:

☞Referuar nenit 8 dhe 10 të ligjit, drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë administrative dhe artistike të institucionit, realizohet respektivisht nga titullari i institucionit dhe Bordi Artistik (BA). Për vitin **2022**, Bordi Artistik i krijuar në zbatim të nenit 10 të ligjit të sipërcituar ka qënë vijimësi e Bordit të krijuar me Urdhërin Nr.3571/2, datë 16.07.2018 të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën me mandat 4 vjeçar, por që për këtë periudhë nuk ka funksionuar për shkaqet e cituara më poshtë.

Për vitin **2023**, me Urdhërin Nr.373/2, datë 16.06.2023 të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën është miratuar përbërja e Bordit të ri, me 5 (pesë) anëtarë nga fusha e artit dhe kulturës, 1 (një) specialist nga Ministria e Ekonomisë dhe 1 (një) specialist nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, i cili ka ushtruar funksionet e tij nga kjo periudhë e vijim.

☞Referuar nenit 7, pika 2 të ligjit, nga titullari i institucionit/Drejtori i CK është propozuar Statuti dhe miratuar nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën protokolluar me shkresën nr.843 prot., datë 05.02.2013.

☞Për vitin 2022, në zbatim të nenit 7, pika 3 të ligjit, institucioni ka funksionuar në bazë të Rregullores për funksionimin e brendshëm, miratuar nga Drejtori i CK protokolluar me shkresën Nr.116 prot., datë 11.03.2013. Për vitin 2024, është miratuar Rregullore e Brendshme e cila me shkresën Nr.71, datë 20.03.2024 i është përcjellë ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

☞ Referuar nenit 7, pika 3 të ligjit është miratuar nga vetë Bordi Rregullorja e funksionimit në mbledhjen e parë të tij me Vendimin Nr.1, datë 12.07.2023.

Funksionimi i Bordit Artistik.

Bazuar në Statutin e Cirkut, neni 8, pika 4, Bordi mbledhet jo më pak se 2 herë gjatë një sezoni artistik.

Konstatim: Për vitin 2022 Bordi nuk është mbledhur, pasi bazuar në Ligjin Nr. 10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar neni 10, pika 5, ai mbledhet sa herë gjykohet e nevojshme nga titullari i institucionit gjatë një sezoni artistik. Në këtë periudhë, posti i drejtorit të CK është kryer nga drejtorë të komanduar. Gjithashtu Bordi nuk është mbledhur dhe për shkak të mungesës së truallit ku ishte vendosur çadra e cirkut kthyer ish pronarit, si pasojë e ekzekutimit të detyrueshëm të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 8473, datë 17.12.2019 nga Përmbarimi gjyqësor, dhe bllokimit të llogarive nga kjo zyrë.

-për vitin 2023, BA ka funksionuar me 5 anëtarë dhe jo me 7, jo në përputhje me Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar neni 10, pika 3, për vitin 2024 me 6 anëtarë për shkak të dorëheqjes së një anëtari.

Për vitin **2023**, Bordi ka zhvilluar 3 mbledhje dhe ka dalë me 2 vendime:

- Vendimi Nr.1, datë 12.07.2023 ka miratuar përbërjen e Bordit, tarifat e reja për krijimtarinë si dhe është miratuar projekti “Kult-Art” për sezonin Nëntor-Dhjetor 2023 me vlerë financimi 350,000 lekë.
- Vendimi Nr.2, datë 25.10.2023 ka miratuar projektin ”ShakeSpirit”, me vlerë financimi 1,480,000 lekë.

Për vitin **2024**, Bordi ka zhvilluar 5 mbledhje dhe ka dalë me 3 vendime:

- Vendimi Nr.1, datë 21.03.2024 ka miratuar projektet (3):
 - Klloun, me vlerë financimi 620,000 lekë,
 - Puh legjende, me vlerë financimi 1,320,000 lekë,
 - Gjenerata X, me vlerë financimi 430,000 lekë.
- Vendimi Nr.2, datë 15.05.2024 ka miratuar projektet (2):
 - Gjenerata X, me financim 0,
 - Guri i magjistarit, do të realizohet në një moment të dytë me artistë të cirkut pa burime nga jashtë.
- Vendimi Nr.3, datë 04.12.2024 ka miratuar projekt (1):
 - Kartolina urimi në 65 vjetor, me vlerë financimi 672,280 lekë.

Vendimmarrja e Bordit për vitin 2023-2024.

Konstatim i përgjithshëm:Nga auditimi i njëpasnjëshëm i vendimeve të BA dhe projekteve artistike për periudhën nën auditim dhe rezulton:

➡për vitin 2023, nuk është miratuar repertori artistik vjetor i propozuar nga BA, në përputhje me politikën e ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën, jo në përputhje me Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010, i ndryshuar, nenin 11, pika “b” si dhe me Statutin neni 3, pika 4;

➡tarifat për krijimtarinë artistike miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 12.07.2023 të BA nuk janë argumentuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar krahasuar me çmimet e tregut, por rritja e tyre trajtohet si domosdoshmëri nga ndryshimi i çmimeve të tregut. Ndryshimi i tarifave nuk argumentohet duke marrë një bazë krahasuese me tarifat e krijimtarisë për institucionet e tjera të artit dhe kulturës;

➡Vendimet e BA për miratimin e projekteve me financim nga buxheti nuk përmbajnë bazën ligjore (aktin administrativ) konkret, të cilit i referohen për tarifat;

➡Për vitin 2023-2024 të gjithë urdhërat e ish titullarit dhe titullarit aktual për ndjekjen dhe zbatimin e “*gjurmës së auditimit të projekteve*” nga pikëpamja e formulimit të udhërit nuk janë të qarta, pasi objekti i urdhrit është “ngritja e grupit të punës për hartimin e gjurmës së auditimit”, në një kohë që kjo gjurmë është miratuar me Urdhrin Nr.70, datë 01.12.2023 të ish titullarit në përputhje me Ligjin

Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 19 dhe neni 9,16 si dhe Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 5.

➔Rregullorja e funksionimit të Bordit miratuar me Vendimin Nr.1, datë 12.07.2023 si dhe Rregullorja për funksionimin e brendshëm, miratuar nga Drejtori i CK nuk është përditësuar me proceset e punës për zbatimin e “gjurmës së auditimit të projekteve” miratuar me Urdhrin Nr.70, datë datë 01.12.2023;

nuk është përditësuar me proceset e punës për zbatimin e “gjurmës së auditimit të projekteve”;

➔kontratat e shërbimit me artistët nuk parashikojnë: penalitete për vonesa në realizimin e shërbimit, afatet, kalendarin e shfaqjeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve në mënyrë specifike, të drejtën e pronësisë për kostumet apo materialet skenike të prodhuara për projektin konkret, si dhe detyrimet mbi të drejtën e autorit, jo në përputhje me parimet e përgjithshme të Kodit Civil për kontratat e shërbimit;

➔kontratat e shërbimit që janë lidhur për projektet e miratuara nuk përmbajnë bashkëlidhur, plan buxhetin e miratuar për projektin, si pjesë integrale e kontratës;

➔në disa raste mungon relacioni përmbledhës mbi zbatimin e gjurmës së auditimit të projekteve;

➔publikimi i thirrjeve për aplikim projektsh bëhet në rrjete sociale (instagram) në adresë të CK dhe jo në faqen zyrtare të CK dhe as në atë të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën (mungon faqe zyrtare);

➔dosjet e projekteve për periudhën 2023-2024 nuk janë të inventarizuara, nuk përmbajnë dokumentacionin sipas kërkesës së “gjurmës së auditimit” (*skenarin, konceptin regjisorial, projekt skenografi, projekt kostumografi dhe preventivin sipas zërave*) jo në përputhje me Ligjin “Për arkivat” si dhe Urdhrin Nr.70, datë 01.12.2023 për miratimin e “gjurmës së auditimit të projekteve”;

➔aktet administrative dalë për zbatimin e projekteve në disa raste për vitin 2024, kanë korrigjime në numrin e protokollit (si: *deklaratat e konfliktit të interesit, Vendimi Nr.1, datë 21.03.2024 i Bordit*);

➔në 2 raste, (2023), administrohen nga Zyra e Protokoll Arkivit dy shkresa me të njëjtën përmbajtje dhe datë por me numra të ndryshëm protokollit (*shkresa me objekt thirrje për aplikim projektsh Nr.207, datë 11.09.2023 dhe nr.206, datë 11.09.2023*) si dhe 1 rast (2024), administrohen nga Zyra e Protokoll Arkivit 2 urdhra të titullarit të institucionit me të njëjtat ekstremitetet (*datë dhe numër protokollit*) por me ndryshim në përbërjen e grupit për monitorimin e projektit (*Urdhri Nr. 20, datë 11.04.2024*);

➔dorëzimi i akteve administrative të brëndshme nga zyra e protokoll arkivit nuk bëhet me libër dorëzimi por komunikohet verbalisht pa lënë gjurmë në qarkullimin e dokumentacionit të brendshëm.

Nga auditimi i njëpasnjëshëm i vendimeve të Bordit dhe dosjeve të projekteve artistike për vitin 2023.

Vendimi Nr.1, datë 12.07.2023, ka miratuar nga pikëpamja artistike projektin “Kult-Art” me vlerë financimi 350,000 lekë sipas plan buxhetit të propozuar.

Konstatim:Procesverbali i mbledhjes së Bordit datë 12.07.2023 trajton:

- miratimin e Rregullores së BA, por nuk rezulton të jetë pasqyruar dhe përshkruar në dispozitivin e Vendimit Nr. 1,

-nuk trajtohet nëse është bërë thirrje për aplikim për projekte, kush i është përgjigjur thirrjes për aplikim, mënyra e përzgjedhjes së projekteve, kriteret e vlerësimit dhe publikimi i fituesit,

-nuk gjen pasqyrim për projektin e miratuar “Kult-Art”, analiza e çmimeve/tarifave për zërat buxhetorë, si dhe zërat buxhetore nuk kanë të përcaktuar sasinë e numrave akrobatikë që do të realizohen/për shfaqje si dhe sasinë e kostumeve të ideuara apo të ripërmirësuar nga kostumografi.

Veprimet e sipërme janë jo në përputhje me Ligjin Nr.8480, date 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 dhe 17, pasi BA

funksionon në zbatim të këtij ligji dhe është kompetencë e personit të ngarkuar me mbajtjen e këtij protokollit të mbledhjes.

Vendimi Nr.2, datë 25.10.2023 për miratimin nga pikëpamja artistike e projektit "ShakeSpirit", me vlerë financimi 1,480,000 lekë sipas plan buxhetit të propozuar.

Konstatim: Procesverbali i mbledhjes së Bordit datë 25.10.2023, nuk është i plotë pasi nuk pasqyrohet dhe përmban:

-përshkrim të detajuar të diskutimeve të anëtarëve të BA mbi zërat financiarë të propozuar të projektit;

-nuk është pasqyruar nëse projekti i vetëm që i është përgjigjur thirrjes për aplikim ka paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas shkresës Nr. 207, datë 11.09.2023 "Thirrje për aplikim",

-nuk përmban minutat e takimit të mbledhjes, veprime jo në përputhje me Ligjin Nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 16 dhe 17, kompetencë e mbajtësit të protokollit të mbledhjes M. D.

-Në dosjen e projektit nuk gjendet bashkëlidhur projektidea.

-Projekt Kostumografia që administrohet në dosjen e shpenzimeve të kryera nga Sektori i Financës për komponentët e projektit është një album fotografik dhe jo skicë ide e realizuar nga kostumografi si krijimtari për kostumet sipas personazheve të skenarit.

-Në plan buxhetin e projektit "ShakeSpirit", nuk janë detajuar në mënyrë analitike zërat buxhetorë, pasi nuk parashikohet numri i shfaqjeve, numri i kostumeve të përgatitura/skicuara apo të ripunuara.

-Preventivi i parashikuar dhe i miratuar nga BA parashikon zërin buxhetor "kostumografi qera (kostumet)" në vlerën 400,000 lekë dhe zërin "kostumografi" në vlerën 150,000 lekë. Nga BA nuk është analizuar arsyeja e marrjes së kostumeve me qera, numri i tyre si dhe e drejta e marrjes me qira nga kostumografi, veprime jo në përputhje me Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar neni 11, germa "ç".

Veprimet e sipërme janë kompetencë e BA (E. N., E. Ç., O. C., D. D. dhe F. S).

-Me kostumografin A.R. është lidhur kontrata e shërbimit Nr.352/2, datë 12.12.2023 për kostumografinë dhe në të njëjtën kohë kostumografi A.R ka nënshkruar një kontratë qeraje Nr. 353 datë 12.12.2023 për 80 kostume me shoqërinë "S.B.", pa e patur një tagër të tillë në kontratën Nr.352/2, datë 12.12.2023. Gjithashtu nga kronologjia e protokollimit të akteve në regjistrin e protokollit del që kontrata e qirasë me Nr. 353 prot., të jetë lidhur më parë se kontrata e shërbimit me kostumografin me Nr. 352/2 prot., pasi numri del me fraksion dhe janë në të njëjtën datë.

Në nenin 2, pika 2, të kontratës Nr. 52/2, datë 12.12.2023 është parashikuar detyrimi i kostumografit të "angazhojë me detyra të caktuara persona të tjerë ndihmës" dhe në asnjë rast nuk del detyrimi i tij për të nënkontraktuar me të tretë. Nga ana tjetër në kontratën e qirasë, neni 3 përcaktohet se kostumografi "përfiton shpërblimin në shumën 150,000 lekë për krijimtarinë dhe shuma prej 400,000 lekë parashikuar në preventivët e miratuar për realizimin (marrjen me qera) të kostumografisë së Projektit do të kalojë kostumografit A.R.", por në asnjë rast nuk përcaktohet e drejta e "kostumografit" për të nënkontraktuar me të tretë.

Në kushte të tilla, nga CK është anashkaluar procedura e blerjes/marrjes me qera me prokurim publik, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar neni 1 dhe 2, kompetencë e ish titullarit L.Y.

-Referuar Konstatës së qirasë Nr. 353 datë 12.12.2023, në nenin 2, pika 4 përcaktohet qartë se "Qiramarrësi ka të drejtën të zgjedhë dhe të përcaktojë kostumet kundrejt çmimit...", që në kuptimin literal kostumografi ka të drejtën e zgjedhjes së kostumeve kundrejt çmimit nga qiramarrësi dhe jo detyrimin, për të krijuar kostumet referuar skenarit apo konceptit regjisorial. Në këtë këndvështrim kostumografi paraqitet në cilësinë e "ndërmjetësit"/"agjentit" për përzgjedhjen e kostumeve dhe marrjen me qera, si dhe nuk përcaktohet asnjë specifikim artistik për 80 kostumet me qera.

-Me fletë hyrje Nr.1, datë 28.12.2023, janë bërë hyrje në magazinë nga kostumografi 80 kostume me vlerë 400,000 lekë me TVSH. Bashkëlidhur praktikës së magazinës nuk ka urdhër nga ish

titullari për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit si dhe një procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit/kostumeve, jo në përputhje me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 35, germa “b” sipas të cilit “Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në: Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi” si dhe “Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)”, veprime këto kompetencë e ish titullarit L.Y.

-Urdhëri Nr.69, datë 24.11.2023 i ish Drejtorit të Cirkut L.Y. për ngritjen e grupit të punës për hartimin e gjurmës së auditimit për projektin, nga përmbajtja nuk është i qartë pasi “gjurma e auditimit për projektet” është miratuar me Urdhërin Nr.70, datë 01.12.2023 dhe urdhëri duhet të ishte për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e “gjurmës së auditimit”.

Shënim: Mbi veprimtarinë e Cirkut për vitin 2022-deri në Tetor 2023, është ushtruar auditim nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën e cila ka përcjellë me shkresën Nr.4414/7, datë 26.12.2023 Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet.

Gjithashtu nga Ministria e Financave/Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në inspektimin e kryer në vitin 2024 me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën referuar Raportit të Auditit të Brendshëm të kësaj ministrie është kontrolluar zbatimi i ligjshmërisë në lidhje me procedurat e kryera për evidentimin, marrjen në dorëzim të sendeve të inventarizuara të Çadrës së Demoluar etj., kryerjen e inventarit të aktiveve për vitin 2022-2023 dhe gjendjen kontabël të aktiveve duke dalë me rekomandimet përkatëse, masa organizative, shpërblim dëmi dhe propozimin për kallëzim penal për “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim i dokumentacionit”.

Nga auditimi i njëpasnjëshëm i vendimeve të Bordit dhe dosjeve të projekteve artistike për vitin 2024.

Për vitin 2024, është publikuar thirrja për aplikim të projekteve artistike për kalendarin artistik 2024, me shkresën nr. 25, datë 25.01.2024. Për këtë thirrje kanë shfaqur interes dhe janë paraqitur projektet:

- Surprizë pranverore,
- Cirkuit,
- Klloun,
- Gjenerata X
- Puhë Legjende.

Konstatim: Mungon memo për hapjen e thirrjeve për projekte artistike.

Në datën 21.03.2024 është mbledhur Bordi me objekt “paraqitjen për miratim të projekteve dhe aktiviteteve mbi kalendarin artistik 2024”.

Vendimi Nr.1, datë 21.03.2024 BA, ka miratuar repertorin artistik për periudhën Prill-Dhjetor 2024, si dhe plan buxhetet për secilin projekt të propozuar:

- Klloun, me vlerë financimi 620,000 lekë
- Puhë legjende, me vlerë financimi 1,320,000 lekë,
- Gjenerata X, me vlerë financimi 430,000 lekë.

Konstatim: Në procesverbalin datë 21.03.2024 të BA dhe në Vendimin Nr.1 të tij, nuk janë trajtuar në mënyrë të detajuar zërat buxhetorë, pasi Bordi nuk është shprehur për numrin e

shfaqjeve, numrin/sasinë e kostumeve që duhet të krijohen apo të ripunohen, veprime në koompetencën e BA (E. N., D. D., F.S. dhe B. A).

Për zbatimin e projektit “Klloun” kanë dalë aktet administrative të ish-drejtorit L.Y.

-Urdhëri nr.20, datë 11.04.2024 për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e projektit, rezulton të jetë protokolluar 2 herë në Zyrën e Protokoll Arkivit me të njëjtat ekstremite (Nr. 103 prot, datë 11.04.2024) ku njëri akt ka ndryshim në përbërjen e grupit të punës (në njërin akt grupi përbëhet nga (L. Z, A. H. dhe E.T.) ku rezulton të jetë bërë shënimi me shkrim dore nga ish titullari duke ndryshuar përbërjen e anëtarëve dhe protokolluar ky akt me të njëjtin numër por me ndryshimet në përbërje të grupit (L. Z, A. H., E. H. dhe J. K).

-Mungon relacioni nga grupi i punës së ngritur me Urdhër të titullarit nr.20, datë 11.04.2024 (L. Z,A. H., E. H. dhe J. K.) me pretendimin se nuk janë vënë në dijeni nga Zyra e protokoll arkivit, pretendim ky i trajtuar në relacionin e grupit të punës për zbatimin e gjurmës së auditimit Nr. 198, datë 15.07.2024.

Zyra e Protokoll Arkivit nuk disponon libër dorëzimi për aktet e brëndshme pasi nuk ka patur një të tillë deri në Nëntor 2024. Në vijim është operuar me libër dorëzimi dokumentacioni Mod.4/1. Komunikimi i shkresave në këtë periudhë bëhet me aplikacionin WhatsApp apo verbalisht për mungesë të postës zyrtare elektronike (e mail) të institucionit.

Në relacionin Nr.198 prot, datë 15.07.2024, grupi i punës për monitorimin e projektit (R.F., J. K. dhe I. M.) nuk është shprehur për procedurën e ndjekur nga BA dhe grupet e punës për zbatimin e projektit referuar “gjurmës së auditimit” për këto pika:

-pika 3 ”Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit të projekteve artistike”, nuk është trajtuar nëse janë përcaktuar kriteret e vlerësimit të projekteve,

-pika 4 “Vlerësimi i projekteve nga BA”, nuk është trajtuar procedura e ndjekur nga BA bazuar në kriteret e vlerësimit për projektet,

-pika 8 “Administrimi i dosjeve të projekteve” është trajtuar vetëm që dokumentacioni i hartuar është arkivuar në Zyrën e Protokoll Arkivit dhe Sektorit të Financës pa u përmendur që nuk është inventarizuar dokumentacioni sipas kërkesave të “gjurmës së auditit”. Veprimet e sipërme janë komepetencë e grupit për ndjekjen dhe zbatimin e projektit.

Në mbledhjen e Bordit datë 14.05.2024 janë marrë në shqyrtim projektet:

Gjenerata X dhe Guri i Magjistarit.

Vendimi Nr.2, datë 15.05.2024, ka miratuar projektin:

-Gjenerata X, me vlerë financimi 0 lekë dhe jo 430,000 lekë siç ishte miratuar në Vendimin Nr.1 të BA.

Në mbledhjen e BA datë 31.10.2024 janë marrë në shqyrtim problematikat e dala për realizimin e shfaqjes për 65 vjetorin e Cirkut si dhe në datë 05.11.2024, u morën në shqyrtim çështjet në lidhje me realizimin e shfaqjes për 65 vjetorin e Cirkut si dhe është nxjerrë nga Drejtori i Cirkut (J.V.) akti administrativ/Urdhëri Nr.79, datë 05.11.2024 për ngritjen e grupit të punës për organizimin e programit artistik etj.

Nuk rezulton që BA të ketë dalë me vendime nga këto mbledhje.

Në mbledhjen e BA datë 04.12.2024, u mor në shqyrtim vlerësimi i aplikimeve në kuadër të 65 vjetorit të Cirkut,planet artistike dhe menaxheriale për 2025.

Konstatim:Në procesverbalin e mbledhjes, nuk pasqyrohet në mënyrë të detajuar preventivi i projektit ”Kartolina Urimi për 65 vjetor” dhe preventivit bashkëngjitur, projekt i vlerësuar fitues. sipas zërave buxhetore, konkretisht numri i shfaqjeve.

Vendimi Nr.3, datë 04.12.2024 BA ka miratuar projektin “Kartolina urimi në 65 vjetor”, projekt i cili është i përfshirë në repertorin e miratuar për vitin 2024, me vlerë financimi 672,280 lekë.

Në lidhje me realizimin e projektit konstatohet se kanë dalë aktet administrative të titullarit të Cirkut:

Konstatim: Urdhëri Nr.92, datë 19.12.2024 i titullarit/Drejtorit të CK J. V. për miratimin e gjurmës së auditimit, nga përmbajtja nuk është i qartë, pasi “gjurma e auditimit për projektet” është miratuar me urdhër të titullarit në 2023.

-mungon relacioni mbi zbatimin e gjurmës së auditimit nga grupi i punës (R. F. E. H. dhe I. M.) ngritur me Urdhrin Nr.92, datë 19.12.2024,

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

Nga auditimi mbi veprimtarinë e Cirkut Kombëtar për vitin 2022-2024 u konstatua:

☞për vitin 2023, BA ka funksionuar me 5 anëtarë dhe jo 7, për vitin 2024 me 6 anëtarë për shkak të dorëheqjes së një anëtari, jo në përputhje me Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar neni 10, pika 3.

☞për vitin 2023, nuk është miratuar repertori artistik , jo në përputhje me Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010, i ndryshuar, neni 11, pika “b” si dhe me Statutin neni 3, pika 4;

☞tarifat për krijimtarinë artistike miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 12.07.2023 të BA nuk janë argumentuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar krahasuar me çmimet e tregut apo duke marrë një bazë krahasuese me tarifat e krijimtarisë për institucionet e tjera të artit dhe kulturës;

☞për vitin 2023-2024 të gjithë urdhërat e ish titullarit dhe titullarit të CK për ndjekjen dhe zbatimin e “gjurmës së auditimit të projekteve” nga pikëpamja e formulimit të udhërit nuk janë të qarta, pasi objekti i urdhrit është “ngritjen e grupit të punës për hartimin e gjurmës së auditimit”, në një kohë që kjo gjurmë është miratuar me Urdhrin Nr.70, datë 01.12.2023;

☞Rregullorja e funksionimit të Bordit miratuar me Vendimin Nr.1, datë 12.07.2023 si dhe Rregullorja e për funksionimin e brendshëm, miratuar nga Drejtori i CK nuk është përditësuar me proceset e punës për zbatimin e “gjurmës së auditimit të projekteve” miratuar me Urdhrin Nr.70, datë datë 01.12.2023;

☞kontratat e shërbimit me artistët nuk parashikojnë: penalitete për vonesa në realizimin e shërbimit, afatet, kalendarin e shfaqjeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve në mënyrë specifike, të drejtën e pronësisë për kostumet apo materialet skenike të prodhuara për projektin konkret, si dhe detyrimet mbi të drejtën e autorit, jo në përputhje me parimet e përgjithshme të Kodit Civil për kontratat e shërbimit;

☞në disa raste mungon relacioni përmbledhës mbi zbatimin e gjurmës së auditimit të projekteve;

☞publikimi i thirrjeve për aplikim projektesh bëhet në rrjete sociale (instagram) në adresë të CK;

☞dosjet e projekteve për periudhën 2023-2024 nuk janë të inventarizuara, nuk përmbajnë dokumentacionin sipas kërkesës së “gjurmës së auditimit” (*skenarin, konceptin regjisorial, projekt skenografi, projekt kostumografi dhe preventivin sipas zërave*) jo në përputhje me Ligjin “Për arkivat” si dhe Urdhrin Nr.70, datë 01.12.2023 për miratimin e “gjurmës së auditimit të projekteve”;

☞aktet administrative dalë për zbatimin e projekteve në disa raste për vitin 2024, kanë korrigjime në numrin e protokollit (si: *deklaratat e konfliktit të interesit, Vendimi Nr.1, datë 21.03.2024 i Bordit*);

☞në 2 raste, (2023), administrohen nga Zyra e Protokoll Arkivit dy shkresa me të njëjtën përmbajtje dhe datë por me numra të ndryshëm protokollit (*shkresa me objekt thirrje për aplikim projektesh Nr.207, datë 11.09.2023 dhe nr.206, datë 11.09.2023*) si dhe 1 rast (2024), administrohen nga Zyra e Protokoll Arkivit 2 urdhra të titullarit të institucionit me të njëjtat ekstremitetet (*datë dhe numër protokollit*) por me ndryshim në përbërjen e grupit për monitorimin e projektit (*Urdhri Nr. 20, datë 11.04.2024*);

☞dorëzimi i akteve administrative të brëndshme nga zyra e protokoll arkivit nuk bëhet me libër dorëzimi por komunikohet verbalisht pa lënë gjurmë në qarkullimin e dokumentacionit të brendshëm.

Veprimet e sipërme janë përgjegjësi dhe koompetencë e Bordit Artistik sipas rasteve trajtuar më sipër, ish titullarit të CK për periudhën 2023-2024 dhe titullarit të CK për periudhën Nëntor-Dhjetor 2024, grupit për monitorimin e projektit, grupit për zbatimin e “gjurmës së auditimit” të projekteve, sipas rasteve trajtuar më sipër dhe Specialistit të Zyrës së Protokoll Arkivit dhe në cilësinë e mbajtësit të procesverbalit të mbledhjes së BA.

2.6 Funkcionimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2024.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit pranë Cirkut Kombëtar u realizua bazuar në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar si dhe aktet e tjera nënligjore.

Sipas përcaktimeve të këtij ligji, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve publike. *Kontrolli i brendshëm* përbëhet nga pesë komponentë të ndërlydhur, të cilët ndër veprojnë me njëri-tjetrin, si më poshtë:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi i riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informimi dhe komunikimi;
- Monitorimi.

Lidhur me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi si më poshtë:

I. Mjedisi i Kontrollit

Ky komponent i kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli në një njësi të caktuar. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë, filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës, mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta, organizon e zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep niveli drejtues. Ky mjedis ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë dhe marrëdhëniet e llogaridhënies.

Cirku Kombëtar është institucion publik qëndror i artit e kulturës, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Ai ka si objekt të veprimtarisë së tij, mbështetjen në vlerat e kulturës dhe artit kombëtar, si dhe në vlerat më të mira të kulturës dhe artit botëror. Cirku Kombëtar organizohet dhe funksionon në zbatim të Ligjit Nr. 10352, datë 18.11.2010, “*Për Artin dhe Kulturën*”, Statutit të miratuar nga ministri përgjegjës për kulturën, dërguar me shkresën nr. 843 prot, datë 05.02.2013, si dhe Rregullores së brendshme, protokolluar me shkresën nr. 116 prot, datë 20.03.2024.

Misioni i tij është ruajtja dhe lartësimi i identitetit kombëtar duke nxitur krijimin dhe interpretimin e veprave cilësore nëpërmjet profileve të akrobacisë, ekuilibrit, ajrit, dresimit, zhoglimit, kllounatës, iluzionit si dhe nëndarjet e tyre.

1.1 “Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike”.

Në referencë të Ligjit Nr. 9131, datë 08.09.2003, “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar, kap. III, pika 3.1, kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje.

CK nuk ka hartuar një kod etike por rregullat e përgjithshme të sjelljes së etikës janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të tij. Mungojnë përcaktime të veçanta për zbatimin e parimeve të etikës, rregullat e klasifikimit të veprimtarive të jashtme, dhuratat dhe favoret, si dhe këshillimi, trajnimi, e mbikëqyrja për zbatimin e tyre. Për periudhën 2022-2023 institucioni ka funksionuar sipas rregullores së brendshme të miratuar nga drejtori i institucionit, protokolluar me shkresën nr. 116 prot, datë 11.03.2013, me fuqi ligjore deri në miratimin e rregullores së re në datën 20.3.2024.

1.2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

CK nuk ka hartuar objektiva afatmesëm dhe vjetorë si dhe planet e veprimit në mënyrë që të monitorojë zbatimin e tyre, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa "a"⁶ dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kap. II , pika, 2.4.1.

Për periudhën **2022-2024**, titullari i institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA) nuk ka garantuar mbikëqyrje lidhur me projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë, pasi nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm. Veprimi i sipërm është në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011, i Ministrit të Financave “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, dhe Udhëzimit nr. 02, datë 26.01.2024 i Ministrit të Financave “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Nëpërmjet deklaratës, NA merr përsipër përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo financiarë të njësisë, si dhe pohon se sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë së tij. Raporti Vjetor mbi gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm hartohet në kuadrin e aktiviteteve monitoruese të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Ky dokument përmban një vlerësim të përgjithshëm të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë, informacione mbi gjetjet e auditimit të brendshëm e të jashtëm si dhe masat që janë marrë ose do të ndërmerren për përmirësimin e këtij sistemi.

Për organizimin e brendshëm të procesit të hartimit të raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike që ka detyrimin për raportim ndërmerr veprime për mbledhjen e informacionit për hartimin e raportit dhe të deklaratës përmes pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e MFK. Deklarata, së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti i paraqitet nëpunësit të parë autorizues në Ministrinë e Financave. Për sa më sipër, **nuk janë përmbushur këto detyrime.**

-Sa i përket delegimit të kompetencave, konstatohet se CK nuk ka rregulla të brendshme që trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

- Lidhur me detyrimet ligjore që burojnë nga Ligji Nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” si dhe VKM-së nr. 816, datë.16.11.2016, “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike”, rezultoi se, mungojnë rregullat për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit.

⁶ “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a)propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi...”.

1.3 Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë. Për periudhën objekt auditimi, CK ka funksionuar sipas kufirit organik të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 135, datë 28.3.2014, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Cirkut Kombëtar” dhe ka një numër të përgjithshëm prej 38 punonjësish. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe ka përbërjen si vijon: Drejtori, Sektori Teknik, Sektori Artistik dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse. Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë administrative dhe artistike të institucionit të Cirkut Kombëtar realizohen respektivisht nga titullari i institucionit dhe Bordi Artistik.

Për periudhën 2022-2024, institucioni është drejtuar nga këta titullarë sipas periudhave respektive:

A.H. (29.12.2021-31.8.2022)-Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr.845, datë 29.12.2021;

A. B. (31.8.2022- 13.4.2023)- Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr.579, datë 31.8.2022;

L. Y. (13.4.2023 –18.9.2024)-Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr.229, datë 13.4.2023;

M. Q. (18.9.2024- 16.10.2024)-Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr.707, datë 18.9.2024

J. V. (16.10.2024-në vazhdim)-Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr.652, datë 16.10.2024

Bordi Artistik⁷ është organizëm kolegjal pranë Cirkut Kombëtar, i cili funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 8480, datë 27.05,1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. BA, drejtohet nga Drejtori i Cirkut Kombëtar dhe gjatë vitit 2023, ka pasur në përbërje 5 anëtarë, ndërsa gjatë 2024 përbëhej nga 6 anëtarë. Anëtarët e tij propozohen nga titullari i institucionit dhe miratohen nga Ministri përgjegjës për kulturën.

Për periudhën objekt auditimi **2022-2024**, vende të lira/vakante⁸ sipas viteve ka qenë si vijon: për vitin 2022-7 vende të lira, për vitin 2023-8 vende të lira dhe për vitin 2024- 5 vende të lira. Rregullorja Cirkut Kombëtar, protokolluar me shkresën nr.116 prot, datë 20.03.2024 bazohet në strukturën organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 135, datë 28.3.2014, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Cirkut Kombëtar”.

NA është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të MFK, në të gjitha njësitë, strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndosh financiar dhe transparencës. NZ për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse. Emërimi i Nëpunësit Zbatues (NZ), zj. R.F. është bërë me shkresën nr.631/1 prot, datë 13.02.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës.

Sa i përket përshkrimit të punëve për punonjësit e Cirkut Kombëtar, pozicionet aktuale në strukturë e kanë të reflektuar përshkrimin e punës në rregulloren e sipërcituar. Gjithashtu në rregulloren e brendshme janë parashikuar pjesërisht rregulla për hartimin dhe qarkullimin e akteve administrative gjatë përmbushjes së funksioneve të strukturave të brendshme të saj. Lidhur me procedurat e rekrutimit të punonjësve, në Rregulloren e brendshme nr.116 prot, datë 11.3.2013 përcaktohet se punonjësit e Cirkut Kombëtar punësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me konkurs dhe pas kalimit të periudhës së provës, ndërsa në rregulloren e protokolluar me shkresën nr.116 prot, datë 20.03.2024, përcaktohet se njoftimet për pozicionet e lira të punës publikohen në faqen zyrtare të Cirkut Kombëtar/Buletin e Njoftimeve Publike si dhe i komunikohen Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Publike. Verifikimi i plotësimi të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit kryhet sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme.

Konstatim: Për periudhën **2022-2024**, rezulton se janë rekrutuar **7** punonjës, për të cilët nuk është kryer publikimi i njoftimeve për vendet e lira në faqen zyrtare të institucionit dhe

⁷ Veprimtaria e bordit trajtohet në pikën 2.5 të programit të auditimit.

⁸ Trajtuar në pikës 2 të programit “Auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave”

buletin e njoftimeve publike, veprim në kundërshtim me nenin 9, të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë,” neni 12, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (i ndryshuar), neni 5 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 9, pika 4, shkronja dh) të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, pikës 1 dhe 2 të VKM-së nr. 176, datë 29.3.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, nenin 4 dhe 5 të Rregullores së Cirkut Kombëtar, miratuar nga drejtori i institucionit, protokolluar me shkresën nr. 116 prot, datë 11.03.2013.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi në cilësinë e Titullari të Institucionit sipas periudhave përkatëse: z.A. B. për 2 raste dhe z.L.Y. për 5 raste.

Përsa i përket procedurave të largimit nga puna, për periudhën 2022-2024 konstatohet se nuk kryej dorëzimi me procesverbal i aktiveve në ngarkim të personelit të larguar nga puna. Veprime në kundërshtim me nenin 11, pika 4, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 (i ndryshuar), si dhe pikën 13, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

1.4 Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave.

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë dhe veprimet disiplinore, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Burimet njerëzore, referuar strukturës së miratuar menaxhohen nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse. Sektori mbulon çështjet që kanë të bëjnë me procedurat e emërimit dhe largimit nga detyra, procedurat disiplinore, administrimin e dosjeve të personelit, plotësimin e regjistrit të personelit, përgatitjen e përshkrimeve të punës.

Lidhur me trajnimin e punonjësve gjatë periudhës objekt auditimi rezultoi se: i) nuk janë analizuar nevojat për trajnim, ii) nuk janë hartuar plane trajnime e për pasojë nuk janë zhvilluar trajnime për punonjësit. Sipas intervistimit të subjektit kjo situatë ka ardhë për shkak të bllokimit⁹ të fondeve buxhetore të Cirkut Kombëtar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të palës kreditore (Shoqëria “U.” SHPK), bllokim i cili ka vijuar deri në datën 21.01.2025. Megjithatë referuar VKM nr. 138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil”, pas ndryshimeve nëpërmjet VKM nr. 687, datë 18.11.2021, në kreun III, pika 9/1, përcaktohet se: “nëpunësit e administratës publike jashtë shërbimit civil trajnohen nga ASPA nëpërmjet programit të formimit të vazhdueshëm, për veprimtari administrative të lidhura ngushtësisht me detyrën, trajnime të cilat përcaktohen nga institucioni ku janë të punësuar apo nga institucione të tjera përgjegjëse për fusha të caktuara. Nga institucioni i Cirkut Kombëtar nuk rezulton të jetë iniciuar asnjë korrespondencë paraprake me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, institucion publik i krijuar sipas nenit 8, pika 1, 2, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me mision parësor trajnimin e nëpunësve civilë dhe nëpunësve të tjerë të administratës publike.

Referuar nenit 4.4 të Rregullores së brendshme të Cirkut Kombëtar, protokolluar me shkresën nr. 116 prot, datë 20.03.2024, vlerësimi i rezultateve në punë të punonjësve kryhet një herë në vit. Në varësi të strukturës organizative vlerësimi bëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe drejtori i cirkut.

Konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve. Vlerësimi i performancës inkurajon zhvillimin profesional të punonjësve dhe ofron mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt. Bazuar në nenin 9, pika 4, shkronja dh) të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 (i ndryshuar), përcaktohet se:

⁹ Shkresë nr.4838/6 prot, datë 03.8.2021 e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Dega Tiranë.

“Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:-mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

II. Menaxhimi i Riskut

2.1 Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen për arritjen e objektivave të vendosura. Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, për periudhën **2022-2024** u konstatua se:

-Institucioni i CK nuk ka të përcaktuara objektivat institucionalë si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Institucioni nuk ka krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut pasi, nga ana e titullarit nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, organ i cili luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike; GMS duhet të sigurojë që komponentët e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi efektiv i risqeve janë të pranishëm dhe funksionojnë siç duhet në njësinë publike. Veprime në kundërshtim me nenin 8, pika 8, shkronja b), të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 (i ndryshuar);

-Nuk është hartuar *Strategjia e Menaxhimit të Riskut/ Plani i menaxhimit për trajtimin e risqeve*, dokumenti që përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve si dhe kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut, veprime në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, të ndryshuar,

-Nëpunësi autorizues i Cirkut Kombëtar, në rolin e Koordinatorit të MFK-së nuk ka përmbushur detyrimin e përgatitjes dhe nënshkrimit të deklaratës dhe të raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm bazuar në nenin 18 të Ligjit të MFK.

2.2. *Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.*

Nga strukturat përgjegjëse nuk kryhet identifikimi, vlerësimi, kontrolli dhe monitorimi i risqeve në të gjitha nivelet e saj me qëllim arritjen e objektivave dhe si rrjedhojë nuk është dokumentuar procesi i menaxhimit të riskut në një regjistër, veprime në kundërshtim me nenin 11, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”(i ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016, “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”.

2.3. *Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.*

Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Institucioni i Cirkut nuk ka

rregullore mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe nuk ka evidenca të vlerësimit dhe monitorimit të riskut të mashtrimit.

2.4. Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Nga subjekti nuk janë analizuar apo marrë në konsideratë ndikimet e mundshme ekzistuese në sistemin e kontrollit të brendshëm.

III “ Aktivitetet e Kontrollit”

3.1 Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivite kontrolli.

Aktivitetet e kontrollit janë rregulla, procedura dhe veprime që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 të ndryshuar përcaktohet se *“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”*.

-Titullari i institucionit nuk ka hartuar gjurmën e auditimit për procese kryesore si; menaxhimi i aktiveve, procedura e marrjes në dorëzim të mallrave, ekzekutimi i shpenzimeve, procedura për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit sipas përcaktimit në nenin 16, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 (i ndryshuar).

Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, janë përcaktuar përgjegjësitë, por mungojnë rregulla të veçanta lidhur me administrimin, komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, mënyrën e mbajtjes së dosjes së personelit, procedura e sinjalizimit, mënyra e mbajtjes së korrespondencës me strukturat brenda njësisë dhe me njësitë e tjera etj.

-Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të institucionit hartohet nga CK dhe dërgohet për miratim në Ministrinë përgjegjëse për kulturën.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimit i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve mbështetëse. Hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialisti i sektorit, ndërsa autorizimi i pagesës nga NA.

-Lidhur me prokurimet publike, për periudhën objekt auditimi institucioni i Cirkut Kombëtar nuk ka hartuar regjistër parashikimi dhe realizimi vjetor të prokurimeve publike për arsye të mungesës së fondeve, pasi Dega e Thesarit me shkresën nr.4838/6 prot datë 03.8.2021 ka vendosur masën e sekuestros në shpenzimet operative (artikulli buxhetor 602), në masën e vendimit gjyqësor të formës së prerë në favor të palës U. SHPK.

-Në kuadër të detyrimeve ligjore për menaxhimin e aktiveve konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer procedurat e inventarizimit, vlerësimit, tjetërsimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve. Nga titullari i institucionit nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave të brendshëm lidhur me përcaktimin e përgjegjësive në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, nxjerrjes nga përdorimi. Veprime në kundërshtim me nenin 9, pika 4 shkronja ë) të Ligjit¹⁰ nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar si dhe pikave 73 dhe 74 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ku përcaktohet se *“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet*

¹⁰ *“Nëpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:- përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar”*.

inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”. Gjithashtu mos realizimi i vlerësimit të aktiveve nga institucioni ndikon në mos planifikimin efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.

IV. “Informimi dhe Komunikimi”

4.1 Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor.

Institucioni i Cirkut Kombëtar nuk disponon faqe zyrtare në ëeb, si mjet informimi publik që garanton akses në informacione që lidhen me buxhetin e miratuar; raportet periodike të zbatimit të buxhetit, pasqyrat vjetore financiare; statistika mbi prokurimet; kontratat e lidhura; raporte të auditimit të jashtëm për njësinë, etj. Bazuar në nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*” i ndryshuar, Autoriteti Publik duhet të publikojë programin e transparencës (PT) sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit si dhe kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik. Autoriteti duhet të rishikojë e përditësojë PT në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit të tij institucional, kuadrit ligjor apo çdo element tjetër që ka lidhje me transparencën pro aktive në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

-Gjithashtu institucioni nuk ka krijuar postë elektronike si mjet komunikimi zyrtar të brendshëm me qëllim transmetimin e informacionit te punonjësit. Në mungesë të postës elektronike, njohja e punonjësve të institucionit me aktet ligjore e nënligjore si dhe me ndryshimet e tyre, nuk dokumentohet në formën e afishimit të tyre apo përmes procesverbale të mbledhjeve, në mospërputhje me nenin 8, pika 8, shkronja “c” të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar.

V. “Monitorimi dhe Raportimi”

Referuar përcaktimit ligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit “*Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme së aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur*”.

Nga auditimi i veprimtarisë së subjektit lidhur me monitorimin e sistemeve të MFK u konstatua se nuk kryhej vlerësimi i zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm pasi nuk janë plotësuar pyetësorët e vetëvlerësimit për funksionimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nga drejtuesit e strukturave të saj. Gjithashtu nuk është hartuar deklarata dhe raporti i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm. Veprime në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.28, datë 15.12.2011, i Ministrisë të Financave “*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike*”, Udhëzimit nr. 02, datë 26.01.2024, i Ministrisë të Financave “*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike*”.

CK nuk ka njësi të Auditit të Brendshëm, kjo pasi nuk plotësohen kriteret e kërkuara në pikën 1 të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”, por shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga Ministria përgjegjëse për kulturën. Dobësitë e kontrollit të brendshëm për periudhën 01.10.2021-31.8.2023 janë analizuar dhe adresuar përmes auditit të brendshëm nga Ministria e Kulturës. Nëpunësit Autorizues nuk kanë marrë masa për hartimin e planit të menaxhimit për veprime përmirësuese.¹¹

Për periudhën 2022-2024, nuk janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në kundërshtim me nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e Sistemit*

¹¹ Raport përfundimtar auditimi nr.330/2 prot, datë 28.12.2023.

Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, kreu II dhe kreu III, i ndryshuar.

Duke qenë se numri i punonjësve, veçanërisht Sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe financës është mjaft i vogël, numër i cili nuk mundëson ndarje të detyrave dhe monitorim sipas hierarkisë, i njëjti punonjës mund të ndjekë një proces pune nga fillimi në fund, pa patur monitorim nga një nivel më i lartë hierarkie. Raportimet periodike për veprimtarinë e kryer konsistojnë në raportimin me shkrim tek titullari nga çdo përgjegjës sektori për aktivitetin mujor. Organizimi i përgjithshëm në punë bëhet mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara nga bordi artistik dhe titullari.

Veprimet e sipërme janë kompetencë e titullarëve të CK sipas periudhave respektive Drejtor në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e Nëpunësit zbatues.

Konkluzion:

Nga auditimi për periudhën 2022-2024 mbi komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi:

Mjedisi i kontrollit

☞ Nga NA/titullari nuk është hartuar Deklarata dhe raporti i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011.

☞ Nuk janë hartuar objektiva afatmesëm dhe vjetorë si dhe planet e veprimit në mënyrë që të monitorojë zbatimin e tyre sipas përcaktimeve në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, neni 9, pika 4, germa "a" .

☞ Për rekrutimin e 7 punonjësve (2022-2024) nuk është kryer publikimi i njoftimeve për vendet e lira në faqen zyrtare të institucionit dhe buletinin e njoftimeve publike në kundërshtim me nenin 9, të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 neni 12, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit nr. 44/2015, neni 9, pika 4, shkronja “dh” të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, pikës 1 dhe 2 të VKM-së nr. 176, datë 29.3.2006, nenin 4 dhe 5 të Rregullores së Cirkut Kombëtar, protokolluar me shkresën nr. 116 prot, datë 11.03.2013.

☞ Në rastet e largimeve nga puna, dorëzimi i aktiveve dhe i dokumentacionit zyrtar në ngarkim të personelit të larguar nga puna nuk bëhet me procesverbal, në kundërshtim me nenin 11, pika 4, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 i ndryshuar, si dhe pikën 13, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

☞ CK nuk ka rregulla të brendshme që trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

☞ Nuk ka rregulla për procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të Ligjit nr.60/2016 si dhe VKM-së nr. 816, datë.16.11.2016.

☞ Nuk janë hartuar plane trajnimi e për pasojë nuk janë zhvilluar trajnime për punonjësit si pasojë e bllokimit të fondeve buxhetore në kuadër të ekzekutimit të vendimit gjyqësor në favor të palës kreditore (Shoqëria “U.” SHPK). Bllokim i cili ka vijuar deri në datën 22.01.2025.

☞ Nuk janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve në kundërshtim me nenin 9, pika 4, shkronja “dh” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar si dhe nenit 4.4 të Rregullores së brendshme të Cirkut Kombëtar, protokolluar me shkresën nr. 116 prot, datë 20.03.2024.

Menaxhimi i Riskut

☞ Për periudhën objekt auditimi nuk janë krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut nga titullari nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, veprime jo në përputhje me nenin 8, pika 8/b të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar.

☞ Nuk është hartuar *Strategjia e Menaxhimit të Riskut/Plani i menaxhimit për trajtimin e risqeve*, jo në përputhje me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar.

☞ Nuk kryhet identifikimi, vlerësimi, kontrolli dhe monitorimi i risqeve në të gjitha nivelet e saj me qëllim arritjen e objektivave dhe si rrjedhojë nuk është dokumentuar procesi i menaxhimit të riskut në një regjistër. Nuk ka evidenca të vlerësimit dhe monitorimit të riskut të mashtrimit nga niveli i lartë si dhe planit të veprimit jo në përputhje me nenin 11, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr. 16, dt.20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

☞ Mungojnë rregullat për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit si dhe evidenca të sinjalizimeve.

Aktivitetet e Kontrollit

☞ Nuk është hartuar gjurma e auditimit për procese kryesore si; menaxhimi i aktiveve, procedura e marrjes në dorëzim të mallrave, ekzekutimi i shpenzimeve, procedura për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit sipas përcaktimit në nenin 16, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar.

☞ Nuk janë kryer procedurat e inventarizimit, vlerësimit, tjetërsimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, nuk janë marrë masa për përcaktimin e përgjegjësive në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi. Veprime në kundërshtim me nenin 9, pika 4 shkronja “ë” të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar si dhe pikave 73, 74 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar,

Informimi dhe Komunikimi

☞ CK nuk disponon faqe zyrtare në ëeb si mjet informimi publik bazuar në nenin 7, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, nuk ka një postë elektronike si mjet komunikimi zyrtar të brendshëm me qëllim transmetimin e informacionit, jo në përputhje me nenin 8, pika 8, shkronja “c” të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar.

Monitorimi dhe Raportimi

☞ Nuk janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me nenin 65 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 dhe UMF nr.22, datë 17.11.2016 kreu II dhe kreu III, i ndryshuar.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave duke pasur parasysh:

A.MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për periudhën 2022-2024 rezultoi se:

-Gjatë vitit 2022 konstatohet se planifikimi për zërin 231 rezulton në vlerën 352 mijë lekë dhe realizimi rezulton 0 lekë me mosrealizim në masën 100%;

-Për vitin 2023, zëri buxhetor 606 “Fond i veçantë” është planifikuar në vlerën 288 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 253 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 35 mijë lekë krahasuar me planin përfundimtar;

-Për vitin 2024, zëri buxhetor 604 “Transferta të brendshme” është planifikuar në vlerën 1,500 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,299 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 201 mijë lekë, krahasuar me planin fillestar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të Cirkut të marrë masa për planifikimin e zërave të buxhetit duke kryer një analizë të detajuar dhe duke u bazuar te realizimet e viteve paraardhëse, në mënyrë të tillë që të ulen rastet e rialokimit dhe shpërndarjes së fondeve buxhetore gjatë vitit.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës dhe pagesave të kryera për ekzekutimin e titullit ekzekutiv “Vendim nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” me palë kreditore Shoqëria “U. SHPK”, referuar urdhër shpenzimeve rezultoi se, nga Zyra përmbarimore “K.B.S.” nuk janë vendosur në dispozicion të Cirkut në çdo rast faturat për tarifat përmbarimore. Fatura nr. 40 nga zyra përmbarimore është lëshuar në datën 03.02.2025 ku përfshihen zëra: tarifë pjesore përmbarimore, tarifë shpenzime përmbarimore, tarifë për çmontimin e çadrës së Cirkut, tarifa e ekspertit për demolim çadre, tarifë eksperti hartim akti dhe shërbim ruajtje dhe siguri fizike. Si rrjedhojë në momentin e kryerjes së likuidimit me Urdhër Shpenzimin nr. 137, datë 20.01.2025 sipas akt marrëveshjes nr. 353, datë 06.11.2024, Cirkut nuk ka pasur dokumentin justifikues “faturë tatimore” në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë” pika 61.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të Cirkut dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa që në vijimësi të administrojnë, bashkëngjitur urdhrat të shpenzimeve, të gjithë dokumentacionin justifikues shoqërues (fatura, kontrata, etj.) për çdo shpenzim të kryer.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Referuar monitorimit të buxhetit, për vitet 2022-2023 rezultoi se:

-Nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (NZ) nuk janë hartuar relacione/raporte mbi monitorimin e buxhetit por vetëm tabelat e anekseve, jo në përputhje me Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 dhe Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”. Për vitin 2022 janë hartuar anekset e monitorimit të buxhetit 4 mujore në datë 16.05.2022 dhe më pas është vijuar me anekset 12 mujore në datë 07.02.2023, në këtë aneks nuk është paraqitur vlera në llogarinë 231, si rrjedhojë ka diferenca midis raportimit të anekseve të monitorimit dhe rakordimit të bërë me thesarin me shkresën nr. 17 prot., datë 23.01.2023. Për vitin 2023, Cirkut Kombëtar ka hartuar 2 anekse monitorimi buxheti (4- mujor dhe 8-mujor) për zbatimin e buxhetit të këtij viti. Shkresat e dërgimit të raporteve të monitorimit ndër vite të sipërcituara nuk u vendosën në dispozicion të grupit të auditimit.

-Për vitin 2024, relacioni 8 mujor dhe 12 mujor për monitorimin e zbatimit të buxhetit dërguar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, buxheti total i planifikuar dhe i realizuar për vitin 2024, shprehur në këtë relacion, ka diferenca me buxhetin e planifikuar dhe realizuar sipas rakordimeve me thesarin, përkatësisht planifikimi ka diferenca në vlerën 100 mijë lekë dhe fakti ka diferenca në vlerën 100 mijë lekë.

-për vitet objekt auditimi 2022-2024, nuk është respektuar detyrimi i Cirkut për të publikuar në fillim të çdo viti, fondin publik të institucionit jo më vonë se 1 (një) muaj pas përcaktimit me hollësi të buxhetit të shtetit, në kundërshtim me Statutin e Cirkut neni 3, pika 2, kompetencë dhe përgjegjësi e titullarit të institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të Cirkut dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa për hartimin e relacioneve dhe tabelave të monitorimit të buxhetit çdo katër muaj, ku të pasqyrohen vlera të rakorduara ndërmjet raportimit në thesar dhe relacioneve përkatëse.

-Titullari i institucionit të marrë masa për përmbushjen e detyrimit në lidhje me publikimin e raporteve të monitorimit të buxhetit dhe publikimin në fillim të çdo viti të fondit publik të institucionit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Nëpunësi Zbatues me funksion përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse nuk ka hartuar regjistër për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra të institucionit, nuk ka kontabilizuar lëvizjet e materialeve sipas hyrje-daljeve për të dhënë një informacion të plotë para inventarizimit të përgjithshëm, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 dhe pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 30-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për hartimin e regjistrit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra si dhe kontabilizimin e lëvizjeve të materialeve sipas hyrje-daljeve që të disponohet informacion i plotë para kryerjes së inventarizimit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se:

Për vitet 2022 dhe 2023, nuk është realizuar inventarizimi i aktiveve, në kundërshtim me nenin 74 të UMF nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar; nuk janë paraqitur rezultate të inventarizimit duke bërë kështu të pamundur që zërat e aktiveve të paraqitura në Bilancin e Pasqyrave Financiare të Cirkut Kombëtar për vitet 2022-2023, të shprehin gjendjen reale të tyre në fund të vitit;

-Në kuadër të detyrimeve ligjore për menaxhimin e aktiveve u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer procedurat e inventarizimit, vlerësimit, tjetërsimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve.

-për rezultatet nga procesverbali mbi verifikimin e inventarit të Cirkut të zhvendosur nga ambientet e Cirkut me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr.66 prot datë 09.02.2022, të magazinuara në ambientet e Bunk-Art 1, ku u konstatuan inventarë të dëmtuar dhe të humbur në vlerën 9,359 mijë lekë, nuk janë ndërmarrë veprime të mëtijshme në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 30-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa të menjëhershme për realizimin e procedurës së inventarizimit, me qëllim kryerjen e një analize të detajuar konform udhëzimit të menaxhimit të aktiveve dhe kuadrit të raportimit financiar për vlerësimin e dëmtimeve të aktiveve nga transferimet dhe paraqitjen reale të zërave në Pasqyrat Financiare.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Për llogarinë ekonomike 218, sipas inventarit kontabël, ka disa aktive si pajisje elektronike, kondicionerë, kitarë, kamera digjitale etj. që duhet të pasqyroheshin në llogarinë 214 “Pajisje, instalime teknike, makineri e pajisje elektronike” dhe jo në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”. Për pasojë, Nëpunësi Zbatues nuk ka kryer klasifikimin e saktë të aktiveve ndër zëra. Për zërin 218 “Inventar ekonomik”, është përdoruar metoda e amortizimit mbi vlerën e mbetur. Kategorizimi i aktiveve nuk është i saktë, rrjedhimisht dhe amortizimi nuk është konform normave përkatëse për kategori të ndryshme aktivesh, në kundërshtim me UMF Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitje, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011 i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 30-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të Cirkut të marrë masa për klasifikimin e saktë të zërave të aktiveve në pasqyrat financiare si dhe rillogaritjet amortizimi për vitet e kaluara në mënyrë që pasqyrat financiare të vitit 2025 të paraqesin vlerën reale të aktiveve të institucionit.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën e Cirkut Kombëtar, gjatë periudhës Janar 2022-Dhjetor 2024 rezultoi se:

-struktura nuk është plotësuar për të gjithë pozicionet e parashikuara në strukturën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.134, datë 28.03.2014;

-nuk janë shpallur/publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën ose në Buletin, njoftime publike vendet e lira/vakante së bashku me kriteret përkatëse për pozicionet respektive, jo në përputhje me pikën 1 dhe 2 të VKM nr. 176, datë 29.3.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, pasi institucioni nuk disponon një faqe zyrtare në web, ose në Buletin njoftime publike për vende vakante;

-struktura e miratuar për vitin 2024, nuk përmban pozicionin “jurist”, për pasojë janë lidhur kontrata pune për shërbim ligjor me të tretë (jurist), me afate 3 muajore për periudhën 2023-2024, gjithsej 4 kontrata. Përzgjedhja për këtë pozicion nuk është bërë mbi bazën e kriterëve të vlerësimit si dhe nuk është bërë publikimi në faqen zyrtare të Ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën ose në Buletin njoftimeve publike jo në përputhje me pikën 1 dhe 2 të VKM nr. 176, datë 29.3.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”. Në këto kontrata çmimi për kryerjen e shërbimit nuk ka një referencë ligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,2 faqe 22-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtori i Cirkut Kombëtar në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse që, referuar parashikimit për numrin e vendeve vakante, të bëhet shpallja/publikimi i tyre së bashku me kriteret përzgjedhëse për çdo pozicion, si dhe procedurat e rekrutimeve të bëhen publike me qëllim që të jenë transparente.

-Drejtori i Cirkut Kombëtar, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të marrë masat që të zgjidhet problematika e plotësimit në strukturë për pozicionin “jurist”, apo atashashimi pranë Cirkut i një juristi, nga një njësi tjetër varësi e ministrisë.

Deri në dhjetor 2025

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dorëzimin e dokumentacionit dhe aktivet në përdorim për punonjësit e larguar nga puna për periudhën 2022-2024, rezultoi se:

-nuk janë kryer procedurat e nevojshme për dorëzimin e dokumentacionit të krijuar nga ata gjatë periudhës së punës si dhe aktiveve që kanë patur në përdorim;

-strukturat përgjegjëse të CK nuk kanë mbajtur me personat e larguar nga puna procesverbalet mbi dorëzimin e aktiveve në ngarkim të tyre dhe dokumentacionit zyrtar përpara dorëzimit të dokumentacionit përkatës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,2 faqe 22-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtori i Cirkut Kombëtar në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa që punonjësit e larguar nga puna, të dorëzojnë të dokumentuar me procesverbal detyrën dhe aktivet në ngarkim, para marrjes në dorëzim të librezës së punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit të përzgjedhura për auditim rezultoi se:

-Kontratat individuale të punës të lidhur me punonjësit e Cirkut Kombëtar si dhe kontratat individuale për punonjësit e rekrutuar gjatë periudhës Janar 2022-Dhjetor 2024, të cilat janë

pjesë e dosjeve të personelit, ishin me afat 1 apo 2 vjeçar pa u justifikuar arsyet pse janë lidhur me këtë afat si dhe atyre që ju kishte përfunduar afati nuk ishin rinovuar.

-Në dosjet e personelit mungojnë vlerësimet e performancës në punë, mbi verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave, si dhe i aftësive apo dobësive të punonjësve në kryerjen e detyrave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtori i Cirkut Kombëtar, të marrin masat për plotësimin e dosjeve të personelit me kontratat e reja me afat të pacaktuar, si dhe të kryhet procesi i vlerësimit periodik i performancës në punë të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listëpagesave të përzgjedhura për auditim rezultoi se:

- Për muajin shtator, tetor 2023 listpagesat nuk ishin të shoqëruara me listëprezencat, me qëllim verifikimin e ditëve të punës së stafit.

- Listpagesat shtator, tetor 2024 janë të shoqëruara me listëprezencën përkatëse përgatitur nga dirigjenti/drejtuuesi artistik dhe nënshkruar nga Drejtori i CK, por rezulton se ka mospërputhje ndërmjet numrit të punonjësve në listëprezencë dhe numrit punonjësve në listpagesë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtori i Cirkut Kombëtar, të marrin masat për shoqërimin e listpagesave me listëprezencat si dhe përputhshmërinë midis tyre, me qëllim që pagesa e punonjësve të jetë sipas prezencave repektive në punë dhe mos të këtë shpenzime të pajustificuara nga Nëpunësi Zbatues dhe Autorizues i Institucionit.

Në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Bordit Artistik (BA) për periudhën e audituar 2022-2024 rezulton se:

-për vitin 2023, BA ka funksionuar me 5 anëtarë dhe jo me 7 siç është detyrimi ligjor ndërsa për vitin 2024 me 6 anëtarë për shkak të dorëheqjes së një anëtari, jo në përputhje me Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar neni 10, pika 3;

-Rregullorja e funksionimit të Bordit miratuar me Vendimin Nr.1, datë 12.07.2023 si dhe Rregullorja për funksionimin e brendshëm, miratuar nga Drejtori i CK, nuk është përditësuar me proceset e punës për zbatimin e “*gjurmës së auditimit të projekteve*” miratuar me Urdhrin 70, datë datë 01.12.2023;

-tarifat për krijimtarinë artistike miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 2.07.2023 të BA nuk janë argumentuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar për çdo element që përbën zërin konkret për krijimtarinë (si *regji, koreografi, skenografi, kostumografi etj.*) krahasuar me çmimet e tregut apo duke ju referuar një bazë krahasuese me tarifat e krijimtarisë në institucionet e tjera të artit dhe kulturës, vendosja e tyre është trajtuar si domosdoshmëri që vjen nga ndryshimet e çmimeve në treg; -në të gjitha rastet vendimet e BA për miratimin e projekteve me financim nga buxheti, nuk përmbajnë bazën ligjore (*aktin administrativ ligjor*), të cilës i referohen për miratimin e zërave buxhetore mbi krijimtarinë;

-në një rast (2023) procesverbali i mbledhjes së Bordit nuk është i plotë pasi nuk pasqyron dhe përmban: përshkrim të detajuar të diskutimeve të anëtarëve të BA mbi zërat financiarë të propozuar për projektet në shqyrtim, nuk pasqyron shpalljen e interesit për thirrje për aplikim, si dhe nuk pasqyron dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët sipas “Thirrje për aplikim”, veprime jo në përputhje me Ligjin Nr.8480, date 27.5.1999 “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*”, neni 16 dhe 17.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 45-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bordi Artistik dhe titullari/Drejtori i Cirkut Kombëtar për të përditësuar Rregulloren e Bordit Artistik si dhe Rregulloren për funksionimin e brendshëm të Cirkut, me procedurat e ndjekura për zbatimin e “*gjurmës së auditimit të projekteve*”;

-Të merren masa nga Bordi Artistik për rishikimin e Vendimit Nr. 1, datë 2.07.2023 të tij, për zërat e krijimtarisë (si: *regji, koreografi, skenografi, kostumografi etj.*) krahasuar me çmimet e tregut apo referuar tarifave të krijimtarisë në institucionet e tjera të ngjashme të artit dhe kulturës, me qëllim argumentimin e tyre në mënyrë të detajuar.

-Të merren nga sekretari i protokollit të mbledhjeve të Bordit Artistik, për të pasqyruar në mënyrë të plotë të gjithë procesin e shqyrtimit dhe miratimit të projekteve artistike.

Deri me datë 30.09.2025

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projekteve artistike për periudhën e audituar 2022-2024 rezulton se:

-Për vitin 2023-2024 të gjithë urdhrat e titullarëve për periudhat respektive për ndjekjen dhe zbatimin e “*gjurmës së auditimit të projekteve*”, nga pikëpamja e formulimit urdhrat nuk janë të qarta, pasi urdhri del për “Ngritjen e grupit të punës për hartimin e gjurmës së auditimit”, në një kohë që kjo gjurmë është miratuar me Urdhrin Nr.70, datë 01.12.2023 të ish titullarit në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, neni 4, pika 19 dhe neni 9,16 si dhe Ligjin Nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative*” neni 5.

-kontratat e shërbimit të lidhur me artistët nuk parashikojnë penalitete për vonesa në realizimin e shërbimit, afatet, kalendarin e shfaqjeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve në mënyrë specifike, të drejtën e pronësisë për kostumet apo materialet skenike të prodhuara për projektin konkret, si dhe detyrimet mbi të drejtën e autorit, jo në përputhje me parimet e përgjithshme të Kodit Civil për kontratat e shërbimit;

-kontratat e shërbimit për projektet e miratuara nuk përmbajnë bashkëlidhur, plan buxhetin e miratuar për projektin, si pjesë integrale e kontratës;

-në disa raste mungon relacioni përmbledhës mbi zbatimin e gjurmës së auditimit të projekteve;

-publikimi i thirrjeve për aplikim projektësh bëhet në rrjete sociale (instagram) në adresë të CK dhe jo në faqen zyrtare të CK dhe as në atë të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën (mungon faqe zyrtare). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 45-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

12.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari/Drejtori i Cirkut Kombëtar në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse që në kontratat e shërbimit të lidhura për projektet, të parashikojë penalitete për vonesa në realizimin e shërbimit, afatet, kalendarin e shfaqjeve, të drejtat dhe detyrimet e palëve në mënyrë specifike, të drejtën e pronësisë si dhe detyrimet mbi të drejtën e autorit.

-Publikimi i thirrjeve për aplikim projektësh në çdo rast të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën ose/apo në Buletin e Njoftimeve Publike.

Në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projektit “ShakeSpirit”, viti 2024, rezulton se:

-Plan buxheti i miratuar nga BA për këtë projekt nuk ka të detajuar në mënyrë analitike zërat buxhetorë, pasi nuk parashikohet numri i shfaqjeve, numri i kostumeve të përgatitura/skicuara apo të ripunuara, gjithashtu për zëri buxhetor “kostumografi qera (kostumet) “-400,000 lekë nuk është analizuar arsyeja e marrjes së kostumeve me qera, numri i tyre si dhe e drejta e marrjes me qira nga kostumografi, veprime jo në përputhje me Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010, i ndryshuar neni 11, germa “ç”.

-kontrata e shërbimit Nr.352/2, datë 12.12.2023 lidhur me kostumografin si dhe kontrata e qirasë Nr. 353 datë 12.12.2023 lidhur mes kostumografit dhe shoqërisë “S.B.”, nuk parashikon të drejtën e nënkontraktimit, duke anashkaluar nga CK, procedura e blerjes/marrjes me qira me prokurim publik, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020, i ndryshuar neni 1 dhe neni 2;

-bashkëlidhur praktikës së magazinës për hyrje në magazinë të 80 kostume me vlerë 400,000 lekë me TVSH, nuk ka urdhër nga titullari për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit si dhe nuk është mbajtur një procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit/kostumeve, jo në përputhje me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 35, germa “b”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 45-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari/Drejtori i Cirkut Kombëtar që në funksion të realizimit të projekteve, kryerja e shërbimeve apo blerjes së mallrave, të bëhet përmes procedurës së prokurimit duke ju nënshtruar legjislacionit për prokurimin publik.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mbi administrimin e dokumentacionit të projekteve artistike për periudhën e audituar 2022-2024 rezultoi se:

-dosjet e projekteve artistike për periudhën 2023-2024 nuk janë të inventarizuara, nuk përmbajnë dokumentacionin sipas kërkesës së “gjurmës së auditimit” (*skenarin, konceptin regjisorial, projekt skenografi, projekt kostumografi dhe preventivin sipas zërave*) jo në përputhje me Ligjin “Për arkivat” si dhe Urdhrin Nr.70, datë 01.12.2023 për miratimin e “gjurmës së auditimit të projekteve”;
-aktet administrative dalë për zbatimin e projekteve në disa raste për vitin 2024, kanë korrigjime në numrin e protokollit (si: *deklaratat e konfliktit të interesit, Vendimi Nr.1, datë 21.03.2024 i Bordit*);
-në 2 raste, (2023), administrohen nga Zyra e Protokoll Arkivit dy shkresa me të njëjtën përmbajtje dhe datë por me numra të ndryshëm protokollit (*shkresa me objekt thirrje për aplikim projektësh Nr.207, datë 11.09.2023 dhe nr.206, datë 11.09.2023*) si dhe 1 rast (2024), administrohen nga Zyra e Protokoll Arkivit 2 urdhra të titullarit të institucionit me të njëjtat ekstremitetet (*datë dhe numër protokollit*) por me ndryshim në përbërjen e grupit për monitorimin e projektit (*Urdhri Nr. 20, datë 11.04.2024*);

-dorëzimi i akteve administrative të brendshme nga zyra e protokoll arkivit nuk bëhet me libër dorëzimi por komunikohet në mënyrë verbale pa lënë gjurmë në qarkullimin e dokumentacionit të brendshëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 45-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Drejtori i Cirkut Kombëtar në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të merren masa për inventarizimin e dosjeve të projekteve në përputhje me kërkesat e “gjurmës së auditit të projekteve”.

-Zyra e Protokoll Arkivit të marrë masa për administrimin e dokumentacionit në protokoll si dhe shpërndarjen e korrespondencës sipas dokumenteve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Menjëherë

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, për periudhën 2022-2024, rezultoi se nuk është zbatuar Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:

-nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, për pasojë nuk janë përcaktuar strukturat dhe mekanizmat që garantojnë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe funksionojnë me efektivitet brenda njësisë;

-mungon *Strategjia e Menaxhimit të Riskut/Plani i menaxhimit për trajtimin e risqeve*, e cila ka sjellë si pasojë që nga strukturat përgjegjëse nuk kryhet identifikimi, vlerësimi, kontrolli dhe monitorimi i risqeve në të gjitha nivelet e saj me qëllim arritjen e objektivave dhe si rrjedhojë nuk është dokumentuar procesi i menaxhimit të riskut në një regjistër;

-Nëpunësi Autorizues, në rolin e Koordinatorit të MFK-së nuk ka përmbushur detyrimin e përgatitjes dhe nënshkrimit të deklaratës dhe të raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 8, pika 8 shkronja” b”, nenin 9, pika 4, shkronja "a", nenin 11, pikat 2 dhe 3, neni 18, neni 21 pika 2 si dhe nenin 27 të Ligjit nr. 10296,

datë 08.07.2010, i ndryshuar, UMF nr.16, dt.20.07.2016, UMF nr. 28, datë 15.12.2011 dhe UMF nr. 2, datë 26.01.2024;

-nuk janë hartuar plane trajnimi e për pasojë nuk janë zhvilluar trajnime për punonjësit;

-nuk janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve, në kundërshtim me nenin 9, pika 4, shkronja” dh” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, si dhe nenin 4.4 të Rregullores së brendshme të Cirkut Kombëtar, protokolluar me shkresën nr. 116 prot, datë 20.03.2024;

-titullari i institucionit nuk ka hartuar gjurmën e auditimit për procese kryesore si; menaxhimi i aktiveve, procedura e marrjes në dorëzim të mallrave, ekzekutimi i shpenzimeve, procedura për ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumentacionit jo në përputhje me nenin 16, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar;

-në kuadër të detyrimeve ligjore për menaxhimin e aktiveve u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer procedurat e inventarizimit, vlerësimit, tjetërsimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave të brendshëm lidhur me përcaktimin e përgjegjësive në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi, në kundërshtim me nenin 9, pika 4 shkronja “ë” të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe pikave 73, 74 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 52-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Institucioni nuk disponon faqe zyrtare në ëeb si mjet informimi publik me qëllim garantimin e aksesit në informacione, bazuar në nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, si dhe nuk ka krijuar postë elektronike si mjet komunikimi zyrtar të brendshëm me qëllim transmetimin e informacionit, në mospërputhje me nenin 8, pika 8, shkronja “c” të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 52-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandim: Të merren masa nga drejtuesit e strukturave të CK-së, të kryejnë identifikimin dhe plotësimin e regjistrit institucional të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave, si dhe të miratojnë planin e veprimit për minimizimin e tyre.

-Nëpunësi Autorizues/Titullari, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me drejtuesit e strukturave për hartimin dhe miratimin e hartës dhe manualit të proceseve kryesore të punës dhe gjurmës së auditimit për secilin nga proceset.

Në vijimësi

15.2 Rekomandim: Nëpunësi Autorizues të marrë masa për:

-hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut dhe miratimin e saj nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, në përputhje me prioritetet dhe qëllimet afatmesme e afatgjata të institucionit;

-hartojë deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të Cirkut Kombëtar si dhe për çdo vit, të realizojë vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe

Në vijimësi

15.3 Rekomandim: Nga titullari i institucionit dhe përgjegjësi i sektorit të kryhet vlerësimi objektiv vjetor i performancës së punonjësve si dhe të identifikohen nevojat për trajnime;

-Për të rritur njohuritë e stafit mbi çështjet e MFK të merren masa që të përfshihen në planin vjetor të trajnimeve tema në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Në vijimësi

15.4 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisioneve për procesin e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve të njësisë me qëllim identifikimin e aktiveve gjendje/funksionale që disponon institucioni si dhe rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike.

Deri me datë 31.12.2025

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës së qirasë nr. 45 prot. datë 20.02.2023 me Shoqërinë “D.” SHPK, rezultoi se:

-Cirkul Kombëtar nuk ka shpallur dhe publikuar njoftimin së bashku me kriteret e kualifikimit të interesuarve/konkurrentëve për marrjen me qira të një godine/objekt ndërtimor për ushtrimin e veprimtarisë së CK dhe afatin e dorëzimit të ofertave;

-nuk është përcaktuar sipërfaqja e nevojshme dhe llogaritur vlera fillestare minimale për konkurrim sipas VKM-së nr. 469 datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, ku nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit rezultojnë që vlera e qirasë të jetë 266,804 lekë/muaj ose për 2 vjet vlera 6,403,296 dhe jo 300,000 lekë /muaj, siç është përcaktuar në kontratë, diferenca prej **797 mijë** lekë përbën shpenzime pa ekonomikitet dhe efektivitet;

-likuidimi i faturave për qiranë është kryer me vonesë, në tejkalim të afateve të përcaktuara në kontratën e qirasë, neni 4, pika 1 dhe pika 5.

-nga krahasimi i datës së faturës tatimore dhe datës së likuidimit, rezultojnë se janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 52 si dhe Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i Cirkut Kombëtar, që në të ardhmen të ndiqen procedurat ligjore në rastet e lidhjes së kontratave të qirasë për godinë/objekt ndërtimor, duke llogaritur çmimin minimal bazuar në çmimin e referencave të qirave të ndërtesave me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet të fondeve buxhetore.

-Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të Cirkut të marrë masa për likuidimin e faturave në përputhje me afatet e kontratës si dhe në zbatim të disiplinës ligjore për menaxhimin e buxhetit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se:

Në pasqyrat financiare të vitit 2023 është reflektuar veprimi kontabël pakësim inventari. Ky veprim është bazuar në konkluzionet e grupit të inventarizimit të aktiveve të cilët kanë hartuar pasqyrën për nxjerrje jashtë përdorimit në tabelë exceli për 37 artikuj me emërtimin “Mungojnë me proces verbal” në vlerën 6,578 mijë lekë që përbën shpenzim pa ekonomikitet. Referuar këtyre evidencave, nuk dokumentohet të ketë miratim nga strukturat përgjegjëse lidhur me shkarkimin me procesverbal të vlerave të evidentuara si mungesë, në moszbatim të kërkesave të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 të ndryshuar. Të dhënat e kësaj table të cilat rezultojnë mbi vlerën e materialitetit, nuk janë konfirmuar nga grupi i inventarizimit dhe nuk është kryer një analizë e veprimeve kontabël sistemuese, jo në përputhje me UMF nr. 30 datë 27.11.2011 të ndryshuar pika 34, 35, 36, 37 dhe 38 dhe Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore të NJQP”, i ndryshuar. Mbi procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë, nuk ka gjurmë të plotë të auditit përse i përket këtij procesi, nuk specifikohet mënyra e kryerjes së nxjerrjes jashtë përdorimit, mungojnë provat justifikuese siç kërkohet nga UMF nr. 30 datë 27.12.2011 të ndryshuar;¹²

2.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa për analizimin, verifikimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për veprimet e paautorizuara lidhur me procesverbalin e mbajtur për

¹² Lidhur me këtë problematikë është shprehur dhe Inspektimi Financiar Publik dhe çështja është në proces në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

shkarkimin nga inventari të artikujve që mungojnë në vlerën 6,578 mijë lekë, i cili përbën shpenzim pa ekonomikitet.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës dhe pagesave të kryera për ekzekutimin e titullit ekzekutiv “Vendim nr. 8473, datë 17.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” me palë kreditore Shoqëria “U. SHPK”, referuar urdhër shpenzimeve rezultoi se:

Ekzekutimi i Vendimit nr. 8473, datë 17.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga CK, nuk është bërë në mënyrë vullnetare por në mënyrë të detyrueshme nga Zyra Përmbartimore “K.B.S.” SHPK, duke sjellë kosto shtesë për buxhetin në vlerën prej 13,236 mijë lekë nga të cilat 10,773,000 lekë përbëjnë tarifa dhe shpenzime përmbartimore dhe 2,463 mijë lekë shpenzime për hartim akt- ekspertimi, çmontim çadre etj.

Shpenzimet për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor në vlerën prej 13,236 mijë lekë konsiderohen shpenzim pa ekonomikitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që të kryejë në kohë likuidimin e shpenzimeve gjyqësore sipas vendimeve të formës së prerë, me qëllim shmangien e shërbimit përmbartimor, tarifatat e të cilit në vlerën 13,236 mijë lekë përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet për buxhetin.

Në vijimësi

V.ANEKSE

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.

SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

A. Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

1. Një **opinion i pamodifikuar** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësine publike të audituar; dhe
- (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

1.1 Opinioni me rezerve. Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mos pajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

B. Audituesi e modifikon opinionin, duke shprehur:

1. Opinioni i modifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të modifikuar:

1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose

2. Kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

2. Opinioni negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

3. Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

Gjatë fazës së planifikimit nga ana e grupit të auditimit u vlerësua risku dhe metoda e auditimit. Materialiteti

Përcaktimi i materialitetit nga *ana sasiore* përfshin gjykimin mbi nivelin maksimal të pranueshëm të shmangies së përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret. Ky materialiteti vlerësohet deri në 2% në nivel grupi dhe llogarie.

Përcaktimi i materialitetit nga *ana cilësore* “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose në varësi të kontekstit të tyre” të cilat do të lidhen me përputhshmërinë e veprimtarisë së CK vlerësohen materiale nga ana cilësore për vetë impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike të cilin ka veprimtaria e këtij institucioni.

Emërtimi i Shpenzimeve 2023	Vlera e	Faktori i Riskut	Çështje për tu shqyrtuar
	Popullatës	(0.7-3)	
Paga (600)	43,026,061	0.7	31
Sigurime Shoqërore (601)	7,210,208	0.7	5
Mallra e Shërbime (602)	9,745,120	2	20
Investime të brend. (230-231)	0	2	0
Te tjera transfer. korrente (606)	252,863	0.7	0
Total	60,234,252		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	1,204,685		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	1,204,685		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	120,469		
Nëntotali	1,084,216		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	975,794		

Materialiteti

Përcaktimi i materialitetit nga *ana cilësore* “*Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose në varësi të kontekstit të tyre*” të cilat do të lidhen me përputhmërinë e veprimtarisë së CK vlerësohen materiale nga ana cilësore për vetë impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike të cilin ka veprimtaria e këtij institucioni.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT